



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**Komuna e Klinës**  
Opština Klina – Municipality of Klina



# **KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027 E KOMUNËS SË KLINËS**

**Klinë, qershor 2024**

# **Përmbajtja**

I. Hyrje

II. Deklarata e Prioriteteve Afatmesme 2025-2027

III. Korniza Fiskale

3.1 Korniza makroekonomike komunale

3.2 Të Hyrat komunale dhe parashikimi afat-mesëm 2025-2027

3.3 Politikat e reja

3.4 Shpenzimet komunale dhe parashikimet 2025-2027

3.5. Analiza Gjinore

IV. Korniza e Përformancës së Shpenzimeve

V. Informacionet sipas programeve

## **I. Hyrje**

Korniza afatmesme buxhetore komunale paraqet një përmbledhje të planifikuar të shpenzimeve dhe të hyrave buxhetore për komunën e Klinës për periudhën afatmesme 2025-2027 si dhe shpërndarjen e resurseve financiare nëpër programe komunale sipas prioriteteve të qeverisë komunale të nxjerra nga dokumentat strategjike komunale dhe vendimet e Kuvendit komunal të Klinës.


Korniza Afatmesme Buxhetore, KAB, që po prezantohet është një dokument i cili përgatitet nga administrata komunale dhe miratohet në parim çdo vit nga Asambleja Komunale. Ky material siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve publike dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor komunal. Gjithashtu, KAB, siguron mekanizmat e nevojshëm për arritjen objektivave prioritare, të identifikuara në dokumentet strategjike të komunës, nëpërmjet integritit sa më të mirë në procesin buxhetor.

Korniza afatmesme buxhetore komunale bazohet në parashikimet e mundshme reale të të hyrave të planifikuara për periudhën afatmesme buxhetore: granteve qeveritare në formë të kufijve buxhetor, parashikimet mbi trendin e të hyrave vetanake si dhe parashikimeve mbi donacionet e mundshme qoftë edhe në formë participimeve të qytetarëve (grave dhe burrave) si dhe parashikimet reale të shpenzimeve buxhetore nëpër programet komunale që janë në fushën e përgjegjësisë së tyre.

Hartimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore përbën një detyrim për institucionet buxhetore komunale, kërkuar me Qarkoren Buxhetore Komunale 2025/01 të lëshuara nga Ministria e Financave, punës dhe transferëve në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP).

KAB 2025-2027 paraqet dokumentin kryesor mbi bazën e të cilit do të hartohet Buxheti vjetor për vitin 2025.

Ky dokument do të jetë baza për përcaktimin e sektorëve prioritarë të zhvillimit dhe identifikimin e prioriteteve të shpërndarjes së burimeve komunale për periudhën 2025-2027. Janë katër faza të përmbledhura për zhvillimin e KAB Komunale dhe afatet kohore, si në figurën e mëposhtme:



## II. Deklarata e Prioriteteve Afatmesme 2025-2027 nga Strategjia Zhvillimore Komunale

Komuna e Klinës gjendet në pjesën veri – perëndimore të Kosovës, rajoni i Pejës . Është njëra nga komunat e mesme të vendit. Pozita gjeografike që ka i mundëson asaj lidhje të mira me qendrat tjera të Kosovës dhe të rajonit. Komuna e Klinës ka gjithsej 54 fshatra. Sipas rezultateve të regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, Komuna e Klinës ka rreth 38496 banorë (19303 gra dhe 19193 burra) të organizuar në 5843 ekonomi familjare.

Mbi 1621 biznese (340 biznese që udhëheqen nga femrat dhe 1281 biznese që udhëheqen nga burrat) operojnë brenda komunës. Bazuar në të dhënat e Drejtorisë për Buxhet e financa, rreth 521 merren me veprimtari tregtare, 371 shërbyese, 150 prodhuese dhe 579 ndërtimore.



Administrata e Komunës së Klinës është e organizuar për rreth zyrës qendrore dhe zyrave lokale që ofrojnë shërbime në nivel të komunitetit, nga të cilat një është e vendosur brenda qytetit duke përfshirë zyrën qendrore dhe 9 të tilla në fshatra.

Vizioni i mëposhtëm për Komunën e Klinës i definuar pas konsultimeve me akterët e rëndësishëm të jetës politike ekonomike e sociale në komunë bazohet edhe në dokumentet afatmesme dhe afatgjata strategjike, që ka zhvilluar komuna siç janë: Strategjia e Zhvillimit ekonomik e Komunës së Klinës 2024-2029, në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2025-2027 të Qeverisë së Kosovës dhe prioritetëve bazë të saj, si dhe në Qarkoren Buxhetore Komunale 2025/01 të lëshuara nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve e Qeverisë së Republikës së Kosovës .

**Vizioni i komunës është që Klina do të bëhet një vend ekonomikisht i zhvilluar, ku gratë dhe burrat kanë mundësi të barabarta për të hapur dhe zhvilluar bizneset e tyre, me një administratë komunale efikase në shërbim të qytetarëve dhe bizneseve, mjedis të pastër dhe atraktiv për të jetuar dhe investuar. Duke patur për bazë pozitën dhe kushtet gjeografike, prioritet do të jetë zhvillimi i NVM-ve, bujqësisë, turizmit dhe infrastrukturës fizike. Të kemi ngritje dhe përmirësim të cilësisë në arsim, shëndetësi dhe shërbime publike, ku barazia gjinore është prioritet ndërsektorial .**

Atributet më të rëndësishme të çfarëdo dokumenti të planifikimit strategjik dhe vizionit të definuar janë së pari lehtësia e komunikimit dhe llogaridhënia. Me qëllim të përmbushjes së këtyre dy attributeve, prioritetet strategjike të Komunës në periudhën afatmesme janë grupuar në katër prioritetet që do të mundësojnë realizimin e qëllimit të vizionit tonë për komunën, si :

## **1. Zhvillimi ekonomik për të gjithë qytetarët (gra, burra, vajza dhe djem)**

Përmes objektivave :

- **Ndërmarrësia – Zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme ;**
- **Zhvillimi i bujqësisë - mbështetje e sektorit bujqësor dhe blegtoral;**
- **Zhvillimi i turizmit dhe trashëgimisë kulturore;**
- **Barazia gjinore si prioritet ndërsektorial në ndërmarrësi, zhvillim i bujqësisë, turizmit dhe tashëgimisë kulturore.**

## **2. Zhvillimi i infrastrukturës së nevojshme në funksion të qytetarëve dhe bizneseve (gra, burra, vajza dhe djem) dhe bizneseve.**

Përmes objektivave :

- **Rritja e nivelit të shërbimeve administrative për biznese në pronësi të grave dhe burrave (reduktimi i procedurave)**
- **Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatra**
- **Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit në fshatra**
- **Zgjerimi i infrastrukturës rrugore**

### **3. Përmirësimi i cilësisë së arsimit dhe shëndetësisë**

Përmes objektivave :

- **Përmirësimi i infrastrukturës shkollore**
- **Përmirësimi i infrastrukturës shëndetësore në QKMF, AMF dhe AM**

### **4. Përparimi dhe mbrojtja e mjedisit jetësor.**

Përmes objektivave :

- **Ruajtja dhe përmirësimi i natyrës**
- **Ulja graduale e ndotjes së ujit, ajrit, tokës.**

### **5. Krijimi i qeverisë komunale që ofron shërbime efikase dhe që u përgjigjet kërkesave të qytetarëve (gra, burra, vajza dhe djem)**

Përmirësimi i shërbimeve komunale karshi qytetarëve duke u fokusuar në qasjen më të afërt dhe të lehtë të tyre në administratë përmes:

Mirëmbajtjes së zyreve komunale (të gjendjes civile) dhe furnizimi me material të nevojshëm me qëllim të ofrimit të shërbimeve.

### III. Korniza Fiskale Komunale

#### 3.1 Korniza makroekonomike komunale

Ndonëse komuna nuk udhëheqë drejtëpërdrejt politikën makroekonomike (kjo është kompetencë e qeverisë qendrore), mjedisi i përgjithshëm ekonomik ndikon në pasqyrën fiskale komunale. Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës është në përputhje me kornizën makroekonomike të Kosovës dhe sipas dokumentit Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH) 2025-2027 të përpiluar nga Qeveria e Kosovës.

Komponentet e politikës makroekonomike siç janë bruto produkti vendor, inflacioni dhe demografia duhet konsideruar dhe marrë parasysh. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2025-2027 e Qeverisë së Kosovës bazuar në të dhënat historike si dhe në zhvillimet e fundit ekonomike, nënvizon faktin se do të ketë ecuri pozitive të rritjes ekonomike në vitet e ardhshme, më saktësisht në periudhën 2025-2027.

Natyrisht se rritja ekonomike nëkuptohet në krijimin e vendeve të reja të punës për gra dhe burra, zbutjen e papunësisë në komunë, që në periudhën afatmesme pritet të ulët.

Komuna nga ana e saj do të adaptojë legjislacionin përkatës në funksion të krijimit të ambientit më të mirë për sektorin privat dhe rritjes së të ardhurave të tyre, rrejdhimisht rritjes së të hyrave buxhetore komunale.

Aktualisht financimi komunal përfshinë: **1. Të Hyrat Vetanake dhe 2. Grantet Qeveritare**. Komuna është pranuese e **granteve të donatorëve** (me mbulim të plotë apo si pjesë të bashkëfinancimeve), si dhe ka mundësinë e huamarrjes sipas kushteve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Komuna e Klinës në periudhën afatmesme buxhetore 2025-2027 nuk planifikon të marrë hua nga institucione financiare për të financuar projektet e saj, siç e ka lejuar Ligji për Financat Publike dhe Përgjegjësitë.

### 3.2 Të Hyrat komunale dhe parashikimi afat-mesëm 2025-2027

Të hyrat e Komunës së Klinës nga dy burimet e saj kryesore – grantet qeveritare si dhe të hyrat vetanake komunale kanë shënuar rritje nga viti në vit.

Tabela 1:Financimi komunal për vitet 2025-2027 sipas burimit

<b>Korniza afatmesme buxhetore 2025-2027</b>	<b>Buxheti aktual 2024</b>	<b>Planifikimi 2025</b>	<b>Vlerësimi 2026</b>	<b>Vlerësimi 2027</b>
Granti i përgjithshëm	6.086.118.00	6.571.819.00	6.951.325.00	7.337.752.00
Granti specifik i arsimit	5.453.127.00	5.953.349.00	6.131.950.00	6.315.908.00
Granti i shëndetësisë	1.673.212.00	1.897.981.00	1.988.325.00	2.082.970.00
Të hyrat vetanake	1.436.260.00	1.495.504.00	1.606.855.00	1.720.536.00
Financimi për shërbimet rezidenciale		250.000.00	200.000.00	200.000.00
<b>Totali :</b>	<b>14.648.717.00</b>	<b>16.168.653.00</b>	<b>16.878.455.00</b>	<b>17.657.166.00</b>

Figura 1: Buxheti total i komunës në vite

Siç shihet nga tabela më lartë, financimi për Komunën e Klinës në total nga viti në vit shënon rritje . Grantet për Komunën e Klinës për periudhen 2025-2027 si tërësi do të shenojnë rritje rreth 6.45%  $(10.37+4.38+4.61/3)$  .

Të dhënat e prezantuara në tabelën më lartë bazohen në të dhënat e përgjithshme për rritjen buxhetore që planifikohet në nivel të Qeverisë nacionale, siç parashihet me KASH-in 2025-2027. Për vitin 2025 Granti i përgjithshëm, Granti i shëndetësisë dhe Granti i arsimit kanë rritje të lehtë.

Projeksionet e të hyrave vetanake komunale si burim i financimit komunal, në anën tjetër, për vitin 2025 ka rritje për 4.12%, për vitin 2026 ka shënuar rritje për rreth 7.44% dhe në vitin 2027 rritje për 7.07% . Planifikimi i të hyrave nga gjykatat dhe dënimet në trafik do të planifikohen në nivelin qendror në institucionet të cilat i realizojnë këto të hyra .

**Tabela 2. Të hyrat vetanake për 2025-2027**

	2024	2025	2026	2027
THV	1,436,260.00	1,495,504.00	1,606,855.00	1,720,536.00




Figura 2: Buxheti nga të hyrat vetanake në vite

**Tabela 3. Planifikimi i të hyrave vetanake të komunës sipas burimeve për periudhën 2025-2027 në euro**

Kodet	BURIMET E TË HYRAVE	Planifikimi - për vitin 2025	Planifikimi - për vitin 2026	Planifikimi - për vitin 2027
<b>1)</b>	<b>Drejtoria e Urbanizmit</b>	<b>357.294.00</b>	<b>365.000.00</b>	<b>395.000.00</b>
50009	Lejet për ndërtim	357.294.00	365.000.00	395.000.00
<b>3)</b>	<b>Drejtoria e Inspektionit</b>	<b>17.000.00</b>	<b>19.500.00</b>	<b>33.000.00</b>
50104	Denimet mandatore	8.000.00	9.500.00	15.000.00
50205	Komisioni inspektues	9.000.00	10.000.00	18.000.00
<b>5)</b>	<b>Kadastra</b>	<b>85.000.00</b>	<b>86.000.00</b>	<b>88.000.00</b>
50504	Të hyrat nga shërbimet kadastrale	85.000.00	86.000.00	88.000.00
<b>6)</b>	<b>Administrata e përgjithshme</b>	<b>55.180.00</b>	<b>58.200.00</b>	<b>65.500.00</b>
50013	Çertifikatat e lindjës	680.00	1.000.00	1.000.00
50014	Çertifikatat e kunorzimit	100.00	100.00	100.00
50015	Çertifikatat e vdekjës	1.400.00	1.400.00	1.400.00
50016	Çertifikatat tjera	43.000.00	45.000.00	50.000.00
50017	Të hyrat tjera	7.500.00	8.000.00	10.000.00
50019	Taksat administrative	2.500.00	2.700.00	3.000.00
<b>7)</b>	<b>Drejtoria për Buxhet e Financa</b>	<b>865.030.00</b>	<b>947.155.00</b>	<b>1.001.036.00</b>
50103	Marimanga	1.000.00	1.000.00	1.000.00
50217	Taksa për ushtrim të veprimtarisë	62.000.00	62.000.00	62.000.00

Vërejtje: KAB 2025-2027 bëhet përfundimtare pas miratimit të buxhetit vjetor 2025 nga Kuvendi Komunal

50001	Taksa për rexhistrimin e automjeteve	86.000.00	86.000.00	86.000.00
50407	Qiraja për lokalet afariste	10.000.00	17.000.00	25.006.00
50408	Qiraja për banesa	29.000.00	32.000.00	35.000.00
50403	Shitja e pasurisë	10.000.00	15.000.00	20.000.00
50405	Shfrytëzimi i pronës publike	11.000.00	11.000.00	11.000.00
50406	Qiraja për treg të hapur	1.030.00	1.030.00	1.030.00
40110	Tatimi mbi pronë	460.000.00	494.125.00	520.000.00
	Tatimi në tokë	195.000.00	228.000.00	240.000.00
<b>I</b>	<b>Totali i administratës komunale</b>	<b>1.379.504.00</b>	<b>1.475.855.00</b>	<b>1.582.536.00</b>
	<b>Të ardhurat nga arsimi</b>			
50409	Qerdhet	25.000.00	30.000.00	29.000.00
50409	Arsimi fillor	3000	2000	5000
50409	Arsimi i mesëm	43.000.00	50.000.00	50.000.00
<b>II</b>	<b>Totali - arsimi</b>	<b>71.000.00</b>	<b>82.000.00</b>	<b>84.000.00</b>
	<b>Të ardhurat nga shendetësia</b>			
50409	Shendetësia primare	39.000.00	42.000.00	47.000.00
50409	Qendra për Punë Sociale	6.000.00	7.000.00	7.000.00
<b>III</b>	<b>Totali - shendetësia</b>	<b>45.000.00</b>	<b>49.000.00</b>	<b>54.000.00</b>
<b>TOTALI I TË ARDHURAVE VETANAKE TË KOMUNËS ( I + II + III )</b>		<b>1.495.504.00</b>	<b>1.606.855.00</b>	<b>1.720.536.00</b>

Në këto projeksione janë marrë parasysh të hyrat nga tatimi në pronat e paluajtshme (tatimi në tokë dhe tatimi në pronë) sipas faturimit të tatimit në pronë dhe trendit të realizimit të të hyrave jo tatimore gjatë tri viteve të fundit, duke përfshirë nga këto projeksione të hyrat nga gjambat në trafik dhe të hyrat nga gjykatat.

Komuna e Klinës vazhdon të dominohet në buxhetin total të saj nga transferet qeveritare të cilat edhe në tri vitet e ardhshme do të përbëjnë rreth 90.75 % të buxhetit total të komunës.

#### - Huamarrja

Komuna e Klinës në periudhën afatmesme buxhetore 2025-2027 nuk planifikon të marrë hua nga institucione financiare për të financuar projektet e saj, siç e ka lejuar Ligji për Financat Publike dhe Përgjegjësitë

### 3.3 Politikat e reja

Komuna e Klinës në tri vitet e ardhshme do të bëjë përpjekje në mobilizimin e resurseve komunale me qëllim të adaptimit të politikave të reja që ka inicuar qeveria nacionale e Republikës së Kosovës, por edhe të atyre të inicuar në nivelin e qeverisë komunale.

Sipas Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të Qeverisë së Kosovës 2025-2027, ndarjabuhetore bazohet në formulën e përcaktuar në nenin 24 të LFPL. Sipas këtij neni, 10% e të hyrave totale të buxhetuara të Qeverisë qendrore ju ndahen komunave (duke përfshirë të hyrat nga shitja e aseteve, të hyrat tjera të jashtëzakonshme, të hyrat e dedikuara vetanake dhe të hyrat nga huamarrja).

Në periudhën afatmesme Qeveria e Kosovës me formulën shtetërore për ndarje të grantit të arsimit për komuna, ndarje kjo që është bërë në qarkoren buxhetore 2025/01 në bazë të numrit të nxënësve, e që çdo vit bie numri i nxënësve, atëherë kjo do të ketë ndikim të dukshëm në buxhetin e komunës ( ulë grantin e arsimit) duke pas parasysh se ky grant përbën pjesën më të madhe të buxhetit komunal.

Komuna e Klinës është e ndikuar në aspektin buxhetor edhe me rastin e fillimit të aplikimit të Ligjit për paga në sektorin publik. Sa i përket politikave të reja ose atyre të paralajmëruara nga niveli qendror, me ndikim në Komunën e Klinës , është edhe politika në lidhje me trajtimin e mirëqenies sociale si kompetencë e decentralizuar në komunat e Kosovës. Komuna e Klinës aktualisht nuk posedon informatat e nevojshme në lidhje me mënyrën e ndarjes buxhetore që do të bëhet për financimin kësaj fushe, ndryshe nga ajo që është aktualisht, ndonëse ka paralajmërim nga ministria e linjës dhe Ministria e Financave dhe transfereve sa i përket këtyre politikave.

Komuna e Klinës ka mirëpritur deklaratimet e Qeverisë Qëndrore, që në të ardhmen, sa i përket fleksibilitetit të shpenzimeve në të gjitha kategoritë ekonomike, përveç pagave, të kenë mundësi këtë ta bëjnë edhe nga Granti i Përgjithshëm si shtesë, përveç se nga të hyrat vetanake komunale.

Ndërsa sa i përket të hyrave të tjera të komunës, apo të hyrave vetanake, sërish qeveria nacionale ka shtyrë drejt politikave të reja që do të orientonin komunën drejt avancimit të tatimeve me potencial të mirë dhe zbehjes eventualisht eleminimit të atyre taksa e ngarkesa komunale që rëndojnë ambientin biznesor komunal, janë jo transparente karshi qytetarëve respektivisht tatimpaguesit komunal.

### **3.4 Shpenzimet komunale dhe parashikimi i tyre afat-mesëm 2025-2027**

Sipas rekomandimeve të Misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar të komunikuar përmes Qarkorës Buxhetore komunale 2025/01, komunat do të kenë edhe në të ardhmen fleksibilitet në shpërndarjen e të hyrave vetanake komunale në Strukturën e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike për vitin 2025, duke përjashtuar kategorinë Paga dhe Meditje. Si rezultat Komuna e Klinës prezanton këtë ndarje të shpenzimeve në mes të kategorive të lejuara buxhetore:

**Tabela 6. Korniza Buxhetore Komunale, në euro**

Përshkrimi	2024	2025 (planifikim)	2026 (vlerësimet)	2027 (vlerësimet)
<b>1 TË HYRAT TOTALE KOMUNALE</b>	<b>14.648.717.00</b>	<b>16.168.653.00</b>	<b>16.878.455.00</b>	<b>17.657.166.00</b>
1 Të hyrat vetanake	1.436.260.00	1.495.504.00	1.606.855.00	1.720.536.00
1 Grantet dhe transferet qeveritare	13.212.457.00	14.673.149.00	15.271.600.00	15.936.630.00
<b>2 SHPENZIMET TOTALE KOMUNALE</b>	<b>14.534.764.00</b>	<b>16.168.653.00</b>	<b>16.878.455.00</b>	<b>17.657.166.00</b>
2.1 Shpenzimet rrjedhëse	<b>10.496.857.00</b>	<b>11.640.000.00</b>	<b>12.179.800.00</b>	<b>12.728.524.00</b>
Pagat dhe medijtjet	7.936.857.00	8.730.000.00	9.166.500.00	9.624.825.00
Mallrat dhe shërbim	1.710.000.00	1.790.000.00	1.843.700.00	1.899.011.00
Shërbime komunale	250.000.00	320.000.00	329.600.00	339.488.00
Subvencionet	600.000.00	800.000.00	840.000.00	865.200.00
<b>2 Shpenzimet Kapitale</b>	<b>4.037.907.00</b>	<b>4.528.653.00</b>	<b>4.698.655.00</b>	<b>4.928.642.00</b>



Figura 3: Shpenzimet komunale të planifikuara sipas kategorive ekonomike për 2025



**3.4.1 Pagat dhe Meditjet** – kjo kategori e shpenzimeve në periudhen afatmesme pritet të rritet me një mesatare prej 6.66%. Rritja më e lartë për shkak të sistematizimit dhe klasifikimit të vendeve të punës parashihet në vitin 2025 rreth 9.99%. Pjesëmarrja e kategorisë së pagave dhe mëditjeve në shpenzimet përgjithshme buxhetore komunale në vitin 2025 pritet të mbetet në nivel të përafërt rreth 53.99 % e buxhetit. Buxheti për paga dhe meditje për vitin 2025 pritet të arrinë shumën prej **8,730,000.00 euro (buxheti për gra 4,294,011.94 euro ose 49.18% dhe buxheti për burra 4,435,988.06 euro ose 50.81%)**.

**3.4.2 Mallrat dhe Shërbimet** -kategoria e shpenzimeve për mallra dhe shërbime në periudhen 2025-2027 do të shënoj rritje për rreth 3.55 % . Në vitin 2025 pritet rritje prej 4.68% krahasuar me vitin 2024 ndërsa për vitet 2026 dhe 2027 pritet rritje prej 3%. Pjesëmarrja e kësaj kategorie të shpenzimeve në shpenzimet e përgjithshme buxhetore, në vitin 2025 pritet të jetë rreth 11.07 %. Buxheti për mallra dhe shërbime për vitin 2025 pritet të arrinë shumën prej 1,790,000.00 euro (buxheti për gra 897,506.00 euro ose 50.14% dhe buxheti për burra 892,494.00 euro ose 49.86%).

**3.4.3 Shpenzimet komunale** - kategoria e shpenzimeve komunale në periudhen 2025-2027 do të shënoj rritje mesatare prej 11.33% . Në vitin 2025 pritet të ket rritje më të lartë prej 28% krahasuar me vitin 2024 për shkak të zgjerimit të rrjetit të ndriqimit publik dhe ndërtimin e nxemjeve qendrore me pompa termike në institucionet arsimore, shëndetësore dhe publike, ndërsa për vitin 2026 rritje 3% dhe në vitin 2027 rritje prej 3% . Pjesëmarrja e kësaj kategorie të shpenzimeve në shpenzimet e përgjithshme buxhetore, në vitin 2025 pritet të jetë rreth 1.97 % . Buxheti për shpenzime komunale për vitin 2025 pritet të arrinë shumën prej 320,000.00 euro (buxheti për gra 160,448.00 euro ose 50.14% dhe buxheti për burra 159,552.00 euro ose 49.86%).

**3.4.4 Subvencionet** – kjo kategori e shpenzimeve gjatë periudhës së projektuar 2025-2027 pritet të shënoj rritje mesatare prej rreth 13.77 % . Rritje më e lartë parashihet në vitin 2025, rreth 33.33 % për shkak të riklasifikimit të disa shpenzimeve nga kategoria e shpenzimeve kapitale në këtë kategori. Pjesëmarrja e transfereve dhe subvencioneve në shpenzimet e përgjithshme buxhetore në vitin 2025 pritet të jetë rreth 4.94% . Në vitin 2025 subvencionet do të shpenzohen për shëndetësi ( ndihmë për shërimë bazuar në kërkesat e deponuara), kulturë, rini e sport , arsim-bursa për student, bujqësi ) etj . Buxheti për subvencionime për vitin 2025 pritet të arrinë shumën prej 800,000.00 euro (buxheti për gra 360,000.00 euro ose 45% dhe buxheti për burra 440,000.00 euro ose 55%).

**3.4.5 Investimet Kapitale** - kjo kategori e shpenzimeve në periudhen 2025-2027 do të shënojë rritje mesatare prej rreth 27.92% . Në vitin 2025 pritet rritje prej 12.15% krahasuar me vitin 2024. Një pjesë e madhe e tyre planifikohet të financohet nga të hyrat vetanake të komunës. Rritja e investimeve kapitale, nga buxheti i komunës do të bëhet nga viti në vit . Pjesëmarrja e investimeve kapitale në totalin e shpenzimeve të komunës në vitin 2025 pritet të jetë rreth 28 % . Buxheti për investimet kapitale për vitin 2025 pritet të arrinë shumën prej 4,528,653.00 euro (buxheti për gra 2,270,666.61euro ose 50.14% dhe buxheti për burra 2,257,986.38 euro ose 49.86%).

Tabelat në vijim janë një pasqyrë e shpërndarjes së shpenzimeve komunale në bazë të programeve dhe në bazë të kategorive ekonomike. Shpenzimet në vijim janë ato aktuale të vitit 2024, planifikimi për vitin e ardhshëm 2025 si dhe vlerësimet për vitet 2026 dhe 2027.

**Tabela 7: Shpenzimet komunale sipas kategorive ekonomike dhe programeve – Viti aktual 2024**

Programet	2024					Gjithsej
	Paga/Mëditje	Mallra/Shërbime	Komunali	Subvencione	Investime Kapitale	
<b>Zyra e Kryetarit</b>	135,321.00	36,000.00		299,000.00		470,321.00
<b>Zyra e Kuvendit Komunal</b>	227,183.00	5,000.00				232,183.00
<b>Administrata dhe Personeli</b>	307,964.00	95,000.00			65,000.00	467,964.00
<b>Çështjet gjinore</b>	8,393.00	5,000.00				13,393.00
<b>Inspektimet</b>	68,476.00	42,000.00				110,476.00
<b>Buxheti dhe financat</b>	157,906.00	57,137.00	140,000.00			355,043.00
<b>Infrastruktura Publike</b>	11,310.00	265,692.00			535,000.00	812,002.00
<b>Zjarrfikësit dhe Inspektimet</b>	144,606.00	20,000.00				164,606.00
<b>Zyra Komunale për Komunitete</b>	33,364.00	13,000.00				46,364.00
<b>Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural</b>	83,144.00	15,000.00		161,000.00	180,000.00	439,144.00
<b>Kadastra dhe Gjeodezia</b>	82,589.00	20,000.00				102,589.00
<b>Planifikimi urban dhe mjedisi</b>	47,567.00	60,200.00			2,881,860.00	2,989,627.00
<b>Shëndetësia</b>	1,243,409.00	415,007.00	40,000.00		75,000.00	1,773,416.00
<b>Shërbimet sociale</b>	91,162.00	12,000.00	8,000.00			111,162.00
<b>Shërbimet rrezidenciale</b>	50,000.00	45,000.00	5,000.00		150,000.00	250,000.00
<b>Kultura, rinia dhe sporti</b>	95,002.00	44,500.00		100,000.00	55,000.00	294,502.00
<b>Arsimi dhe shkenca</b>	5,149,461.00	559,464.00	57,000.00	40,000.00	210,000.00	6,015,925.00
<b>TOTALI</b>	7,936,857.00	1,710,000.00	250,000.00	600,000.00	4,151,860.00	14,648,717.00

**Tabela 8: Shpenzimet komunale sipas kategorive ekonomike dhe programeve – Viti i ardhshëm 2025**

Programet	2025					Gjithsej
	Paga/Mëditje	Mallra/Shërbime	Komunali	Subvencion e	Investime Kapitale	
<b>Zyra e Kryetarit</b>	137.842.13	26.000.00		385.000.00		548.842.13
<b>Zyra e Kuvendit Komunal</b>	311.117.09	5.000.00				316.117.09
<b>Administrata dhe Personeli</b>	330.000.00	90.000.00			40.000.00	460.000.00
<b>Çështjet gjinore</b>	8.700.00	500.00		4.000.00		13.200.00
<b>Inspektimet</b>	64.734.72	42.000.00				106.734.72
<b>Buxheti dhe financat</b>	188.552.76	47.137.00	200.000.00			435.689.76
<b>Infrastruktura Publike</b>	18.529.48	330.692.00			663.000.00	1.012.221.48
<b>Zjarrfikësit dhe Inspektimet</b>	130.000.00	15.000.00				145.000.00
<b>Zyra Komunale për Komunitete</b>	33.000.00	8.000.00				41.000.00
<b>Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural</b>	54.000.00	15.000.00		231.000.00	140.000.00	440.000.00
<b>Kadastra dhe Gjeodezia</b>	73.000.00	20.000.00			12.000.00	105.000.00
<b>Planifikimi urban dhe mjedisi</b>	55.000.00	60.200.00			3.083.653.00	3.198.853.00
<b>Shëndetësia</b>	1.406.970.00	460.007.00	43.000.00		70.000.00	1.979.977.00
<b>Shërbimet sociale</b>	83.878.81	16.500.00	4.000.00		-	104.378.81
<b>Shërbimet rrezidenciale</b>	50.000.00	45.000.00	5.000.00		260.000.00	360.000.00
<b>Kultura, rinia dhe sporti</b>	93.500.00	49.500.00		120.000.00	50.000.00	313.000.00
<b>Arsimi dhe shkenca</b>	5.691.175.00	559.464.00	68.000.00	60.000.00	210.000.00	6.588.639.00
<b>Gjithsej</b>	<b>8.730.000.00</b>	<b>1.790.000.00</b>	<b>320.000.00</b>	<b>800.000.00</b>	<b>4.528.653.00</b>	<b>16.168.653.00</b>

**Tabela 9. Shpenzimet komunale sipas kategorive ekonomike dhe programeve - Vlerësimi 2026**

Programet	2026					Gjithsej
	Paga/Mëditje	Mallra/Shërbime	Komunali	Subvencione	Investime Kapitale	
<b>Zyra e Kryetarit</b>	143.355.82	27.000.00		402.000.00		572.355.82
<b>Zyra e Kuvendit Komunal</b>	323.561.77	6.000.00				329.561.77
<b>Administrata dhe Personeli</b>	373.200.00	90.000.00			85.000.00	548.200.00
<b>Çështjet gjinore</b>	9.048.00	500.00		5.000.00		14.548.00
<b>Inspektimet</b>	67.324.11	42.000.00				109.324.11
<b>Buxheti dhe financat</b>	203.394.87	48.500.00	205.600.00			457.494.87
<b>Infrastruktura Publike</b>	19.270.66	360.692.00			713.655.00	1.093.617.66
<b>Zjarrfikësit dhe Inspektimet</b>	145.200.00	20.000.00				165.200.00
<b>Zyra Komunale për Komunitete</b>	34.320.00	8.000.00		3.000.00		45.320.00
<b>Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural</b>	56.160.00	15.000.00		235.000.00	160.000.00	466.160.00
<b>Kadastra dhe Gjeodezia</b>	75.920.00	20.000.00			12.000.00	107.920.00
<b>Planifikimi urban dhe mjedisi</b>	57.200.00	64.537.00			3.338.000.00	3.459.737.00
<b>Shëndetësia</b>	1.493.248.80	465.007.00	45.000.00		80.000.00	2.083.255.80
<b>Shërbimet sociale</b>	87.233.97	17.000.00	4.000.00		-	108.233.97
<b>Shërbimet rrezidenciale</b>	52.000.00	45.000.00	5.000.00		20.000.00	122.000.00
<b>Kultura, rinia dhe sporti</b>	97.240.00	55.000.00		125.000.00	80.000.00	357.240.00
<b>Arsimi dhe shkenca</b>	5.928.822.00	559.464.00	70.000.00	70.000.00	210.000.00	6.838.286.00
<b>Gjithsej</b>	<b>9.166.500.00</b>	<b>1.843.700.00</b>	<b>329.600.00</b>	<b>840.000.00</b>	<b>4.698.655.00</b>	<b>16.878.455.00</b>

**Tabela 10. Shpenzimet komunale sipas kategorive ekonomike dhe programeve - Vlerësimi 2027**

Programet	2027					Gjithsej
	Paga/Mëditje	Mallra/Shërbime	Komunali	Subvencione	Investime Kapitale	
<b>Zyra e Kryetarit</b>	150.523.61	28.000.00		407.200.00		585.723.61
<b>Zyra e Kuvendit Komunal</b>	339.739.86	6.300.00				346.039.86
<b>Administrata dhe Personeli</b>	391.860.00	91.000.00			85.000.00	567.860.00
<b>Çështjet gjinore</b>	9.500.40	700.00		5.000.00		15.200.40
<b>Inspektimet</b>	70.690.31	43.000.00				113.690.31
<b>Buxheti dhe financat</b>	213.564.61	49.000.00	210.488.00			473.052.61
<b>Infrastruktura Publike</b>	20.234.19	387.974.00			836.642.00	1.244.850.19
<b>Zjarrfikësit dhe Inspektimet</b>	152.460.00	20.000.00				172.460.00
<b>Zyra Komunale për Komunitete</b>	36.036.00	8.000.00		3.000.00		47.036.00
<b>Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural</b>	58.968.00	15.000.00		250.000.00	180.000.00	503.968.00
<b>Kadastra dhe Gjeodezia</b>	79.716.00	21.500.00			12.000.00	113.216.00
<b>Planifikimi urban dhe mjedisi</b>	60.060.00	64.537.00			3.420.000.00	3.544.597.00
<b>Shëndetësia</b>	1.567.911.24	480.000.00	45.000.00		85.000.00	2.177.911.24
<b>Shërbimet sociale</b>	91.595.66	17.000.00	3.000.00		-	111.595.66
<b>Shërbimet rrezidenciale</b>	54.600.00	45.000.00	6.000.00		20.000.00	125.600.00
<b>Kultura, rinia dhe sporti</b>	102.102.00	57.000.00		125.000.00	80.000.00	364.102.00
<b>Arsimi dhe shkenca</b>	6.225.263.10	565.000.00	75.000.00	75.000.00	210.000.00	7.150.263.10
<b>Gjithsej</b>	<b>9.624.825.00</b>	<b>1.899.011.00</b>	<b>339.488.00</b>	<b>865.200.00</b>	<b>4.928.642.00</b>	<b>17.657.166.00</b>

Kategoria Ekonomike – Investimet Kapitale - e prezantuar në detaje më poshtë paraqet një komponentë të rëndësishme të buxhetit të komunës e cila ndonëse nuk përfaqëson pjesën më të madhe të shpenzimeve të përgjithshme buxhetore, mbetet me rëndësi të posaqme në aspektin e planifikimit gjithëpërfshirës, për Komunën e Klinës. Kjo kategori e shpenzimeve në kuadër të shpenzimeve të rregullta buxhetore, ka potencialin më të madh për të nxitur rritjen ekonomike. Andaj, kjo kategori e shpenzimeve, edhe gjatë periudhës së ardhshme afatmesme, do të vazhdojë të jetë në funksion të krijimit të ambientit më të favorshëm për ngritje të pjesëmarrjes së sektorit privat, përmes përmirësimit të vazhdueshëm të infrastrukturës. Në këtë kontekst përmirësimi i infrastrukturës do të pozicionojë ekonominë e Komunës së Klinës në një rrugë të rritjes më të shpejtë dhe të qëndrueshme ekonomike në periudhë afatgjatë.

### Projektet me prioritet për vitin 2025

	<b>Emri i projektit</b>	<b>Totali</b>	<b>10</b>	<b>21</b>
1	Rindërtimi i rrugëve të Qytetit të Klinës me segmente të tyre: S Rexhepi, M Daka, F Elezaj, M Haxhaj, L Palucaj, H Prishtina, I Qemajli, F Bojaj etj	340.000.00	250.000.00	90.000.00
2	Ndërtimi i rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore në Klinë	130.000.00	90.000.00	40.000.00
3	Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në Komunën e Klinës	20.000.00	20.000.00	
4	Bashkëfinancim me donatorë	468.653.00	418.653.00	50.000.00
5	Ndërtimi i rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore Videje-Polce-Paskalicë-Jagodë-Krushevë e Madhe	80.000.00	60.000.00	20.000.00
6	Ndërtimi i segmenteve të rrugës Mal Bashota, Dositej Obradović, Bekim Fehmiu dhe infrastrukturës nëntokësore në Klinë-Dersnik-Dollc	600.000.00	450.000.00	150.000.00
7	Ndërtimi i rrugëve (Trotuare) dhe infrastrukturës nëntokësore në Zajmë-Deiq	45.000.00	30.000.00	15.000.00
8	Ndërtimi i rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore Poterq- Dugajevë-Drenovce	120.000.00	90.000.00	30.000.00
9	Ndërtimi i rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore Zllakuqan-Pataqan-Berkove	80.000.00	60.000.00	20.000.00
10	Ndërtimi i rrugëve dhe riparimi i rrugës Klinë-Shtupel-Kërnice	170.000.00	140.000.00	30.000.00
11	Ndërtimi i kanalizimit në Shtupel-Kërnice-Binxhe-Gracë	60.000.00	40.000.00	20.000.00
12	Ndërtimi i rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore Volljakë-Sferke-Qupeve	180.000.00	130.000.00	50.000.00
13	Ndërtimi i rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore Cerovik-Qabiq	15.000.00		15.000.00
14	Asfaltimi i rrugëve Ranoc - Leskoc	30.000.00	30.000.00	-
15	Asfaltimi i rrugëve Sigevë-Ujmirë-Shtaricë	35.000.00	15.000.00	20.000.00
16	Ndërtimi i rrugëve dhe ures në Budisalcë-Rudice	20.000.00	10.000.00	10.000.00
17	Ndërtimi i rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore Gllarevë-Rixheve-Stapanice-Zabergje	75.000.00	55.000.00	20.000.00

18	Ndërtimi i rrugëve dhe infrastruktures nëntokësore Gjurgjevik i Vogel-Klinavc	50.000.00	30.000.00	20.000.00
19	Ndërtimi i rrugëve e infrastruktures nëntokësore Grabanicë-Bokshiq-Dollove	100.000.00	80.000.00	20.000.00
20	Ndërtimi i rrugëve e infrastruktures nëntokësore Gjurgjevik i Madhë	70.000.00	50.000.00	20.000.00
21	Rregullimi i shtratit të lumit Lumëbardhi i Pejës	20.000.00	10.000.00	10.000.00
22	Rregullimi i shtratit të lumit Drini i Bardhë	20.000.00	10.000.00	10.000.00
23	Ndërtimi i shtratit të lumit Klina, Lagja Arbëri, Burimi i Jarinës - Pogragjë	50.000.00	30.000.00	20.000.00
24	Ndërtimi i shtigjeve te ecjes dhe infrastrukture rrugore në Gryken e Jarines-Pogragje	30.000.00	15.000.00	15.000.00
25	Ndërtimi i rrugëve dhe infrastruktures nëntokësore në Jashanicë-Jelloc-Resnik	170.000.00	120.000.00	50.000.00
26	Ndërtimi i kanalit kullues të ujit nga Gryka e Jarinës - Dersnik - Arbëri	0.00		
27	Ndërtimi i rrugës Shpella e Azem Bejtes-Përqevë	35.000.00	20.000.00	15.000.00
28	Ndërtimi i rrugëve dhe infrastruktures nëntokësore në Gremnik-Qupevë e Ulët	20.000.00	10.000.00	10.000.00
29	Ndërtimi i infrastruktures nëntokësoredhe mbitokësore Qeskovë-Këpuz-Rastoka	50.000.00	30.000.00	20.000.00
	<b>Urbanizmi</b>	<b>3.083.653.00</b>	<b>2.293.653.00</b>	<b>790.000.00</b>
30	Mirëmbajtja e drunjëve dekorativ në rrugët e qytetit		Mallra e sherbime	
31	Zgjerimi i sipërfaqeve të gjelbruara (Parqeve)	50.000.00	30.000.00	20.000.00
32	Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik	220.000.00	170.000.00	50.000.00
33	Rindërtimi i infrast mbitok me asfalt në Jashanicë, Shtupel, Zllakuqan, Klinë-Videj etj	160.000.00	130.000.00	30.000.00
34	Mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit		Mallra e sherbime	
35	Mirëmbajtja e rrjetit te Kamerave te qytetit		Mallra e sherbime	
36	Ndërtimi i impianteve për trajtimin e ujrave të zeza	100.000.00		100.000.00
37	Blerja e kamionit me eskavator për pastrim të ambientit në Klinë	10.000.00		10.000.00
38	Ndërtimi i rrethojave të vorrezave në Komunën e Klinës dhe mirëmbajtja e tyre	123.000.00	93.000.00	30.000.00
	<b>Infrastruktura rrugore</b>	<b>663.000.00</b>	<b>423.000.00</b>	<b>240.000.00</b>
39	Shenjzimi horizontal dhe vertikal i rrugëve		Mallra e sherbime	
40	Rrënimi i objekteve te vjetra dhe ndërtimeve pa leje		Mallra e sherbime	
	<b>Inspeksioni</b>	-	-	-
41	Rindërtimi i objekteve shkollore dhe fushave sportive në Komunën e Klinës	210.000.00	150.000.00	60.000.00
42	Furnizim me inventar ne shkolla		Mallera e sherbime	

	<b>Arsimi</b>	<b>210.000.00</b>	<b>150.000.00</b>	<b>60.000.00</b>
43	Furnizim me pajisje mjekësore	40.000.00	40.000.00	-
44	Ndërtimi i shtëpisë për persona të moshuar	260.000.00	210.000.00	50.000.00
45	Ndërtimi dhe renovimi i objekteve shëndetësore	30.000.00	20.000.00	10.000.00
	<b>Shendetësia</b>	<b>330.000.00</b>	<b>270.000.00</b>	<b>60.000.00</b>
46	Ndërtimi dhe renovimi i objekteve komunale	40.000.00	40.000.00	-
47	Blerja e veturave zyrtare	0.00		
48	Digjitalizimi i lëndës arkivore	Mallra e sherbime		
	<b>Administrata</b>	<b>40.000.00</b>	<b>40.000.00</b>	<b>-</b>
49	Ndërtimi dhe rindërtimi i objekteve sportive e të kulturës	50.000.00	50.000.00	
	<b>Kultura</b>	<b>50.000.00</b>	<b>50.000.00</b>	<b>-</b>
50	Furnizim me pajisje gjeodezike	12.000.00		12.000.00
	<b>Gjeodezia</b>	<b>12.000.00</b>	<b>-</b>	<b>12.000.00</b>
51	Ndërtimi i kanaleve te ujitjes	140.000.00	100.000.00	40.000.00
	Shtrimi i rrugëve fushore me zhavor dhe pastrimi i rrjedhave ujore	Mallra e sherbime		
	<b>Bujqesia</b>	<b>140.000.00</b>	<b>100.000.00</b>	<b>40.000.00</b>
	<b>Totali :</b>	<b>4.528.653.00</b>	<b>3.326.653.00</b>	<b>1.202.000.00</b>

### Projektet me prioritet për vitin 2026

Emri i projektit	Totali	10	21
1 Rindërtimi i rrugëve te Qytetit te Klines me segmente te tyre: S Rexhepi, M Daka, F Elezaj, M Haxhaj, L Palucaj, H Prishtina, I Qemajli, F Bojaj etj	120.000.00	80.000.00	40.000.00
2 Ndërtimi i rrugëve e infrastruktures nëntokësore në Klinë	120.000.00	80.000.00	40.000.00
3 Ndërtimi i rrjetit te ujësjellësit në Komunen e Klinës	50.000.00	50.000.00	
4 Rregullimi i shtratit te lumit Klina	250.000.00	150.000.00	100.000.00
5 Bashkëfinancim me donatorë	300.000.00	200.000.00	100.000.00
6 Ndërtimi i rrugëve e infrastruktures nëntokësore Videje-Polce-Paskalicë-Jagodë-Krushevë e Madhe	100.000.00	70.000.00	30.000.00



7	Ndërtimi i segmenteve të rrugës Mal Bashota, Dositej Obradoviç, Bekim Fehmiu dhe infrastruktures nentokësore në Klinë-Dersnik-Dollc	288.000.00	188.000.00	100.000.00
8	Ndërtimi i rrugëve e infrastruktures nëntokësore Poterçe-Dugajevë-Drenovce	120.000.00	100.000.00	20.000.00
9	Ndërtimi i rrugëve e infrastruktures nëntokësore Zllakuqan-Pataqan-Berkove	100.000.00	70.000.00	30.000.00
10	Ndërtimi i rrugëve dhe riparimi i rrugës Klinë-Shtupel-Binxhë	150.000.00	100.000.00	50.000.00
11	Ndërtimi i rrugëve e infrastruktures nëntokësore Volljakë-Sferkë-Qupevë	100.000.00	80.000.00	20.000.00
12	Ndërtimi i rrugëve e infrastruktures nëntokësore Qabiq-Cerovik	80.000.00	80.000.00	
13	Ndërtimi i rrugëve e infrastruktures nëntokësore Leskoc-Ranoc	50.000.00	50.000.00	
14	Ndërtimi i kanalizimit në Shtupel-Kërrnicë-Binxhe-Grapçë	70.000.00	60.000.00	10.000.00
15	Ndërtimi i rrugëve (Trotuare) dhe infrastruktures nëntokësore në Zajmë-Deiq	350.000.00	300.000.00	50.000.00
16	Ndërtimi i rrugëve e infrastruktures nëntokësore Ujemir-Shtaricë-Siqevë	60.000.00	60.000.00	
17	Rregullimi i shtratit te lumit Drini i Bardhë	80.000.00	50.000.00	30.000.00
18	Rregullimi i shtratit te lumit Lumëbardhi i Pejës	30.000.00		30.000.00
19	Ndërtimi i shtratit të lumit Klina, Lagja Arbëri, Burimi i Jarinës - Pogragjë	250.000.00	200.000.00	50.000.00
20	Ndërtimi shtigjeve te ecjes dhe infrastrukture rrugore ne Gryken e Jarines-Pogragje	80.000.00	50.000.00	30.000.00
21	Ndërtimi i rrugëve e infrastruktures nëntokësore Gllarevë-Rixheve-Stapanice-Zabergje	120.000.00	70.000.00	50.000.00
22	Ndërtimi i rrugëve e infrastruktures nëntokësore Grabanicë-Bokshiq-Dollove	100.000.00	80.000.00	20.000.00
23	Ndërtimi i parkut industrial per Kline	10.000.00		10.000.00
24	Ndërtimi i kanalit kullues të ujit nga Gryka e Jarinës - Dersnik - Arbëri	10.000.00		10.000.00
25	Ndërtimi i rrugëve e infrastruktures nëntokësore Gjurgjevik i Vogel-Klinavc	80.000.00	70.000.00	10.000.00
26	Ndërtimi i rrugëve e infrastruktures nëntokësore Jashanicë-Jelloc-Resnik	90.000.00	60.000.00	30.000.00
27	Ndërtimi i rrugëve dhe infrastruktures nëntokësore në Gremnik-Qupevë e Ulët	50.000.00	30.000.00	20.000.00
28	Ndërtimi i rrugës Shpella e Azem Bejtes-Përçevë	130.000.00	100.000.00	30.000.00
	<b>Urbanizmi</b>	<b>3.338.000.00</b>	<b>2.428.000.00</b>	<b>910.000.00</b>
29	Mirëmbajtja e drunjëve dekorativ në rrugët e qytetit	Mallra e sherbime		

30	Zgjerimi i sipërfaqeve të gjelbruara	120.000.00	90.000.00	30.000.00
31	Zgjerimi i rrjetit te ndriçimit publik	223.655.00	173.655.00	50.000.00
32	Rindërtimi i infrastrukturës mbitokësore me asfalt në Jashanicë, Shtupel, Zllakuqan, Klinë-Videjë etj	200.000.00	150.000.00	50.000.00
33	Mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit	Mallra e sherbime		
34	Mirëmbajtja e rrjetit te Kamerave te qytetit	Mallra e sherbime		
35	Ndërtimi i impianteve për trajtimin e ujrave të zeza	20.000.00	15.000.00	5.000.00
36	Ndërtimi i rrethojave të vorrezave në Komunën e Klinës	150.000.00	80.000.00	40.000.00
	<b>Infrastruktura rrugore</b>	<b>713.655.00</b>	<b>508.655.00</b>	<b>175.000.00</b>
37	Shenjzimi horizontal dhe vertikal i rrugëve	Mallra e sherbime		-
38	Rrënimi i objekteve te vjetra dhe ndërtimeve pa leje	Mallra e sherbime		
	<b>Inspeksioni</b>	-	-	-
39	Rindërtimi I objekteve shkollore dhe fushave sportive ne Komunen e Klines	210.000.00	150.000.00	60.000.00
40	Furnizim me inventar ne shkolla	Mallra e sherbime	-	
	<b>Arsimi</b>	<b>210.000.00</b>	<b>150.000.00</b>	<b>60.000.00</b>
41	Furnizim me pajisje mjekësore	50.000.00	50.000.00	
42	Ndërtimi i shtëpisë për persona të moshuar	20.000.00	20.000.00	
43	Ndërtimi dhe renovimi i objekteve shëndetësore	30.000.00	30.000.00	-
	<b>Shendetësia</b>	<b>100.000.00</b>	<b>100.000.00</b>	-
44	Rindërtimi I objektit komunal ne Klinë	50.000.00	50.000.00	
45	Blerja e veturave zyrtare	35.000.00	35.000.00	
46	Digjitalizimi i lëndës arkivore	Mallra e sherbime		
	<b>Administrata</b>	<b>85.000.00</b>	<b>85.000.00</b>	-
47	Furnizim me pajisje gjeodezike	12.000.00		12.000.00
	<b>Gjeodezia</b>	<b>12.000.00</b>	-	<b>12.000.00</b>
48	Ndërtimi dhe rindërtimi i objekteve sportive e të kulturës	80.000.00	60.000.00	20.000.00

	<b>Kultura</b>	<b>80.000.00</b>	<b>60.000.00</b>	<b>20.000.00</b>
49	Ngritja e serave me participim	Subvencione		
50	Furnizim me fidane te pemëve te imëta:mjedër,dredhëza dhe manaferrë	Subvencione		
51	Ngritja e tufave te dhive me participim	Subvencione		
52	Furnizim me pemë arnore me participim	Subvencione		
53	Ndërtimi I kanaleve te ujitjes	160.000.00	120.000.00	40.000.00
54	Fondi emergjent			
	<b>Bujqesia</b>	<b>160.000.00</b>	<b>120.000.00</b>	<b>40.000.00</b>
	<b>Totali :</b>	<b>4.698.655.00</b>	<b>3.451.655.00</b>	<b>1.205.000.00</b>

**Projektet me prioritet për vitin 2027**

<b>Emri i projektit</b>	<b>Totali</b>	<b>10</b>	<b>21</b>
1 Rindërtimi i rrugëve te Qytetit te Klines me segmente te tyre: S Rexhepi, M Daka, F Elezaj, M Haxhaj, L Palucaj, H Prishtina, I Qemajli, F Bojaj etj	270.000.00	170.000.00	100.000.00
2 Ndërtimi i rrugëve e infrastruktures nëntokësore Klinë	130.000.00	80.000.00	50.000.00
3 Ndërtimi i rrugëve e infrastruktures nëntokësore Cerovik-Qabiq	100.000.00	80.000.00	20.000.00
4 Ndërtimi i rrugëve (Trotuare) dhe infrastruktures nëntokësore në Zajmë-Deiq	120.000.00	70.000.00	50.000.00
5 Ndërtimi i segmenteve të rrugës Mal Bashota, Dositej Obradoviq, Bekim Fehmiu dhe infrastruktures nëntokësore në Klinë-Dersnik-Dollc	350.000.00	250.000.00	100.000.00
6 Ndërtimi i rrugëve dhe ures në Budisalcë-Rudice	70.000.00	50.000.00	20.000.00
7 Ndërtimi i rrugëve e infrastruktures nëntokësore Videje-Polce-Paskalicë-Jagodë-Krushevë e Madhe	120.000.00	80.000.00	40.000.00
8 Ndërtimi i rrugëve e infrastruktures nëntokësore Gjurgjevik i Vogel-Klinavc	70.000.00	50.000.00	20.000.00
9 Ndërtimi i rrugëve e infrastruktures nëntokësore Gllarevë-Rixheve-Stapanice-Zabergje	100.000.00	80.000.00	20.000.00
10 Ndërtimi i rrugëve dhe rindërtimi i rrugës Kline-Shtupel-Kërnice	150.000.00	120.000.00	30.000.00
11 Ndërtimi i rrugëve e infrastruktures nëntokësore Grabanicë-Bokshiq-Dollove	120.000.00	100.000.00	20.000.00
12 Ndërtimi i rrugëve dhe infrastruktures nëntokësore në Gremnik-Qupevë e Ulët	50.000.00	30.000.00	20.000.00
13 Ndërtimi i rrugëve e infrastruktures nëntokësore Jashanicë-Jelloc-Resnik-Pogragjë	150.000.00	100.000.00	50.000.00
14 Ndërtimi i rrugëve e infrastruktures nëntokësore Siqevë-Ujmirë-Shtarice	55.000.00	40.000.00	15.000.00
15 Ndërtimi i kanalizimit në Shtupel-Kërnice-Binxhe-Grapce	50.000.00	30.000.00	20.000.00
16 Ndërtimi i rrugëve e infrastruktures nëntokësore Sferkë-Volljake-Qupeve	100.000.00	80.000.00	20.000.00
17 Ndërtimi i rrugëve e infrastruktures nëntokësore Qeskovë-Këpuz	30.000.00	30.000.00	-
18 Ndërtimi i rrugëve e infrastruktures nëntokësore Ranoc - Leskoc	25.000.00	25.000.00	-
19 Ndërtimi i rrjetit te ujësjellësit në Komunën e Klinës	20.000.00		20.000.00
20 Bashkëfinancim me donatorë	450.000.00	300.000.00	150.000.00

21	Ndërtimi i liqenit akumulues për furnizim me ujë të pijes	50.000.00	30.000.00	20.000.00
22	Ndërtimi i shtratit te lumit Drini i Bardhë	50.000.00	50.000.00	-
23	Ndërtimi i shtratit te lumit Lumëbardhi i Pejës	50.000.00	50.000.00	
24	Ndërtimi i shtratit të lumit Klina, Lgja Arbëri, Burimi i Janrinës - Pogragjë	250.000.00	200.000.00	50.000.00
25	Ndërtimi shtigjeve te ecjes dhe infrastrukture rrugore ne Gryken e Jarines-Pogragjë	75.000.00	30.000.00	45.000.00
26	Ndërtimi i rrugëve e infrastruktures nëntokësore Gjurgjevik i Madhë	50.000.00	50.000.00	
27	Ndërtimi i rrugëve e infrastruktures nentokesore ne Perqeve	20.000.00	20.000.00	
28	Ndërtimi i rrugëve dhe infrastruktures nentokesore Zllakuqan-Pataqan-Berkove	100.000.00	80.000.00	20.000.00
29	Asfaltimi i rrugëve dhe infrastruktures nentokesore Krusheve e Vogel	45.000.00	45.000.00	-
30	Studimi i fisibilitetit per ndertimin e ngrohjes qendrore ne qytetin e Klines	Mallëra dhe shërbime		
31	Ndërtimi i rrugës Shpella e Azem Bejtes-Përqevë	100.000.00	70.000.00	30.000.00
32	Ndërtimi i rrugëve dhe infrastruktures nentokesore ne Poterqe-Dugajeve-Drenovce	100.000.00	70.000.00	30.000.00
	<b>Urbanizmi</b>	<b>3.420.000.00</b>	<b>2.460.000.00</b>	<b>960.000.00</b>
33	Ndërtimi i kanaleve te ujitjes	150.000.00	100.000.00	50.000.00
34	Shtrimi i rrugëve fushore me zhavor dhe pastrimi i rrjedhave ujore	30.000.00	30.000.00	
	Furnizim me mekanizem bujqesor per fermere	Subvencion		
	Ndërtimi i serave	Subvencion		
	<b>Bujqesia</b>	<b>180.000.00</b>	<b>130.000.00</b>	<b>50.000.00</b>
	Mirëmbajtja e drunjëve dekorativ në rrugët e qytetit	Mallra e shërbime		
35	Zgjerimi i sipërfaqeve të gjelbruara (Parqeve)	150.000.00	120.000.00	30.000.00
36	Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik	150.000.00	120.000.00	30.000.00
37	Rindërtimi i infrast mbitor me asfalt në Jashanicë, Shtupel, Zllakuqan, Klinë-Videj etj	150.000.00	100.000.00	50.000.00
	Mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit	Mallra e shërbime		
	Mirëmbajtja dhe zgjerimi i rrjetit te Kamerave te qytetit	Mallra e shërbime		
38	Ndërtimi i impianteve për trajtimin e ujrave të zeza	256.642.00	156.642.00	100.000.00
	Riparimi i kanalizimit ne Komunen e Klines	Mallra e shërbime		
39	Ndërtimi i rrethojave të vorrezave në Komunën e Klinës dhe mirëmbajtja e tyre	130.000.00	100.000.00	30.000.00
	Mirëmbajtja e rrugëve	Mallra e shërbime		
	<b>Infrastruktura rrugore</b>	<b>836.642.00</b>	<b>596.642.00</b>	<b>240.000.00</b>
40	Furnizim me pajisje mjekësore	50.000.00	30.000.00	20.000.00
41	Ndërtimi i shtëpisë për persona të moshuar	20.000.00	20.000.00	
42	Rindërtimi i objekteve shëndetësore	35.000.00	20.000.00	15.000.00
	<b>Shëndetësia</b>	<b>105.000.00</b>	<b>70.000.00</b>	<b>35.000.00</b>
	Shenjzimi horizontal dhe vertikal i rrugëve	Mallëra dhe shërbime		
	Rrënimi i objekteve te vjetra dhe ndërtimeve pa leje	Mallëra dhe shërbime		

	<b>Inspeksioni</b>	-	-	-
43	Ndërtimi dhe rindërtimi i objekteve komunale	50.000.00	50.000.00	-
44	Blerja e veturave zyrtare	35.000.00	20.000.00	15.000.00
	Zhvillimi i softverit për menagjim të autoparkut	Mallra e shërbime		
	Digjitalizimi i lëndës arkivore	Mallra e shërbime		
	<b>Administrata</b>	<b>85.000.00</b>	<b>70.000.00</b>	<b>15.000.00</b>
4 5	Furnizim me pajisje gjeodezike	12.000.00		12.000.00
	<b>Gjeodezia</b>	<b>12.000.00</b>	<b>-</b>	<b>12.000.00</b>
46	Ndërtimi dhe rindërtimi i objekteve sportive e të kulturës	80.000.00	55.000.00	25.000.00
	<b>Kultura</b>	<b>80.000.00</b>	<b>55.000.00</b>	<b>25.000.00</b>
47	Rindërtimi i objekteve shkollore dhe fushave sportive ne Komunen e Klines	210.000.00	160.000.00	50.000.00
	Furnizim me inventar ne shkolla	Mallra e shërbime	-	-
	<b>Arsimi</b>	<b>210.000.00</b>	<b>160.000.00</b>	<b>50.000.00</b>
	<b>Totali :</b>	<b>4.928.642.00</b>	<b>3.541.642.00</b>	<b>1.375.000.00</b>

### 3.5. Analiza Gjinore – Buxheti Gjinor

Komuna nuk ka përgatitur një buxhet të përgjegjshëm gjinor të detajuar, por është përpjekur për të vlerësuar se si shpenzimet kapitale janë ndarë për të adresuar çdo pabarazi gjinore në planifikimin e ardhshëm buxhetor. Ne kemi analizuar numrin e grave dhe burrave, djemve dhe vajzave në kuadër të komunës, dhe paraqesim këtë informacion në tabelën e mëposhtme:

**Tabela 11: Përqindja sipas gjinisë**

Kategoria	Shifrat sipas Regjistrimit të Popullsisë 2011	%
Meshkuj	19,193	49.86
Femra	19,303	50.14
Popullata e përgjithshme	38,496	100.00

Komuna i ka përdorur më pas të dhënat specifike gjinore që janë në dispozicion për të vlerësuar ndikimin gjinor të projekteve kapitale në kuadër të buxhetit të 2025-2027. Për shembull, kur një projekt është për qytet apo për një fshat, për një rrugë, gypat e ujësjellësit, për qendër shëndetësore etj. ne kemi përdorur të dhënat e

ndarjes së popullsisë në mes meshkujve dhe femrave për atë zonë. Kur një projekt është për një shkollë të veçantë ne kemi përdorur numrat e nxënësve: meshkuj dhe femra. Kur një projekt ndikon në tërë komunën (duke përfshirë projektet për administratën komunale) ne përdorim analizën e përgjithshme të popullsisë nga viti 2011.

**Tabela 12. Numri i përfituesëve në baza gjinore nga investimet kapitale në vitin 2025**

	Emri i porjektit	Totali	Nr.i perfituesve në baza gjinore			
			Meshkuj	Femra	Totali	Perqindja e femrave ne raport me meshkuj
1	Rindërtimi i rrugëve të Qytetit të Klinae me segmente të tyre: S Rexhepi, M Daka, F Elezaj, M Haxhaj, L Palucaj, H Prishtina, I Qemajli, F Bojaj etj	340,000.00	1010	1093	2103	51.97
2	Ndërtimi i rrugëve dhe infrastruktures nëntokësore në Klinë	130,000.00	19193	19303	38496	50.14
3	Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në Komunën e Klinës	20,000.00	19193	19303	38496	50.14
4	Bashkëfinancim me donatorë	468,653.00	19193	19303	38496	50.14
5	Ndërtimi i infrastruktures nëntokësore dhe mbitorësore Videje-Polce-Paskalice-Jagode-Krusheve e Madhe	80,000.00	748	597	1345	44.39
6	Ndërtimi i segmenteve të rrugës Mal Bashota, Dositej Obradoviq, Bekim Fehmiu dhe infrastruktures nëntokësore në Klinë-Dersnik-Dollc	600,000.00	3749	3834	7583	50.56
7	Ndërtimi i rrugëve (Trotuare) dhe infrastruktures nëntokësore në Zajmë-Deiq	45,000.00	800	843	1643	51.31
8	Ndërtimi i rrugëve dhe infrastruktures nëntokësore Poterq- Dugajevë-Drenovce	120,000.00	1175	1232	2407	51.18
9	Ndërtimi i rrugëve dhe infrastruktures nëntokësore Zllakuqan-Pataqan-Berkove	80,000.00	446	460	906	50.77
10	Ndërtimi i rrugëve dhe riparimi i rrugës Klinë-Shtupel-Kërnice	170,000.00	3480	3627	7107	51.03
11	Ndërtimi i kanalizimit në Shtupel-Kërnice-Binxhe-Gracë	60,000.00	3480	3627	7107	51.03
12	Ndërtimi i rrugëve dhe infrastruktures nëntokësore Volljakë-Sferke-Qupevë	180,000.00	2005	1951	3956	49.32
13	Ndërtimi i rrugëve dhe infrastruktures nëntokësore Cerovik-Qabiq	15,000.00	1010	1093	2103	51.97
14	Asfaltimi i rrugëve Ranoc - Leskoc	30,000.00	303	289	592	48.82
15	Asfaltimi i rrugëve Sipevë-Ujmirë-Shtaricë	35,000.00	933	339	1272	26.65
16	Ndërtimi i rrugëve dhe ures në Budisalcë-Rudice	20,000.00	441	403	844	47.75
17	Ndërtimi i rrugëve dhe infrastruktures nëntokësore Gllarevë-Rixheve-Stapanice-Zabergje	75,000.00	1653	1729	3382	51.12
18	Ndërtimi i rrugëve dhe infrastruktures nëntokësore Gjurgjevik i Vogel-Klinavc	50,000.00	605	620	1225	50.61
19	Ndërtimi i rrugëve e infrastruktures nëntokësore Grabanicë-Bokshiq-Dollove	100,000.00	795	810	1605	50.47

20	Ndërtimi i rrugëve e infrastruktures nëntokësore Gjurgjevik i Madhë	70,000.00	235	219	454	48.24
21	Rregullimi i shtratit të lumit Lumëbardhi i Pejës	20,000.00	795	810	1605	50.47
22	Rregullimi i shtratit të lumit Drini i Bardhë	20,000.00	795	810	1605	50.47
23	Ndërtimi i shtratit të lumit Klina, Lagja Arbëri, Burimi i Jarinës - Pogragjë	50,000.00	1202	1126	2328	48.37
24	Ndërtimi i shtigjeve te ecjes dhe infrastrukture rrugore në Gryken e Jarines-Pogragje	30,000.00	1112	1038	2150	48.28
25	Ndërtimi i rrugëve dhe infrastruktures nëntokësore në Jashanicë-Jelloç-Resnik	170,000.00	1154	1056	2210	47.78
26	Ndërtimi i kanalit kullues të ujit nga Gryka e Jarinës - Dersnik -Arbëri	0.00	2328	2226	4554	48.88
27	Ndërtimi i rrugës Shpella e Azem Bejtes-Përqevë	35,000.00	488	517	1005	51.44
28	Ndërtimi i rrugëve dhe infrastruktures nëntokësore në Gremnik-Qupevë e Ulët	20,000.00	890	820	1710	47.95
29	Ndërtimi i infrastruktures nëntokësore dhe mbitokësore Qeskovë-Këpuz-Rastoka	50,000.00	507	488	995	49.05
	<b>Urbanizmi</b>	<b>3,083,653.00</b>				
30	Mirëmbajtja e drunjëve dekorativ në rrugët e qytetit	Mallra e sherbime				
31	Zgjerimi i sipërfaqeve të gjelbruara (Parqeve)	50,000.00	19193	19303	38496	50.14
32	Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik	220,000.00	19193	19303	38496	50.14
33	Rindërtimi i infrast mbitok me asfalt në Jashanicë, Shtupel, Zllakuqan, Klinë-Videj etj	160,000.00	19193	19303	38496	50.14
34	Mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit	Mallra e sherbime				
35	Mirëmbajtja e rrjetit te Kamerave te qytetit	Mallra e sherbime				
36	Ndërtimi i impianteve për trajtimin e ujrave të zeza	100,000.00	19193	19303	38496	50.14
37	Blerja e kamionit me eskavator për pastrim të ambientit në Klinë	10,000.00	19193	19303	38496	50.14
38	Ndërtimi i rrethojave të vorrezave në Komunën e Klinës dhe mirëmbajtja e tyre	123,000.00	19193	19303	38496	50.14
	<b>Infrastruktura rrugore</b>	<b>663,000.00</b>				
39	Shenjzimi horizontal dhe vertikal i rrugëve	Mallra e sherbime				
40	Rrënimi i objekteve te vjetra dhe ndërtimeve pa leje	Mallra e sherbime				
	<b>Inspeksioni</b>	-				
41	Rindërtimi i objekteve shkollore dhe fushave sportive në Komunën e Klinës	210,000.00	19193	19303	38496	50.14
42	Furnizim me inventar ne shkolla	Mallera e sherbime				
	<b>Arsimi</b>	<b>210,000.00</b>				
43	Furnizim me pajisje mjekësore	40,000.00	19193	19303	38496	50.14
44	Ndërtimi i shtëpisë për persona të moshuar	260,000.00	19193	19303	38496	50.14
45	Ndërtimi dhe renovimi i objekteve shëndetësore	30,000.00	19193	19303	38496	50.14
	<b>Shendetësia</b>	<b>330,000.00</b>				

46	Ndërtimi dhe renovimi i objekteve komunale	40,000.00	19193	19303	38496	50.14
47	Blerja e veturave zyrtare	0.00				
48	Digjitalizimi i lëndës arkivore	Mallra e shërbime				
	<b>Administrata</b>	<b>40,000.00</b>				
49	Ndërtimi dhe rindërtimi i objekteve sportive e të kulturës	50,000.00	19193	19303	38496	50.14
	<b>Kultura</b>	<b>50,000.00</b>				
50	Furnizim me pajisje gjeodezike	12,000.00	19193	19303	38496	50.14
	<b>Gjeodezia</b>	<b>12,000.00</b>				
51	Ndërtimi i kanaleve të ujitjes	140,000.00	19193	19303	38496	50.14
	Shërimi i rrugëve fushore me zhavor dhe pastrimi i rrjedhave ujore	Mallra e shërbime				
	<b>Bujqësia</b>	<b>140,000.00</b>				
	<b>Totali :</b>	<b>4,528,653.00</b>				

**Tabela 13. Paga dhe mëditje sipas bazës gjinore**

Programet	2025		
	Total Paga/Mëditje	Pagat meshkuj	Pagat femrat
Zyra e Kryetarit	137,842.13	100,390.23	37,451.91
Zyra e Kuvendit Komunal	311,117.09	153,189.28	157,927.81
Administrata dhe Personeli	330,000.00	232,231.36	97,768.64
Çështjet gjinore	8,700.00	-	8,700.00
Inspektimet	64,734.72	-	64,734.72
Buxheti dhe financat	188,552.76	72,973.09	115,579.67
Infrastruktura Publike	18,529.48	-	18,529.48
Zjarrfikësit dhe Inspektimet	130,000.00	-	130,000.00
Zyra Komunale për Komunitete	33,000.00	21,848.40	11,151.60
Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	54,000.00	-	54,000.00
Kadastra dhe Gjeodezia	73,000.00	57,495.12	15,504.88
Planifikimi urban dhe mjedisi	55,000.00	37,434.51	17,565.49
Shëndetësia	1,406,970.00	697,283.26	709,686.74
Shërbimet sociale	83,878.81	55,829.08	28,049.73
Shërbimet rrezidenciale	50,000.00	30,000.00	20,000.00
Kultura, rinia dhe sporti	93,500.00	69,916.79	23,583.21
Arsimi dhe shkenca	5,691,175.00	2,907,396.94	2,783,778.06
<b>TOTALI</b>	<b>8,730,000.00</b>	<b>4,435,988.06</b>	<b>4,294,011.94</b>





Fig.Tab.13 Paga dhe meditje sipas bazës gjinore

#### IV. Korniza e Performancës së Shpenzimeve

Indikatorët/treguesit si matës të performancës janë hartuar në konsultim dhe me kontributin e drejtorëve / drejtoreshave kryesor të programeve komunale. Indikatorët apo treguesit e më poshtëm të performancës janë hartuar karshi fushave dhe objektivave prioritare të Komunës për periudhën afatmesme 2025-2027 (të renditur në fillim të këtij dokumenti) dhe në këtë mënyrë janë dhënë vlerat matëse. Njësia matëse e treguesve është e ndryshme dhe më poshtë ka një ndërthurje të treguesve cilësorë me treguesit sasiorë.

Më poshtë do jepet ndarja e synimeve (objektivave strategjike) në objektiva dhe për secilin nga objektivat do paraqiten treguesit e performancës të cilët bëjnë të mundur që të matet realizimi i objektivit përkatës.

Së fundi në tabelat e mëposhtme përveq synimeve strategjike, objektivave përkatëse dhe treguesve matës, janë paraqitur edhe vlerat buxhetore ose shpenzimet që janë paraparë karshi realizimit të këtyre synime. Vëreni se vlerat e përshkruara në formë tabelare përfshijnë kryesisht kategorinë ekonomike – investime kapitale – ndonëse komuna planifikon edhe shpenzime në katër kategoritë tjera ekonomike që lidhen me këto synime. Përfshijra edhe e kësaj pjese buxhetore (përveq buxhetit kapital) do të provohet të bëhet në ciklet e tjera buxhetore si fazë e dytë e avancimit tutje të matësve të performancës në buxhetin afatmesëm komunal.

**1. Zhvillimi ekonomik për të gjithë qytetarët (gra, burra, vajza dhe djem)**

<b>OBJEKTIVAT STRATEGJIKE TE KOMUNES</b>	<b>Indikatorët për Matjen e Performancës në drejtim të përmbushjes së Objektivave</b>	<b>2024</b>	<b>2025</b>	<b>2026</b>	<b>2027</b>
<b>Ndërmarrësia – zhvillimi i NVM</b>	Numri i NVM që përfitojnë nga përmirësimi i infrastrukturës rrugore , ligjore dhe lehtësimit të procedurave administrative rreth regjistrimit të bizneseve.	2356	2586	2890	2950
	Numri i NVM që përfitojnë nga ndarja e mjetëve për përkrahjen e NVM	20	25	30	35
<b>Zhvillimi i bujqësisë – mbështetje e sektorit bujqësor dhe blegtoral</b>	Rritja e sipërfaqes së tokave që do të ujitet	45	50	53	53
	Numri i fermerëve/fermereve ( ekonomive familjare ) që përfitojnë nga projektet në bujqësi .	320	350	365	385
	Rritja e siperfaqeve bujqësore në sera në hektar	13,5	17	20	26
	% e rritjes së rendimenteve për ha	20%	25%	28%	29%
<b>Zhvillimi i turizmit dhe trashëgimisë kulturore</b>	Rritja e sipërfaqeve të pyllëzuara dhe hapësirave të gjelbëruara në %	35%	40%	42%	43%
	Rritja e numrit të vizitorve	800	1000	1000	1200
	Rritja e mirëqenës së ekonomive familjare në %	30%	35%	37%	39%

Për synimin e parë, Komuna e Klinës ka identifikuar tri objektiva, të cilët kanë të bëjnë me sektorin e bujqësisë, kulturës dhe urbanizmit . Në realizimin e këtyre objektivave janë përfshirë Drejtoria për Bujqësi , Drejtoria e Urbanizmit dhe Drejtoria e shërbimeve publike. Buxheti total (kategoria ekonomike – investime kapitale dhe subvencione) në dispozicion të Synimit të parë jepet në tabelën e mëposhtme.

	Burimet buxhetore (000 Euro)			
	2024	2025	2026	2027
Synimi (Objektivi strategjik): <b>Zhvillimi ekonomik</b>	2831	3127	3490	3585
Objektivi 1: Ndërmarrësia – zhvillimi i NVM	2356	2586	2890	2950
Objektivi 2: Zhvillimi i bujqësisë- mbështetje e sektorit bujqësor dhe blegtoral	320	371	395	430
Objektivi 3: Zhvillimi i turizmit dhe trashëgimisë kulturore	155	170	205	205

**2. Zhvillimi i infrastrukturës së nevojshme në funksion të qytetarëve (gra, burra, vajza dhe djem) dhe bizneseve**

<b>OBJEKTIVAT STRATEGJIKE TE KOMUNES</b>	<b>Indikatorët për Matjen e Performancës në drejtëm të përbushjes së Objektivave</b>	<b>2024</b>	<b>2025</b>	<b>2026</b>	<b>2027</b>
<b>Rritja e nivelit të shërbimeve administrative për biznese dhe qytetar</b>	Koha e pritjes për shërbime	6 min.	5 min.	4 min	4 min
	Numri i banorëve (19303 gra dhe 19193 burra) të komunës që i marrin shërbimet nga zyrat e gjendjes civile	40000	41000	42000	425000
	Koha mesatare për lëshimin e certifikatave të gjendjes civile	6 min/ për copë	5 min/ për copë	4 min/ për copë	4 min/ për copë
<b>Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatra</b>	Përqindja e familjeve dhe bizneseve në zonën urbane të lidhura me rrjetin e ujësjellësit	98	98	98	98
	Përqindja e familjeve dhe bizneseve në zonën rurale të lidhura me rrjetin e ujësjellësit	92	93	94	96
	Numri i vendbanimeve të reja të lidhura me rrjetin e ujësjellësit				
	Orë ujë të pijshëm në ditë/ Furnizimi me ujë të pijshëm në ditë	24	24	24	26
<b>Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit në fshatra</b>	Numri i venbanimeve të reja të lidhura me rrjetin e kanalizimeve				
	Përqindja e familjeve dhe bizneseve në zonën urbane të lidhura me rrjetin e kanalizimit	95	95	95	97
	Përqindja e familjeve dhe bizneseve në zonën rurale të lidhura me rrjetin e kanalizimit	92	94	96	98

<b>Zgjerimi i infrastrukturës rrugore</b> (sinjalizimi horizontal e vertikal, ndriqimi publik)	km rrugë lokale të mirëmbajtura (në verë dhe në dimër)	180	210	240	245
	Km rrugë lokale të asfaltuara (të rehabilituara)	300	330	350	355
	% e banorëve (50.14% gra dhe 49.86% burra) të komunës të përfshirë në transportin publik				
	Km sipërfaqe publike me ndriçim të përmirësuar	24	30	35	37
	Km rrugë me sinjalistikë (vertikale dhe horizontale) të përmirësuar	230	260	280	290

Për synimin e dytë, Komuna e Klinës ka identifikuar kater objektiva, të cilët kanë të bëjnë me zhvillimin e infrastrukturës në funksion të qytetarve dhe bizneseve . Në realizimin e synimit të dytë janë të përfshira Drejtoria e Urbanizmit, Drejtoria e Inspeksion dhe Drejtoria e Shërbimeve publike . Buxheti total (kategoria ekonomike – investime kapitale dhe mallra e shërbime) në dispozicion të Synimit të dytë jepet në tabelën e mëposhtme.

	Burimet buxhetore (000 Euro)			
	2024	2025	2026	2027
Synimi (Objektivi strategjik): <b>Zhvillimi i infrastrukturës së nevojshme në funksion të qytetarve dhe bizneseve</b>	375	292	737	866
<a href="#">Objektivi 1: Rritja e nivelit të shërbimeve administrative për biznese dhe qytetar[1]</a>	125	180	185	198
Objektivi 2: Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatra	150	20	150	200
Objektivi 3: Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit në fshatra	80	60	370	435
Objektivi 4: Zgjerimi i infrastrukturës rrugore (sinjalizimi horizontal e vertikal, ndriqimi publik)	20	32	32	33

### 3. Përmirësimi i cilësisë së arsimit dhe shëndetësisë

<b>OBJEKTIVAT STRATEGJIK E TE KOMUNES</b>	<b>Indikatorët për Matjen e Performancës në drejtim të përmbushjes së Objektivave</b>	<b>2024</b>	<b>2025</b>	<b>2026</b>	<b>2027</b>
<b>Përmirësimi i infrastrukturës shkollore</b>	Numri i nxënësve (3648 vajza dhe 3934 djem)që përfitojnë nga përmirësimi i infrastrukturës dhe kushteve të shkollave.	6797	6797	6797	6682
	Mirëmbajtja e objekteve shkollore për m2	36000	36000	36000	36000
	Përfshirja e nxënësve (3648 vajza dhe 3934 djem)në arsimin e obligueshëm me qëllim të zhdukjes së analfabetizmit	99.75	99.8	99.85	100
<b>Përmirësimi i infrastrukturës shëndetësore në QKMF, AMF , AM dhe mirëqenja e qytetarëve</b>	Numri i familjeve të ndihmuara me mjete financiare (familje pa të ardhura)	850	800	830	840
	Familje të varfra që përfitojnë nga Komuna ndihma për shëndetësi dhe nevoja tjera	120	140	120	150
	Pika shëndetësore (QMF) me kushte të përmirësuara dhe të mirëpajisura	3	4	14	14
	Raporti për banorë që u ofrohet shërbimi shëndetësor/ QMF	25000	25000	20000	20000
	Rastet e pacientëve të sëmurë me sëmundje gjaku (që kanë nevojë për hemodializë) të shërbyera	18	20	30	50
	norma banorë / mjek	2500	2000	2000	2000
	rastet e pacientëve me gjendje të rëndë ekonomike që përfitojnë barna	300	350	450	500

Për Synimin e tretë, Komuna e Klinës ka identifikuar dy objektiva, të cilët kanë të bëjnë me përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe shëndetësisë. Në realizimin e synimit të tretë më së shumti është e përfshirë Drejtoria për Arsim dhe Drejtoria për Shendetësi dhe mirëqenje sociale . Buxheti total (kategoria ekonomike – investime kapitale dhe mallra e shërbime) në dispozicion të Synimit të tretë jepet në tabelën e mëposhtme.

	Burimet buxhetore (000 Euro)			
	2024	2025	2026	2027
Synimi (Objektivi strategjik):				
<b>Përmirësimi i cilësisë së arsimit dhe shëndetësisë</b>	435	540	460	490
Objektivi 1: Përmirësimi i infrastrukturës shkollore	210	210	210	210
Objektivi 2: Përmirësimi i infrastrukturës shëndetësore në QKMF, AMF , AM dhe mirëqenja e grave dhe burrave, vajzave dhe djemëve.	225	330	250	280

#### 4. Përparimi dhe mbrojtja e mjedisit jetësor.

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE TE KOMUNES	Indikatorët për Matjen e Performancës në drejtim të përmbushjes së Objektivave	2024	2025	2026	2027
		<b>Ruajtja dhe përmirësimi i natyrës</b>	Sipërfaqja e pyllëzuar gjelbëruar(Mbjellja e drujve )	2.6 ha	2.8 ha
	Sipërfaqja e gjelbëruar dhe mirëmbajtja	2.6 ha	2.8 ha	3.0 ha	3.5 ha

<b>Ulja graduale e ndotjës së ujit, ajrit, tokës .</b>	Sipërfaqja e rregulluar e shtretërve të lumejve	3.2 km	3.8 km	4 km	4.5 km
	Përqindja e sipërfaqes së tokës e pastruar nga mbeturinat e ngurta	80 %	80 %	80%	85%

Për Synimin e katërt, Komuna e Klinës ka identifikuar dy objektiva, që kanë të bëjnë me përmirësimin dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor . Në realizimin e synimit të katërt janë të përfshira Drejtoria e Shërbimeve publike dhe Drejtoria e Urbanizimit . Buxheti total (kategoria ekonomike – investime kapitale dhe mallra e shërbime) në dispozicion të Synimit të katërt jepet në tabelën e mëposhtme.

	Burimet buxhetore (000 Euro)			
	2024	2025	2026	2027
Synimi (Objektivi strategjik): <b>Përparimi dhe mbrojtja e mjedisit jetësor</b>	350	570	570	580
Objektivi 1: Ruajtja dhe përmirësimi i natyrës	150	120	120	125
Objektivi 2: Ulja graduale e ndotjës së ujit, ajrit, tokës	200	450	450	455



**5. Krijimi i qeverisë komunale që ofron shërbime efikase dhe që u përgjigjet kërkesave të qytetarëve.**

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE TE KOMUNES	Indikatorët për Matjen e Performancës në drejtim të përmbushjes së Objektivave	2024	2025	2026	2027
		Shërbime të shpejta komunale për qytetarët në zyrat komunale dhe në terren	Koha mesatare për lëshimin e certifikatave të gjendjes civile	6 min/për copë	5min/për copë
	Numri i banorëve të komunës që i marrin shërbimet nga zyrat e gjendjes civile	40000	41000	42000	42500

Për Synimin e pestë, Komuna e Klinës ka identifikuar vetëm një objektiv, i cili ka të bëjë me përmirësimin e shërbimeve që komuna u ofron qytetarëve. Në realizimin e synimit të katërt janë të përfshira Drejtoria e Administratës publike, Zyra e Kryetarit. Buxheti total (kategoria ekonomike – investime kapitale dhe mallra e shërbime) në dispozicion të Synimit të pestë jepet në tabelën e mëposhtme.

	Burimet buxhetore (000 Euro)			
	2024	2025	2026	2027
Synimi (Objektivi strategjik): <b>Krijimi i qeverisë komunale që ofron shërbime efikase dhe që u përgjigjet kërkesave të qytetarëve</b>	145	143	178	186
Objektivi 1: Mirëmbajtja dhe furnizimi me paisje dhe material shpenzues të zyrave komunale (të gjendjes civile) më qëllim të ofrimit të shërbimeve	145	143	178	186

Nga tabelat e mësipërme mund të thuhet se buxheti i komunës së Klinës (kategoria ekonomike – investime kapitale dhe mallra e shërbime) është ndarë ndërmjet synimeve të komunës si më poshtë:

	<b>Burimet buxhetore (000 Euro)</b>			
	<b>2024</b>	<b>2025</b>	<b>2026</b>	<b>2027</b>
Synimi (Objektivi strategjik): <b>Zhvillimi ekonomik</b>	2831	3127	3490	3585
Synimi (Objektivi strategjik): <b>Zhvillimi i infrastrukturës së nevojshme në funksion të qytetarve dhe bizneseve</b>	375	292	737	866
Synimi (Objektivi strategjik): <b>Përmirësimi i cilësisë së arsimit dhe shëndetësisë</b>	435	540	460	490
Synimi (Objektivi strategjik): <b>Përparimi dhe mbrojtja e mjedisit jetësor</b>	350	570	570	580
Synimi (Objektivi strategjik): <b>Krijimi i qeverisë komunale që ofron shërbime efikase dhe që u përgjigjet kërkesave të qytetarëve</b>	145	143	178	186

## V. Informacionet sipas programeve

### Zyra e Kryetarit

**Misioni:** Misioni i Komunës së Klinës është rritja e përgjegjësisë dhe llogaridhënies për të arritur rezultatet që avancojnë interesin e qytetarit, duke bërë mbikëqyrjen e përgjithshme të administrimit financiar të komunës, kujdesit për ekzekutimin e vendimeve të marra nga Kuvendi i Komunës, kujdeset për zbatimin e ligjit, rregulloreve dhe Statutit të komunës.

**Vizioni:** Vizioni i Komunës së Klinës është ofrimi shërbimeve sa më cilësore ndaj qytetarëve, zhvillim ekonomik të qëndrueshëm të komunës në përgjithësi, me urbanizëm modern dhe shërbime efikase e kualitative, me shërbime financiare të zhvilluara dhe ofrim të një kualiteti të mirë të jetesës për qytetarët e saj. Avancimi dhe i menaxhimit në pajtim me të gjitha normat ligjore, ruajtja dhe shtimi i vlerës së pasurive që posedon komuna mbesin ndër vizionet e komunës për vitet e ardhshme.

### Qëllimi:

Qëllimi i komunës së Klinës për vitet në vijim është rritja e zhvillimit ekonomik, ngritja e nivelit të mirëqenies sociale dhe krijimi i kushteve sa më të mira për jetesë, punë dhe zhvillim, avancimi i shërbimeve në administratën komunale në një administratë moderne, sa më funksionale dhe të rregullt.

### Zyra e Kuvendit

**Misioni:** Për t'ishërbyer qytetarët e komunës, duke siguruar miratimin e duhur të propozimeve nga dega e ekzekutivit në përputhje me detyrimet ligjore.

**Vizioni:** Për të siguruar shqyrtimin në kohë dhe Miratimin e politikave dhe rregulloreve komunale dhe planeve statutore, duke përfshirë buxhetin, në një mënyrë e cila i lejon ekzekutivit dhe stafit të komunës për të kryer detyrën e tyre në mënyrë efikase dhe efektive. Për të siguruar politikë të përshtatshme dhe plane brenda fushë veprimit të kompetencave të komunës, duke i respektuar të gjitha ligjet, në një mënyrë që përfitimet e qytetarëve të jenë të mëdha.

### Objektivat:

- Shqyrtimi dhe miratimi në kohë i politikave/rregulloreve të reja
- Shqyrtimi dhe miratimi në kohë i të gjitha planeve statutore (duke përfshirë buxhetin)
- Përmbyllja e nevojave të qytetarëve përbrenda burimeve në dispozicion të komunës

### Synimet

Indikatori	2025	2026	2027
% e akteve legislative të publikuara në faqen e internetit të komunës brenda 1 jave pas miratimit	97.5	97.7	97.9
% e vendimeve të kuvendit të publikuara në faqen e internetit të komunës brenda periudhës 7 ditë pas mbledhjes së kuvendit	97.5	97.7	97.9

## Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës

**Misioni:**Një komunë e pastër dhe e sigurt për të gjithë qytetarët

**Vizioni:**Për të përmbushur obligime statutores të drejtorisë dhe adresimin e nevojave të qytetarëve tanë në fushën e rrjetit komunal rrugor, ujit dhe infrastrukturës së mbeturinave,hapësirave të gjelbra, shërbimeve emergjente dhe të sigurisë.Ne do të bëjmë këtë dhe arrijmë duke zbatua mirëmbajtjen e planifikuar dhe përmirësimin e infrastrukturës së rrugëve, hapësirave publike , furnizimin me ujë dhe menaxhimin e ujërave të ndotura. Ne gjithashtu do të sigurojmë një plan të duhur që është në vend dhe zbatohet për mbrojtjen nga zjarri dhe emergjencat e tjera.

Indikatori	2025	2026	2027
% e rrugëve të asfaltuara	94	96	98
Km-të e trotuareve të ndërtuara	25	28	30
% e ekonomive familjare me qasje në ujë të pijshëm	90	95	97
% e ekonomive familjare të lidhura në sistemin e kanalizimit	80	85	87
% e inspektimeve për siguri nga zjarri ku nuk janë gjetur shkelje	60	70	75

## Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

**Misioni:** sigurimi i zbatimit të kujdesit parësor shëndetësor duke i dhënë përparësi zbatimit të masave parandaluese,nëpërmjet zbatimit të konceptit të mjekësisë familjare,si dhe brenda synimeve të politikave shëndetësore të siguroj ofrimin e shërbimeve shëndetësore kualitative, mbikëqyrë situatën epidemiologjike ne nivel komunal,si dhe përkujdesjen për mirëqenie sociale të kategorive te caktuara të popullatës së saj,

**Vizioni:**Kujdesi për informimin shëndetësor,kujdesi esencial kurativ, dhe emergjent gjatë 24 orëve,shëndeti oral,shëndeti mendor,furnizimi me barna,kujdesi antenatal ,kujdesi posnatal, planifikimi familjar, kujdesi paliativ etj.

Indikatori	2025	2026	2027
Raporti i numrit të qytetarëve me numrin e objekteve të kujdesit shëndetësor primar	25000	20000	20000
% e fëmijëve (374 vajza dhe 379 djem)nën moshën 1 vjeçar që e përfundojnë rrethin e parë të imunizimit	99	100	100
Raporti i numrit të doktorëve me numrin e qytetarëve	2000	2000	2000
% fëmijëve (3648 vajza dhe 3934 djem) shkollor që kryejnë kontrolle dentare përmes vizitave të dentistëve në shkolla	75	80	82
% e shkollave që marrin pjesë në fushatën për vetëdijesimin dentar	80	90	92

## Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mjedisit

**Misioni:** Mjedis më tërheqës natyror dhe përdorim më efektiv i tokës dhe ndërtesave.

**Vizioni:** Me mbajtjen e regjistrit të saktë të tokës, hartave dhe tokës tjetër dhe ndërtimin e bazave të të dhënave të ndërlidhura, ne përipiemi për të zhvilluar plane rregullore për përdorimin më efektiv dhe efikas të tokës dhe ndërtesave në të gjithë komunën e Klinës. Duke bashkëpunuar rregullisht me Drejtorinë e tjera ne dëshirojmë për të siguruar dhe arritur obligime statusore dhe ligjore, duke bërë që ato të jenë përmbushur në përputhje me plane të zhvilluara Urbane, dhe Planit Hapësinor edhe aktivitetëve për mbrojtjen e mjedisit. Me lëshimin e lejeve të ndërtimit dhe kryerjen e inspektimeve ne dëshirojmë që të sigurohet që zhvillimi dhe ndërtimi të jetë në përputhje me të gjitha kërkesat ligjore. Brenda kësaj drejtorie ne gjithashtu menaxhojmë shpronësimin e tokës për të lehtësuar zbatimin në kohë dhe efektiv të projekteve të zhvillimit të infrastrukturës. Përveç kësaj ne ofrojmë rregullore në fushën e menaxhimit të mbeturinave dhe të promovojmë respektimin e mjedisit dhe turizmit për të krijuar një komunë me ambient të pastër, të gjelbër dhe më tërheqës..

Indikatori	2025	2026	2027
Koha për lëshimin e lejes ndërtimore	30 ditë	30 ditë	30 ditë
% e lejeve të lëshuara brenda afatit ligjore	95	97	98
Koha e nevojshme për lëshimin e certifikatës së inspektimit nga dita e kërkesës së qytetarit/qytetarespër lëshimin e certifikatës	25 ditë	20 ditë	20 ditë

## Drejtoria e Bujqësisë , pylltari dhe zhvillim rural

**Misioni:** Për të krijuar ambient tërheqës, bashkësi ekonomike të qëndrueshëm si dhe ambient të qëndrueshëm bujqësor.

**Vizioni:** Qëllimi ynë kryesor është për të siguruar që numri maksimal i familjeve në zonat e fshatrave dhe sidomos fermat familjare do të zhvillohen dhe mbajnë një bazë ekonomike të qëndrueshme brenda komunës. Ne planifikojmë dhe ta bëjmë këtë duke mbrojtur tokën bujqësore për mes mbajtjes së të dhënave të sakta të përdorimit të tokës bujqësore dhe pronësisë së këtyre pronave. Ne do të bashkëpunojmë me bankat komerciale, për të shqyrtuar format e kreditimit për fermerët, dhe për të stimuluar dhe promovuar blegtorat dhe zhvillimin bujqësor në këto mjedise. Ne gjithashtu do të ofrojmë mbështetje veterinare për fermerët për të reduktuar sëmundjet në blegtori. Ne do të promovojmë mbrojtjen mjedisit tonë natyror dhe të zbatojmë legjislacionin përkatës në fushën e mjedisit dhe ruajtjes së pyjeve.

Indikatori	2025	2026	2027
% e tokës bujqësore që është duke u kultivuar	95	96	94
% e tokës bujqësore që është duke u ujitur	37	38	38
% e rritjes së rendimenteve për ha	8.5	8.7	9.1

## Drejtoria Kadastër e Gjeodezi

**Misioni:** Misioni: Drejtoria e Kadastrës, Gjeodezisë dhe Pronësisë në komunën e Klinës ka për mision të sigurojë menaxhimin efektiv dhe të drejtë të tokës dhe pronësisë, për të garantuar të drejtat pronësore të qytetarëve dhe për të kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm urban dhe rural të komunës.

**Vizioni:** Të jemi një drejtori lider në menaxhimin e tokës dhe pronësisë, duke ofruar shërbime të kualitetit të lartë, transparente dhe inovative, që kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve të komunës së Klinës dhe zhvillimin ekonomik të rajonit.

**Objektivat:**

- Të reduktojmë kohën e përpunimit të aplikimeve për regjistrim të pronësisë dhe shërbimeve të tjera kadastrale për 30% brenda tre viteve të ardhshme.
- Të implementojmë një sistem të ri të menaxhimit të dokumentacionit elektronik brenda dy viteve të ardhshme për të lehtësuar qasjen dhe administrimin e të dhënave.
- Të realizojmë një inventarizim të plotë të të gjitha pronave publike dhe private brenda komunës brenda pesë viteve të ardhshme.
- Të zhvillojmë një platformë online që lejon qytetarët të aksesojnë dhe të menaxhojnë informacionin e tyre pronësor në kohë reale brenda dy viteve të ardhshme.
- Të organizojmë të paktën dy fushata informuese në vit për të rritur ndërgjegjësimin e qytetarëve mbi të drejtat e tyre pronësore dhe procedurat kadastrale.

Indikatorët për Matjen e Performancës në drejtim të përmbushjes së Objektivave	2024	2025	2026	2027
% Të përmirësojmë sistemin e regjistrimit të tokës dhe pronësisë për të siguruar saktësinë dhe integritetin e të dhënave kadastrale.	98	99	100	100
% Të rrisim efikasitetin dhe transparencën në proceset administrative dhe shërbimet ndaj qytetarëve.	100	100	100	100
% Të promovojmë përdorimin e teknologjive të avancuara gjeodezike dhe GIS për menaxhimin dhe planifikimin e tokës.	95	96	98	100

## Drejtoria e Arsimit

**Misioni:** Çdo personi do duhet t'i mundësohet ekspozimi ndaj sportit dhe kulturës nëpërmjet përvojave të të nxëniet pozitiv, dhe do të stimulohet për arritjet e tij / saj të plota, veprime të cilat do ju japin atyre besim dhe do të gjejnë vet përmbushje me atë që merren.

**Vizioni:** Qëllimi ynë është që të sigurojmë qasje të barabartë për të gjithë fëmijët (3648 vajza dhe 3934 djem) brenda komunës, në sistemin e arsimit cilësor, parashkollor, fillor dhe atë të mesëm. Ne gjithashtu do të mbështesim sigurimin e edukimit të mëtejshëm për të rriturit. Për ta bërë këtë ne kemi siguruar zbatimin e rregullores kombëtare dhe legjislacionit të duhur arsimor, dhe politikat gjegjëse si rezultat. Ne marrim pjesë në përzgjedhjen e stafit dhe drejtorëve të shkollave për të siguruar se profesionistët dhe të kualifikuarit janë të punësuar për të mësuar qytetarët tanë, të rinjtë dhe të moshuarit. Ne i mbajmë të gjitha shënimet e nevojshme komunale të arsimit dhe statistikat për të matur nivelin e cilësisë së arsimit që ofrohet nga komuna. Ne komunikojmë hapur me publikun për të gjitha çështjet që lidhen me politikën e arsimit dhe të procesit përbrenda komunës.

Indikatori	2025	2026	2027
% e fëmijëve (245 vajza dhe 222 djem) që arrijnë moshën për të filluar shkollën	99	100	100
% i nxënësve (vajza 131 dhe 78 djem) që kalojnë provimin shtetëror	80	90	90
% e shkollave që kanë kaluar nga sistemi me 3 ndërrime në sistemin me 2 ndërrime	100	100	100
% e shkollave që kanë kaluar nga sistemi me 2 ndërrime në sistemin me 1 ndërrim	50	70	90
Raporti i numrit të mësuesve me numrin e fëmijëve parashkollorë, fillorë dhe të mesëm.	20	15	19

## Drejtoria e Administratës dhe personelit

**Misioni:** Për të qenë më të mirë në ofrimin e shërbimeve administrative-të kuptuarit se ofrimi i veprimeve dhe shërbimeve tona dhe suksesi ynë është i lidhur me kënaqësinë e qytetarëve.

**Vizioni:** Ne kemi për qëllim të ofrojmë shërbime cilësore për qytetarët tanë në një kohë dhe në mënyrë efikase nëpërmjet Qendrës së Shërbimit të Qytetarëve. Llojet e shërbimeve që ne ofrojmë janë regjistrimet e qytetarëve dhe lëshimi i certifikatave. Ne gjithashtu sigurojmë mbështetje administrative dhe këshilla për të gjitha drejtoritë tjera komunale dhe Kuvendin për të ju mundësuar atyre që t'i arrijnë objektivat dhe synimet e tyre. Lloji i mbështetjes logjistike që ne ofrojmë përfshinë ruajtjen, transportin, postën, inventarizimin, sigurinë, përkthimin e dokumenteve zyrtare, mirëmbajtjen e pajisjeve të teknologjisë informative dhe mirëmbajtjen e ndërtesave. Për të përmirësuar transparencën për qytetarët tanë, ne mirëmbajmë dhe e freskojmë rregullisht faqen e internetit të komunës.

Indikatori	2025	2026	2027
% e dokumenteve zyrtare të përkthyer nga gjuha shqipe në gjuhën serbe dhe angleze	100	100	100

## Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Buxhetit

**Misioni:** Arritja e niveleve më të larta të ekonomisë, efikasitetit dhe efektivitetit në menaxhimin e burimeve komunale

**Vizioni:** Nëpërmjet planifikimit të duhur dhe menaxhimit të resurseve komunale, ne përpiqemi që të promovojmë vlerën për ofrimin e të gjitha shërbimeve për qytetarët. Ne mbikëqyrim planifikimin dhe zbatimin e buxhetit komunal për të siguruar pajtueshmërinë me të gjithë legjislacionin e financave, statutit dhe rregulloret tjerapërkatese. Ky veprim përfshin zbatimin e rregullores mbi tarifatat dhe pagesat, veprime që lidhen me mbledhjen e tatimit në pronë. Ne gjithashtu përgatisim të gjitha raportet financiare dhe llogaritë vjetore në përputhje me kërkesat statutorë komunale. Përveç kësaj, ne punojmë për të nxitur zhvillimin ekonomik në të gjithë komunën, duke krijuar një "partneritet" me komunitetin e biznesit dhe hartimin e planeve për me theks të veçantë, zhvillimin e NVM-ve.

Indikatori	2025	2026	2027
Numri i dokumenteve financiare të publikuara në faqen e internetit të komunës brenda 1 jave pas miratimit	6	6	7
Numri i bizneseve (13 biznese të grave 22 biznese të burrave) të reja që kanë filluar punën	35	40	42
% e grumbullimit të hyrave vetanake	80	85	90

## Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Në vitin 2024 Drejtoria për Kulturë, Rinie dhe Sport përmes thirrjes për financim publik të OJQ-ve në bazë të rregullores MF 04/2017 ka financuar një numër të OJQ-ve ndër të cilat ka edhe përfituese femra dhe përqindja e përfitueseve femra duke ndikuar në rritjen e barazisë gjinore planifikohet të rritet edhe në vitet në vazhdim.

**Misioni:** Arritje nivelit më cilësor në aktivitetet kulturore, rinore e sportive. Rritje e mbështetjes financiare për projekte rinore si dhe projekte që kanë për qëllim fuqizimin dhe pjesëmarrje aktive të vajzave/grave në shoqëri.

**Vizioni:** Nëpërmjet thirrjeve publike për financim si dhe bashkëpunimeve me organizata të ndryshme, ne synojmë që DKRS të ketë një program atraktiv që shënon zhvillime dhe përmbushje të nevojave sportive, kulturore e rinore me theks të veçantë buxhetim të barabartë gjinor që ndikon në fuqizimin e vajzave dhe grave. Si dhe çdo mbështetje tjetër që naa lejohen në bazë të rregulloret komunale përmes të cilave kalojnë këto procedura.



**Objektivat:** Rritja e mbështetjes financiare së projekteve dhe OJQ-ve me udhëheqëse gra, aktivizimi i grave dhe vajzave në njohuritë rreth buxhetimit të përgjegjshëm gjinor, krijimi i grupeve në fshatra dhe pjesëmarrje në dëgjimet e KAB-it si dhe futja e ideve/kërkesave të tyre në këtë dokument.

**Aktivitetet:** Takime të rregullta me grupe, aktivitete kulturore e sportive me qëllim socializimi, bashkëpunime me OJQ për zhvillim të programeve e trajnimeve me ndikim në rritjen e njohurive rreth buxhetimit gjinor etj.

<b>Indikatori</b>	<b>2025</b>	<b>2026</b>	<b>2027</b>
Rritja e % së mbështetjes financiare për OJQ-te me udhëheqëse gra	<b>5%</b>	<b>7%</b>	<b>10%</b>
Rritja e % së mbështetjes financiare për OJQ-te me përfituese – anëtare femra	<b>5%</b>	<b>6%</b>	<b>8%</b>
Rritja e % së trajnimeve për fuqizim e pjesëmarrje aktive në shoqëri e politikë si dhe në qeverisje lokale	<b>30%</b>	<b>40%</b>	<b>50%</b>
Rritja e % së OJQ-ve sportive me synim fuqizimi të vajzave dhe grave që kanë prirje në sporte.	<b>10%</b>	<b>30%</b>	<b>30%</b>



Kuvendi i Komunës Klinë

01Nr. \_\_\_\_\_ 2024

## PROCESVERBAL

**Nga mbledhja e Kuvendit të Komunës së Klinës mbajtur me datë 30. 05. 2024 në ora 10:00 në Sallën e Kuvendit të Komunës.**

**Pjesëmarrës në mbledhje; Kryetari i Komunës z. Zenun Elezaj, nënkryetarja znj. Marqe Selmanaj, drejtorët e drejtorive, Komandanti i policisë në Klinë, media lokale, anëtarët e kuvendit, qytetarë.**

**Mbledhja është transmetuar audiovizive drejt për drejt nga KlinaInfo dhe Radio Alba.**

**Kryesuesi i Kuvendit, z. Fadil Gashi hapi mbledhjen e kuvendit duke përshëndet kryetarin e komunës, anëtarët e kuvendit , dhe gjithë të tjerët të pranishëm në sallë. Kryesuesi konstatoi se të pranishëm janë 21 anëtarë prezent. Ilir Hoti, Asdren Ramadani, Arlinda Selitaj, Kushtrim Haliti dhe Arta Pantina mungojnë me arsye.**

**Para se të kalohet tek rendi i ditës kryesuesi ka një kërkesë që anëtarët e KPF për ditët sa do të zgjasin dëgjimet buxhetore nëpër lokacione të marrin pjesë. Po ashtu lutjen e njëjtë jua bëri edhe anëtarëve të kuvendit. Për Rendin e Ditës Kryesuesi kërkon që të shtohet një pikë- vlerësimi i komisionit për ndarjen e titullit “Nderi i Qytetit” për prof. Ymer Berisha.**

**Me 21 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim bashkë me propozimin e kryesuesit Miratohet Rendi i Ditës:**

**Pika 1: Arsyetimi i mungesave.**

Pritet që mbledhjes të i bashkohet Armend Beqiri.

**Pika 2: Shqyrtimi i Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar**

**z. Zafer Gashi:** Kam vetëm lavdërime për procesmbajtësin i cili e ka pasqyruar korrekte atë që është folur në mbledhjen e kaluar.

**Me 22 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA.**

**Pika 3 : Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit të KPF nga mbledhja e rregullt.**

**Pika 4: Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve të KPF nga mbledhja e jashtëzakonshme**

**Me 22 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim u MIRATUAN të dy rekomandimet e të dy takimeve të KPF-së.**

**Pika 5: Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për shtim të buxhetit për projektin , Furnizim me mekanizma bujqësor.**

**z. Enver Berisha, drejtor i FEZH:** Përshëndetje. Realisht sipas kodit të ri thuhet shtim i buxhetit por fjala është për mjetet që përfituesit participojnë.

**z. Esat Raci:** Përshëndetje. Kam pasur dy pyetje për drejtorin e bujqësisë për këtë çështje. Unë personalisht dhe grupi ynë jemi shumë të pakënaqur me ndarjen e këtyre serave dhe mekanizmave, mendojmë që janë ndarje politike. Shembull, si është e mundur që një invalid i luftës dy herë radhazi të aplikoj dhe të mos i ndahet mekanizmi. Po ashtu si është e mundur që në asnjë komision vlerësues nuk ka pasur asnjë zyrtarë nga drejtoria e Bujqësisë të cilët janë shumë të përgjegjshëm në punë. Jo rastësisht në komunën e Klinës nuk është asnjë i akuzuar në rastin e subvencioneve 1 dhe 2. Shihet që ata zyrtarë janë shumë të përgjegjshëm në punë dhe absolutisht nuk janë të kënaqur me trajtimin e pushtetit lokal, duke mos i angazhuar në asnjë komision vlerësues sa i përket bujqësisë.

**z. Zafer Gashi:** këto dy pika të rendit të ditës janë në rregull por nga listat që i kemi pa më të vërtetë ajo që u tha edhe nga Esati, shpërndarja le shumë për të dëshiruar. Ka familjarë të zyrtarëve komunal që kanë përfituar, sera, multikultivator. Kam thënë edhe herën e kaluar se qëllimi i pushtetit lokal është që të i rritë subvencionet shkaku i votave elektorale. Jemi dakord që të rriten subvencionet dhe të shpërndahen drejtë. A ka mundësi që këto subvencione në gjashtë mujorin tjetër të ndahen për personat që janë me sëmundje malinje, kancer etj. Ata të sëmurë po vuajnë , kosto është e madhe për trajtimin e tyre dhe ata nuk po arrijnë që ta paguajnë. Do të ishte mirë që të ndahet një shumë e konsideruar për këta qytetarë në nevojë.

**Znj. Besiana Gashi:** Edhe unë e ndaj mendimin e njëjtë me parafolësit. Mënyra e shpërndarjes së këtyre mekanizmave edhe kësaj radhe ky komision vuri në pah ngjyrimet politike.

**z. Valmir Bacaj:** Përshëndetje të gjithëve> ne si grup kuvendar jemi dakord që të shtohet buxheti ashtu siç edhe u kërkua. Jemi të vetëdijshëm që nuk është arritur që të përfitojnë të gjithë ata që aknë aplikuar por besoj që herën tjetër do të përfitojnë edhe ata që nuk kanë përfituar kësaj radhe.

**Me 19 vota për asnjë kundër dhe 2 abstenime U MIRATUA.**

**Pik 6: Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për shtim të buxhetit për ndarjen e serave.**

**Me 19 vota për asnjë kundër , 2 abstenime U MIRATUA.**

Pika 7: Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për plotësim ndryshim të vendimit për bartjen e mjeteve të hyrave vetanake nga viti 2023.

Drejtori i FEZH, z. Enver Berisha shpjegoi se bëhet fjalë për të hyrat vetanake të tejkaluara në vitin 2023 por kërkohet të shfuqizohet vendimi i 23 shkurtit 2024 dhe më pastaj të votohet vendimi i tanishëm. Propozim vendimi i ri shpjegoi drejtori Berisha, janë të hyrat vetanake të tejkaluara dhe se kapin vlerën prej 423 mijë e 926 euro. Këto mjete janë vendosur të shpërndahen nëpër kategori ku pjesa më e madhe shkon në shpenzime kapitale.

**Me 18 vota për, asnjë kundër dhe 2 abstenime U MIRATUA anulimi i vendimit të shkurtit 2024**

**z. Zafer Gashi:** Po shihet mirë se janë të detyrueshme këto bartje sipas udhëzimeve të qeverisë. Shuma që është cekë në shpenzimet kapitale është e çuditshme sepse janë cekur shumat minimale dhe maksimale dhe nuk ka të mesme. P.sh. ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Caravik dhe Cabiq, 3100 e 2 euro, në Sferkë, Volljak dhe Qupevë, në tre fshatra vetëm 20 mijë euro. Ajo që mu dukë e arsyeshme është ajo e shtëpisë së Pleqve që për shkak të kësaj ne do ta votojmë.

**Me 21 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA vendimi i ri.**

**Pika 8: Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për alokim të mjeteve në kuadër të kategorisë së shpenzimeve kapitale.**

Edhe për këtë pikë drejtori i Ekonomisë, z. Enver Berisha shpjegoi se për çfarë bëhet fjalë. Sa mjete janë dhe ku planifikohen të investohen. Sa janë vlerat dhe nga janë marrë.

**Me 21 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA**

**Pika 9: Shqyrtimi i raportit nga procesi i organizimit të konsultimeve publike për draft rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Komunën e Klinës.**

**Pika 10: Shqyrtimi dhe miratimi i draft rregullore së brendshme.**

**z. Binak Sylaj, drejtor i Administratës:** Përshëndetje të gjithëve. Kjo rregullore është një nga dokumentet më të rëndësishme për rregullimin e brendshëm. Me këtë rregullore shpresoj se do të arrijmë që të i harmonizojmë të gjitha brengat e shërbyesve civil. Ne si administratë , veçanërisht kryetari është angazhuar që ky komision për përpilimin e kësaj rregulloreje të përfaqësohet nga të gjitha drejtoritë. Sa i përket koeficienteve është dashur të jetë në harmoni të plotë me rregulloret dhe dokumentet e tjera të nivelit qendror. Edhe ne i kemi pasur vërejtjet tona dhe këto vërejtje komisioni i ka marr parasysh dhe ka hartuar këtë rregullore. Konsideroj që komisioni ka kryer një punë jashtëzakonisht të mirë dhe mendoj që kjo rregullore do të i hyjë në punë të gjitha drejtorive. Nuk jemi ne që i kemi përcaktuar koeficientet dhe vendet e punës por me këtë rregullore jemi munduar që të i përmirësojmë

disa padrejtësi të bëra prej kohësh. Për detaje këtu e kemi edhe zyrën ligjore edhe kryesuesin e komisionit që mund të përgjigjen në pyetjet e juaja.

**z. Zafer Gashi:** Rreth kësaj draft rregulloreje ne kemi marrë disa vërejtje që kanë të bëjnë me uljen e koeficienteve për disa punëtorë, sidomos në drejtorinë e Kulturës dhe sporteve. E shoh që edhe drejtori ka vërejtje në disa sektorë. Mendoj që përgatitja profesionale dhe edukimi në drejtorinë e Kulturës është nivel më i lartë dhe meritojnë të trajtohen drejtë.

**z. Arben Limanaj:** Përshëndetje të gjithëve. E lexova materialin dhe kam një pyetje për drejtorin e administratës. Te drejtoria e kulturës burojnë shumica e ankesave për kategorizimin – a ka bërë ankesa dikush nga kjo drejtori në lidhje me këtë. Nëse një zyrtar i komunës e ka bërë të madhe çështjen e koeficientit të tij ju ka rregulluar ndërsa ata që nuk aknë mundësi intervenimi i mbetet koeficienti i pa ndryshuar edhe pse ka përgatitje të lartë profesionale.

**z. Binak Sylaj, drejtor i administratës:** Me përgjegjësinë e plotë e them se asnjë presion nuk ka ndodhë, asnjë ndryshim i ndodhur nuk ka ndodhë pa akt emërimin adekuat. DZMP e ka harmonizuar këtë rregullore në nivel Kosovës dhe asnjë ndryshim nuk është bërë pa harmonizimin me DZMP. Nëse keni ndonjë të dhënë që dikush ju ka prezantuar me siguri që nuk është e vërtetë. Kemi qenë një nga komunat me të diskriminuara në nivel Kosove e tani jemi në të njëjtin nivel me komunat e tjera.

**z. Fadil Gashi, kryesues:** Kam një kërkesë që në titull duhet të bëhet një ndryshim. “Klasifikimi i vendeve të punës” duhet të hiqet që të ju përshtatemi akteve të tjera të rrjedhura nga niveli qendror. Në organogram e shoh që mungon Komiteti i Auditimit.

**z. Enver Malaj, kryetar i komisionit:** Komiteti i auditimit nuk futet në organogram pasi që është formuar me vendim të kryetarit të Komunës.

**z. Tunë Dedaj:** Përshëndetje. Duke e marrë parasysh se të ardhurat personale të punëtorëve të administratës janë shumë të ulta është mirë që të angazhoheni në maksimum që të ju rritet koeficienti sepse shporta familjare është rritë shumë.

**z. Valmir Bacaj:** Të gjitha arsyeshmeritë në lidhje me propozimet e pranuar dhe të pa pranuar po besoj që janë të harmonizuara edhe me rregulloren e nivelit qendror. Është shumë e rëndësishme që të kalohet kjo rregullore prandaj ne si grup kuvendar do ta votojmë pro.

**Me propozimet për ndryshime tek titulli i kësaj rregullore, me 18 vota për, asnjë kundër dhe 2 abstenime u MIRATUA**

**Pika 11: Shqyrtimi i raportit nga procesi i organizimit të dëgjimit publik për draft rregulloren për ngarkesat komunale dhe tarifat**

**Pika 12: Shqyrtimi dhe miratimi i draft rregullores për taksa, tarifa dhe ngarkesa komunale**

**z. Enver Berisha, drejtor i FEZH:** Ky draft është hartuar nga një ekip profesionale të prirë nga z. Burim Hotit dhe është punuar për një kohë goxha të gjatë.

Drejtori Berisha foli për ndryshimet monetare të taksave, tarifave etj. nëpër drejtori dhe prezantoi ato një nga një.

**z. Fadil Gashi, kryesues:** Unë e kam për obligim të jua përcjell dy propozimet që janë bërë në KPF: 1. Provimet e vitit të fundit të shkollimit të mesëm , vitit 12 vetëm aty ku nxënësi ka pasur notë të dobët ka paguar 10 euro ndërsa KPF ka propozuar të bëhet 5 euro dhe diploma 10 euro. Do të duhej një shpjegim sepse nëse bazohemi në udhëzimin administrativ, ne, nuk mund ta ndryshojmë.

**z. Qemajl Sejdiu, drejtor i DKA:** Të gjitha taksat dhe tarifat sa i përket drejtorisë së arsimit janë të bazuara në rregullore administrative.

**z. Tunë Dedaj:** Dëshiroj të ja bëjë një pyetje drejtorit të financave. Këtu janë vendosë tarifat e shërbimeve për përcaktimin e kufijve të parcelave. Unë sa e dijë Gjeodetët e kanë të ndaluar që të kryejnë këtë punë prandaj dua ta dijë nëse kjo tarifë vlen edhe për Gjeodetët privat.

**z. Nikson Dakaj, drejtor i Kadastrit:** Këto tarifa vlejné për gjeodetët privat.

**z. Enver Berisha, drejtor i FEZH:** Kam edhe një sqarim. Fjala është për dy tarifa. Për autobusë dhe minibusë. Me këtë rregullore kemi planifikuar që sa herë të futen në stacion autobusi të paguaj 1.5 euro ndërsa minibusi 1 euro.

**z. Tunë Dedaj:** Kjo taksë është shumë e vogël. Peja e ka 3 euro hyrjen në peron të autobusit. Me këtë taksë nuk do të mund të mbulohen shpenzimet e punëtorëve.

**z. Zenun Elezaj, kryetar i komunës:** Përshëndetje. Ideja për me i propozuar këto tarifa është sepse ne ende nuk e kemi themeluar kompaninë publike . Në momentin që do të aprovohet statusi i kompanisë ne do të bëjmë propozimin e ndryshimit të çmimeve.

Kryesuesi tha se mundemi që me një pasus të definojmë ndryshimin e çmimeve atëherë kur të themelohet kompania.

**z. Valmir Bacaj:** Ne sot para vetës e kemi një rregullore mjaft të rëndësishme që do ta votojmë. Kjo rregullore përcakton lartësinë e taksave komunale për caktimin e kategorive të liruara nga kjo taksë dhe caktimin e kundërvajtjeve dhe sanksioneve për kundërvajtje dhe shkelje të dispozitave të kësaj rregulloreje. Është e rëndësishme të cekët sepse nevojitet një sensibilizim i qytetarëve pasi që kjo rregullore i përfshin edhe gjambat për kundërvajtje të personave fizik dhe juridik: kycje në kanalizim, ujësjellës, ndotje të ambientit, ndërhyrje pa leje në infrastrukturë rrugore etj. Ne si grup kuvendar do ta votojmë pro këtë rregullore.

**z. Zafer Gashi:** Unë kam disa vërejtje rreth tarifës për taksë biznesi për veprimtari të ndryshme. Ka një ndryshim që nuk do ti përmend në detaje. Tek Shërbimet publike, shuma që duhet të paguhet për pano të vendosura në qytet, dëshiroj të dijë nëse ka paguar deri tash dikush. Unë them se duhet të jetë një dallim mes panos së vendosur në pronën komunale dhe asaj në pronën private. Unë kam një përvojë të keqe, nga kryetari i komunës më është ndaluar

vendosja e panos edhe pse kam bërë kërkesë ndërsa ka raste kur pano janë të vendosura nëpër shtylla elektrike si ajo e kryetarit të komunës që nga koha e fushatës, a është paguar për këtë këto dy , tre vite të shkuara për ato pano.

**z. Zenun Elezaj, kryetar i komunës:** Për pano kur shfrytëzohet prona publike bëhet një pagesë shtesë. Kryesisht kemi kompani që marrin autorizimin për shfrytëzim komplet të disa hapësirave. Sa e dijë unë ka pasur kompani që e kanë fituar tenderin për shfrytëzim të hapësirës reklamuese për tërë vitin. Ato mundësi tani nuk janë, jemi duke ndërtuar infrastrukturë të re që do të bazohet në këtë rregullore.

**z. Fadil Gashi, kryesues:** Tek faqja 9 është e përsëritur dy herë, 1.36 dhe 1.33- personi nuk është banor i Klinës. Njëra duhet të hiqet. Implementimi i kësaj rregullore ka shumë rëndësi për çka edhe kemi biseduar bashkë. Tek gjobat, kapitulli i fundit neni 48 paragrafi i dytë: Çdo person fizik përgjegjës që nuk e lajmëron vdekjen e personit... gjobitet në vlerë prej 80 euro dhe tek paragrafi i tretë: çdo drejtues i spitalit, burgut, institucionit... ai dënohet 70 euro. Mendoj se përgjegjësia e institucionit është më e madhe prandaj ndoshta do të duhej të ishte e kundërta sa i përket vlerës së gjobës. Unë kam pasur rast të shohë se edhe subjekteve politike për shfrytëzim të hapësirave publike-sallës jua marrin 100 euro ndërsa në komuna të tjera subjekteve politike jua sigurojnë edhe zyrat pa pare. Ndërsa për promovim të një aktiviteti subjekteve të tjera jua marrin vetëm 20 euro. Edhe në këtë rregullore shihet që nga 50 euro për shfrytëzim të sallës nga subjektet politike është rritur në 100. Po shihet sikur diçka e keqe aktiviteti i subjekteve politike.

**z. Valmir Bacaj:** Edhe ne si grup kuvendar pajtohemi me mendimin tënd kryesues dhe e konsiderojmë si tarifë shumë të lartë për subjektet politike prandaj propozojmë që të hiqet komplet si tarifë për subjekte politike.

**Me të gjitha propozimet e dhëna kryesuesi e vendosi në votim dhe me 16 vota për, asnjë kundër dhe 3 abstenime U MIRATUA.**

**Pika 13 : Shqyrtimi i raportit në lidhje me punësimet në komunë dhe punësimet me kontrata mbi vepër.**

**z. Zafer Gashi:** Është e ditur që ne kemi kërkuar formimin e një komisioni hetimor për këtë çështje por jo seriozitetin i kolegëve tonë nga opozita shihet edhe prezenca e tyre në këtë mbledhje sidomos nga PDK. Ne i kishim të targetuara me emër dhe mbiemër punësimet partiake. Tani mund të them se ne opozita duhet mbledhur mend dhe të punojmë sepse më të vërtetë ka nevojë për ndryshim. Nuk do të flas më shumë sepse qëllimi ynë ishte të formohet komision hetimor për këtë çështje. Dy kushëri të mijë vijnë verës dhe takohen me kryetarin e komunës të cilët janë votues të tij dhe i kërkojnë ndihmë për punësimin e motrës së një prej tyre ndërsa kryetari ju përgjigjet se i është mbushur lista për këtë vit por shohim në 2025.

**z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës:** Nuk është e vërtetë që unë kam thënë ashtu, ato fjalë që i thua dhe thënë sinqerisht nuk lëshohem në ato nivele.

**z. Binak Sylaj, drejtor i administratës:** Unë e kam përgatitur raportin që e keni secili nga ju. E kam precizuar formën e poentimit dhe formimit të komisionit. Edhe pse nuk është

precizuar në kërkesë se për cilën periudhë kohore kërkoni raportin unë e kam përgatit atë për vitin 2023. E kam potencuar aty se gjithsejtë në Komunë janë punësuar 21 persona, ndërsa sa i përket punësimit me kontratë mbi vepër ju siguroj se nga shtatori i vitit 2023 nuk ka kontratë mbi vepër sepse ka hy në fuqi ligji për zyrtar publik që nuk njuh kontratë mbi vepër por shërbime të veçanta. Ato që pretendon z. Gashi se ka parregullsi, nuk qëndrojnë . Nga këto punësime që janë bërë e di që ka nga të gjitha subjektet politike. Janë pranuar sipas vlerësimit që ata kanë pasur në test. Janë rregulla e ligje në fuqi që askush nuk mund të i anashkaloj. Gjitha ankesat shqyrtohen dhe gjithçka kalon nëpërmes një filtri të detajuar.

**z. Zafer Gashi:** Ka plotë raste që ka dalë individit me 63 poena ose 64 , i dyti në radhë dhe kur ka ardhur intervista me gojë ku ju i “ndreqni” senet ka dalë i pari.

#### **Pika 14: Shqyrtimi i raportit mbi dhënien e lejeve të operatorëve gurëthyes.**

**z. Enver Berisha, drejtor i Urbanizimit:** Përhëndetje. Unë këtij kuvendi ja kam dërguar një raport të detajuar. Mund ta shihni që numri i lejeve dhe pëlqimeve të lëshuara është zero pasi që komuna nuk lëshon këso lejesh sepse nuk është kompetente. Po ashtu komuna lëshon një vërtetim urbanistik me të cilin palës i tregon se çfarë ka paraparë dokumenti planifikues i komunës. Po ashtu, ju kemi përmbajt edhe vendimit të “famshëm” të marrë nga kuvendi. Ju kemi kërkuar palëve që të na sjellin vendimet e pëlqimeve mjedisore të lëshuara nga ministria dhe më pastaj është punuar konform rregullave dhe ligjeve në fuqi.

**z. Zafer Gashi:** Unë nuk e kam kërkuar, z. Drejtor, por e ka kërkuar kuvendi dhe të falënderoj që na e ke dërguar. Në vërtetimin urbanistik a është përfshirë edhe pika 6 e vendimit të kuvendit të datës 11.03. 2020 ku thuhet se debatet publike për aktivitete minerare të organizohen në objektin e komunës së Klinës. Pyetja e dytë: Tek Sferka konkretisht, operatori që ka ardhur gati tek Perqeva, thuhet se është firma “Ceku” a e ke evidentuar këtu edhe këtë operator. A ka mbajtur debat publik ai operator sepse sa e di që unë nuk është mbajtur debat publik në Sferkë, me qytetarët që jetojnë në atë pjesë.

**z. Enver Berisha, drejtor i Urbanizimit:** Debatin e organizon ministria me kërkesë të palës dhe atë e organizon në një ambient të Komunës. Sa i përket emrit të operatorit në Sferkë unë nuk e shoh emrin. E konsultoj stafin dhe e shqyrtoj lëndën. Nuk merrem me emrat e firmave.

**z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës:** Është mirë që të merret informata dhe në seancën e ardhshme të epet si informacion. Po ashtu është mirë që inspektorati të vizitoj operatorin, të i merr dokumentacionin dhe të na informoj në seancën e ardhshme.

**Znj. Valmira Krasniqi:** Unë dëshiroj vetëm një pyetje. Sa është numri i gurëthyesve nga ana majtë në magjistralen Pejë –Prishtinë pas vendimit të marrë në kuvend që i ndalon, vendim i vitit 2019.

**z. Enver Berisha, drejtor i Urbanizimit:** Ai vendim ka marrë ligjshmërinë dhe prej atëherë nuk është dhënë asnjë dokument i çfarëdolloj.

**z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës:** Kanë qenë tre operator që kanë operuar dhe dy prej tyre kanë pasur licencë valide. Njërit i ka skaduar licenca , janë drejtuar tek ne për pëlqim por



nuk i kemi dhënë. Ju kemi sugjeruar që të marrin leje nga komisioni i pavarur për miniera. Vendimi ynë ka qenë për minim dhe nuk do të marrin pëlqim për minim.

**z. Valmir Bacaj:** Ne në seancën e kaluar kemi pasur një kërkesë nga opozita që të shtyhen këto dy pika dhe është kërkuar interpelanca. Rrjedhje e mirë e interpelancës , jemi shembull edhe për komunat e tjera se si duhet organizuar interpelancat. Falënderoj edhe ekzekutivin dhe të gjithë që kontribuuan.

### **Pika 15: Propozimi i komisionit për ndarjen e titullit “Nderi i Qytetit” për veprimtarin Ymer Berisha**

**Me 17 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA propozimi i komisionit**

### **Pika 16: Pyetje dhe Përgjigje**

**Znj. Blerina Racaj:** Kam një kërkesë për drejtorin e Shërbimeve Publike nga banorët e lagjes “Osman Krasniqi” afër parkut të qytetit për mungesë të ndriçimit dhe trotuarit. Janë dërguar disa kërkesa në Komunë por nuk është ndërmarr asgjë.

**z. Qendrim Millaku, drejtor i SHP:** E kemi kërkesën por gjithashtu ne kemi dërguar një kërkesë në “Ifrakos” që të na lejohet instalimi i ndriçimit publik edhe në anën që të ndriçohet rruga e jo vetëm hekurudha. Në momentin që na kthejnë përgjigjen do të veprojme.

**z. Zafer Gashi:** Unë sipas rregullores me datën 13. 05. 2024 kamë bërë një kërkesë tek zyra për qasje në dokumentet zyrtare dhe ende skam marrë përgjigje për qasjen në tre dokumente. A duhet të pritet ende apo do të ma lejoni qasjen.

**z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës:** Unë e di që aty ku lejohet çdo kërkesë për qasje në dokumente zyrtare duhet të i epet . Do të interesohem që gjithçka që është e ligjshme dhe e drejtë të kryhet në një afat sa më të shkurtë.

**z. Arben Limanaj:** Dua të pyes në lidhje me një shqetësim nga OJQ “Zana” për mos kompensim nga dëmet e vërshimeve. Dhe shqetësimin e dytë që dua ta prezantoj para drejtorit të arsimit , pash një postim nga një arsimtar i shkollës “Isa Boletini” se diku kanë humbur afërsisht 100 orë të gjuhës shqipe dhe nuk është dërguar asnjë arsimtar që të i mbaj këto orë, besoj drejtori do të na informoj.

**z. Zenun Elezaj, kryetar:** Kuvendi ka aprovuar raportin e komisionit dhe nëse OJQ në fjalë është në këtë raport me siguri që ministria e financave do ta kompensoj por nëse ka ndonjë shqetësim tjetër le të i drejtohet drejtorisë së shërbimeve publike dhe merr përgjigjen. Edhe unë kam shqetësime të shumta të qytetarëve sepse në udhëzim administrativ shkruan çartë për sa kohë kanë afat banorët që të i drejtohen komunës por me siguri qytetarët nuk aknë qenë në Kosovë dhe ka kaluar afati për këto raste kemi subvencione dhe nëse gjejmë hapësirë do të kërkoj nga kuvendi që të i kompensojmë aq sa kemi mundësi.

**z. Qemajl Sejdiu, drejtor i DKA:** Në shkollën në Drenoc kemi pasur dalje në pushim të lindjes para kohe dhe nuk kemi mundur të shpallim konkurs, kemi pasur orë të humbura dhe drejtoria e arsimit ka kërkuar që ato orë të humbura të plotësohen. Mësimdhënësi që ka

shprehur shqetësimin ka qenë pikërisht ai që ka kërkuar ato orë e nuk ju kanë dhënë sepse nuk ka qenë adekuat prandaj edhe ka ngritë këtë shqetësim. Përndryshe çdo orë që zëvendësohet edhe paguhet.

Pas përfundimit të kësaj pike të rendit të ditës, kryesuesi ,z. Fadil Gashi duke i falënderuar të gjithë për pjesëmarrje dhe kontribut e shpalli të mbyllur mbledhjen.

Procesmbajtës:

Skënder Behramaj  
Gashi

Kryesues:

Fadil



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



[www.komuna-kline.org](http://www.komuna-kline.org)

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA KLINË  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA

Nr.No.Br. 401-20326/24

Data-Data-Datum 27.06.2024

Klinë-Klina

## RAPORTI NGA PROCESI I ORGANIZIMIT TË DËGJIMEVE BUXHETORE PËR KORNIZËN AFATMESME BUXHETORE 2025-2027

Qershor, 2024

## HYRJE

Korniza afatmesme buxhetore komunale paraqet një përmbledhje të planifikuar të shpenzimeve dhe të hyrave buxhetore për komunën e Klinës për periudhën afatmesme 2025-2027 si dhe shpërndarjen e resurseve financiare nëpër programe komunale sipas prioriteteve të qeverisë komunale të nxjerra nga dokumentet strategjike komunale dhe vendimet e Kuvendit komunal të Klinës.

Korniza Afatmesme Buxhetore, KAB, që po prezantohet është një dokument i cili përgatitet nga administrata komunale dhe miratohet në parim çdo vit nga Asambleja Komunale. Ky material siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve publike dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor komunal. Gjithashtu, KAB, siguron mekanizmat e nevojshëm për arritjen objektivave prioritare, të identifikuar në dokumentet strategjike të komunës, nëpërmjet integritit sa më të mirë në procesin buxhetor.

Korniza afatmesme buxhetore komunale bazohet në parashikimet e mundshme reale të të hyrave të planifikuara për periudhën afatmesme buxhetore: granteve qeveritare në formë të kufijve buxhetor, parashikimet mbi trendin e të hyrave vetanake si dhe parashikimeve mbi donacionet e mundshme qoftë edhe në formë participimeve të qytetarëve (grave dhe burrave) si dhe parashikimet reale të shpenzimeve buxhetore nëpër programet komunale që janë në fushën e përgjegjësisë së tyre.

Hartimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore përbën një detyrim për institucionet buxhetore komunale, kërkuar me Qarkoren Buxhetore Komunale 2025/01 të lëshuara nga Ministria e Financave, punës dhe transferëve në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP).

KAB 2025-2027 paraqet dokumentin kryesor mbi bazën e të cilit do të hartohet Buxheti vjetor për vitin 2025.

Komuna e Klinës gjendet në pjesën veri – perëndimore të Kosovës, rajoni i Pejës . Është njëra nga komunat e mesme të vendit. Pozita gjeografike që ka i mundëson asaj lidhje të mira me qendrat tjera të Kosovës dhe të rajonit. Komuna e Klinës ka gjithsej 54 fshatra. Sipas rezultateve të regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, Komuna e Klinës ka rreth 38496 banorë (19303 gra dhe 19193 burra) të organizuar në 5843 ekonomi familjare.

Mbi 1510 biznese (297 biznese që udhëheqen nga femrat dhe 1213 biznese që udhëheqen nga burrat) operojnë brenda komunës. Bazuar në të dhënat e Drejtorisë për Buxhet e



financa, rreth 521 merren me veprimtari tregtare, 512 shërbyese, 202 prodhuese dhe 275 ndërtime.

Administrata e Komunës së Klinës është e organizuar për rreth zyrës qendrore dhe zyrave lokale që ofrojnë shërbime në nivel të komunitetit, nga të cilat një është e vendosur brenda qytetit duke përfshirë zyrën qendrore dhe 9 të tilla në fshatra.

Vizioni i mëposhtëm për Komunën e Klinës i definuar pas konsultimeve me akterët e rëndësishëm të jetës politike ekonomike e sociale në komunë bazohet edhe në dokumentet afatmesme dhe afatgjata strategjike, që ka zhvilluar komuna siç janë: Strategjia e Zhvillimit ekonomik e Komunës së Klinës 2017-2021, Draft Strategjia e Zhvillimit ekonomik e Komunës së Klinës 2023-2028 në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2025-2027 të Qeverisë së Kosovës dhe prioriteteve bazë të saj, si dhe në Qarkoren Buxhetore Komunale 2025/01 të lëshuara nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve e Qeverisë së Republikës së Kosovës .

Vizion i komunës është që Klina do të bëhet një vend ekonomikisht i zhvilluar, ku gratë dhe burrat kanë mundësi të barabarta për të hapur dhe zhvilluar bizneset e tyre, me një administratë komunale efikase në shërbim të qytetarëve dhe bizneseve, mjedis të pastër dhe atraktiv për të jetuar dhe investuar. Duke pasur për bazë pozitën dhe kushtet gjeografike, prioritet do të jetë zhvillimi i NVM-ve, bujqësisë, turizmit dhe infrastrukturës fizike. Të kemi ngritje dhe përmirësim të cilësisë në arsim, shëndetësi dhe shërbime publike, ku barazia gjinore është prioritet ndërsektorial .

## **ECURIA E PROCESIT TË DËGJIMEVE PUBLIKE BUXHETORE PËR DRAFT - KORNIZËN AFATMESME BUXHETORE 2024-2026**

Bazuar në LIGJI NR. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Lagjnin për Financat Publike dhe Përgjegjësit, Ligji për Financat e Pushtetit Lokal si dhe Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë, Komuna e Klinës, përkatësisht Kuvendi Komunal Klinë në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës hapin procesin e dëgjimeve buxhetore për Kornizën Afatmesme Buxhetore KAB 2025-2027, duke filluar me themelimin e grupit punues, vendim i datës 8 shkurt 2024, me numër protokolli: 01 Nr. 112-4276/2024, me gjithsej pesë anëtarë;

1. Enver Berisha, Drejtorja e Financave,
2. Enver Berisha, Drejtorja e Urbanizimit,
3. Melihate Behramaj, Zyrtarja Kryesore Financiare,
4. Vlora Tafili, Zyrtare përgjegjëse për Konsultim Publik,
5. Mirsad Dakaj, anëtarë.



Grupi punues ka qenë përgjegjës për hartimin e draft-dokumentit KAB 2025-2027, marrjen e propozimeve dhe komenteve nga dëgjimet buxhetore dhe vendosjen lidhur më pranimin apo jo të tyre si dhe hartimin e raportit të shqyrtimit publik, si dhe obligimet tjera që dalin nga Udhëzimi Administrativ të MAPL-ës nr. 04/2023.

Pas marrjes së vendimit, grupi punues ka hartuar planin e brendshëm të organizimit të debateve me publikun:

*Shtojca nr. 1 – Tabela e detajuar e planit të organizimit të dëgjimeve buxhetore për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2025 - 2027:*

**Komuna Klinë**  
**Plani i organizimit të dëgjimeve buxhetore për**  
**Kornizën Afatmesme Buxhetore 2025 - 2027**

	Aktiviteti	Masat që duhet ndërmarrë	Stafi përgjegjës	Stafi përkrahës	Korniza kohore / Vendi dhe Koha
Para-përgatitore	Formimi i grupit punues për dëgjimet buxhetore lidhur me Kornizën Afatmesme Buxhetore 2025 - 2027	Vendim për formimin e grupit punues për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2025 - 2027	Zyra e Kuvendit Komunal, Zyra e Kryetarit, Drejtoria e Financave, Zyra për Informim, Grupi Punues.	Zyra Ligjore	Komuna Klinë Zyra e Kuvendit Komunal, Zyra e Kryetarit
	Hartimi i planit të organizimit të dëgjimeve buxhetore për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2025 - 2027	Organizimi i takimit të grupit punues për dëgjimet buxhetore për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2025 - 2027	Zyra e Kuvendit Komunal, Zyra e Kryetarit, Zyra për Informim, Grupi Punues	Drejtoria e Financave	Komuna Klinë Zyra e Kuvendit Komunal, Zyra e Kryetarit
	Përgatitja e terrenit ku planifikohen të mbahen takimet	Sigurimi i logjistikës dhe rregullimi i ambientit,  Ndarja e përgjithësive brenda grupit punues,  Përcaktimi i target-	Zyra për Informim, Grupi Punues.	Drejtorë të drejtorive	Komuna Klinë Zyra e Kryetarit



		grupeve, Definimi i agjendës.			
Aktivitetet e përgjithshme	Koordinimi i grupit të punës	Sigurimi i logjistikës sipas nevojës dhe përmbajtjes së takimit, rregullimi i ambientit në takim in paraprak dhe udhëtimi,  Definimi i nevojave të grupit punues dhe koordinimi me njësit tjera përgjegjëse.	Zyra për Informim, Grupi Punues.	Drejtorë të drejtorive.	Komuna Klinë Zyra e Kryetarit Maj, 2024
	Prezantimi i Kornizën Afatmesme Buxhetore 2025 - 2027	Informim për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2025 - 2027	Zyrtarja Kryesore Financiare	Zyra e Kuvendit Komunal, Zyra e Kryetarit, Zyra për Informim, Grupi Punues.	Komuna Klinë Vendi i caktuar i takimit, Maj, 2024
	Identifikimi i kërkesave dhe nevojave.	Sigurimi i regjistrimit të kërkesave;  Klasifikimi i projekteve dhe kërkesave nga grupet e targetuara dhe dëgjimeve me qytetaret.	Procesmbajtësi nga grupi punues	Grupi Punues	Komuna Klinë Vendi i caktuar i takimit. Maj, 2023
	Përmbyllja e takimit.	Hartimi i Raportit final të dëgjimeve buxhetore për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2025 – 2027,  Publikimi ne ueb faqen e komunës.	Grupi punues për dëgjimet buxhetore për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2025 – 2027.	Grupi Punues.	Komuna Klinë Vendi i caktuar i takimit. Maj, 2024

<b>Dëgjimi 1</b>	<b>Shtëpia e Fshatit, në fshatin Poterç i Epërm, më banorët e fshatrave Poterç i Epërm, Poterç i Poshtëm, Drenoc dhe Dugajevë.</b>	Organizimi i takimit me qytetarë,  Përgatitja e njoftimit, ftesave dhe thirrjeve tjera në media,  Prezantimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2025 – 2027,  Mbajtja e proces verbalit,  Përgatitja e raportit te takimit.	Zyra e Kuvendit Komunal Zyra e Kryetarit, Drejtoria e Financave, Zyra për Informim. Grupi Punues.	Zyra për Brazë Gjinore, Radio Alba, Klina Info, Drejtorë të drejtorive.	<b>Shtëpia e Fshatit POTERÇ I EPËRM</b> <b>31.05.2024</b> <b>Ora: 16:30</b>
<b>Dëgjimi 2</b>	<b>SHFMU “Azem Bejta”, në fshatin Grabancië, më banorët e fshatrave Grabanicë, Dollovë, Bokshiq, Këpuz dhe Qeskovë.</b>	Organizimi i takimit me qytetarë,  Përgatitja e njoftimit, ftesave dhe thirrjeve tjera në media,  Prezantimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2025 – 2027,  Mbajtja e proces verbalit,  Përgatitja e raportit te takimit.	Zyra e Kuvendit Komunal Zyra e Kryetarit, Drejtoria e Financave, Zyra për Informim. Grupi Punues.	Zyra për Brazë Gjinore, Radio Alba, Klina Info, Drejtorë të drejtorive.	<b>SHFMU “Azem Bejta” GRABANCIË</b> <b>31.05.2024</b> <b>Ora: 18:00</b>
<b>Dëgjimi 3</b>	<b>SHFMU “Motrat Qiriazit”, në fshatin Zajm, më banorët e fshatrave Zajm, Gremnik, Deiq, Dolc dhe Dresnik.</b>	Organizimi i takimit me qytetarë,  Përgatitja e njoftimit, ftesave dhe thirrjeve tjera në media,  Prezantimi i Kornizës	Zyra e Kuvendit Komunal Zyra e Kryetarit, Drejtoria e Financave, Zyra për Informim. Grupi Punues.	Zyra për Brazë Gjinore, Radio Alba, Klina Info, Drejtorë të drejtorive.	<b>SHFMU “Motrat Qiriazit” ZAJM</b> <b>31.05.2024</b> <b>Ora: 19:00</b>



		<p>Afatmesme Buxhetore 2025 – 2027,</p> <p>Mbajtja e proces verbalit,</p> <p>Përgatitja e raportit te takimit.</p>			
Dëgjimi 4	<p>SHFMU “Ali Krasniqi”, në Ujmirë, më banoret e fshatrave Ujmirë, Siqevë, Doberdol dhe Çabiq.</p>	<p>Organizimi i takimit me qytetarë,</p> <p>Përgatitja e njoftimit, ftesave dhe thirrjeve tjera në media,</p> <p>Prezantimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2025 – 2027,</p> <p>Mbajtja e proces verbalit,</p> <p>Përgatitja e raportit te takimit.</p>	<p>Zyra e Kuvendit Komunal Zyra e Kryetarit, Drejtoria e Financave, Zyra për Informim. Grupi Punues.</p>	<p>Zyra për Brazi Gjinore, Radio Alba, Klina Info, Drejtorë të drejtorive.</p>	<p>SHFMU “Ali Krasniqi” <b>UJMIRË</b> 03.06.2023 Ora: 16:30</p>
Dëgjimi 5	<p>Salla e Sporteve “Jetoni”, në fshatin Gllarevë, më banorët e fshatrave Gallarevë, Rixhevë, Stapanicë, Zabergjë dhe Carravik.</p>	<p>Organizimi i takimit me qytetarë,</p> <p>Përgatitja e njoftimit, ftesave dhe thirrjeve tjera në media,</p> <p>Prezantimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2025 – 2027,</p> <p>Mbajtja e proces verbalit,</p> <p>Përgatitja e raportit te takimit.</p>	<p>Zyra e Kuvendit Komunal Zyra e Kryetarit, Drejtoria e Financave, Zyra për Informim. Grupi Punues.</p>	<p>Zyra për Brazi Gjinore, Radio Alba, Klina Info, Drejtorë të drejtorive.</p>	<p>Salla e Sporteve “Jetoni”, <b>GLLAREVË</b> 03.06.2024 Ora: 17:30</p>

Dëgjimi 6	SHFMU "Tre Dëshmorët", në fshatin Jashanicë, me banorët e fshatrave Jashanicë, Pogradjë, Dush i Vogël, Resnik, Jelloc dhe Gjurgjevik i Madh.	Organizimi i takimit me qytetarë,  Përgatitja e njoftimit, ftesave dhe thirrjeve tjera në media,  Prezantimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2025 – 2027,  Mbajtja e proces verbalit,  Përgatitja e raportit te takimit.	Zyra e Kuvendit Komunal Zyra e Kryetarit, Drejtoria e Financave, Zyra për Informim. Grupi Punues.	Zyra për Brazi Gjinore, Radio Alba, Klina Info, Drejtorë të drejtorive.	SHFMU "Tre Dëshmorët" JASHANICË 03.06.2024 Ora: 19:00
Dëgjimi 7	SHFMU "Atë Gjergj Fishta", në fshatin Jagodë, më banorët e fshatrave Jagodë, Vidjeë, Krushevë e Madhe dhe Budisalc.	Organizimi i takimit me qytetarë,  Përgatitja e njoftimit, ftesave dhe thirrjeve tjera në media,  Prezantimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2025 – 2027,  Mbajtja e proces verbalit,  Përgatitja e raportit te takimit.	Zyra e Kuvendit Komunal Zyra e Kryetarit, Drejtoria e Financave, Zyra për Informim. Grupi Punues.	Grupi punues	SHFMU "Atë Gjergj Fishta" JAGODË 10.06.2024 Ora: 16:30
Dëgjimi 8	SHFMU "Atë Shtejfën Gjeçovi", në fshatin Zllakuqan, me banorët e fshatrave Zllakuqan, Ranoc, Leskoc, Nagllavë,	Organizimi i takimit me qytetarë,  Përgatitja e njoftimit, ftesave dhe thirrjeve tjera në media;  Prezantimi i Kornizës	Zyra e Kuvendit Komunal Zyra e Kryetarit, Drejtoria e Financave, Zyra për Informim. Grupi Punues.	Grupi punues	SHFMU "Atë Shtejfën Gjeçovi" ZLLAKUQAN 10.06.2024 Ora: 17:30



	<b>Dranashiq, Stupë dhe Rudicë.</b>	Afatmesme Buxhetore 2025 – 2027,  Mbajtja e proces verbalit;  Përgatitja e raportit te takimit.			
<b>Dëgjimi 9</b>	<b>SHFMU “Emin Duraku”, në fshatin Sferkë, më banorët e fshatrave Sferkë, Përçevë, Volljakë, Qupevë dhe Dush, datë 10.06.2024, ora 19:00,</b>	Organizimi i takimit me qytetarë;  Përgatitja e njoftimit, ftesave dhe thirrjeve tjera në media;  Prezantimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2025 – 2027. Mbajtja e proces verbalit,  Përgatitja e raportit te takimit.	Zyra e Kuvendit Komunal Zyra e Kryetarit, Drejtoria e Financave, Zyra për Informim. Grupi Punues.	Grupi punues	<b>SHFMU “Emin Duraku” SFERKË 10.06.2024 Ora: 19:00</b>
<b>Dëgjimi 10</b>	<b>Takim i përgjithshëm me banorët e lagjeve të qytetit.</b>	Organizimi i takimit me qytetarë;  Përgatitja e njoftimit, ftesave dhe thirrjeve tjera në media;  Prezantimi i Kornizën Afatmesme Buxhetore 2025 – 2027,  Mbajtja e proces verbalit,  Përgatitja e raportit te takimit.	Zyra e Kuvendit Komunal Zyra e Kryetarit, Drejtoria e Financave, Zyra për Informim. Grupi Punues.	Grupi punues	<b>Kuvendi Komunal Klinë KLINË 12.06.2024 Ora: 17:00</b>
<b>Aktivitetet</b>	Organizimi i	Diskutimi i në lidhje	Zyra e Kuvendit	Drejtoria e	<b>Komuna</b>

përfundimtare	takimit të grupit punues pas përfundimit të dëgjimeve buxhetore për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2025 – 2027.	me mbarëvajtjen e dëgjimeve buxhetore për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2025 – 2027,  Identifikimi i projekteve të propozuara,  Përcaktimi i prioriteteve.	Komunal, Zyra e Kryetarit, Drejtoria e Financave, Zyra për Informim. Grupi Punues.	Financave.	Klinës
	Hartimi i raportit nga procesi i organizimit të dëgjimeve buxhetore për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2025 – 2027.	Hartimi i raportit final të dëgjimeve buxhetore për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2025 – 2027.  Publikimi në ueb faqe,  Raportimi në Kuvendin komunal.	Zyra për Informim, Grupi Punues.	Zyra e Kuvendit Komunal, Zyra e Kryetarit, Drejtorë të drejtorive.	Komuna Klinës

**Si dhe dëgjimi buxhetor organizuar nga Kuvendi Komunal Klinë, në sallën e Kuvendit, datë 25.06.2024, ora 10:00.**

Grupi punues pas hartimit të planin e brendshëm të organizimit të debateve me publikun, ka realizuar kalendarin e dëgjimeve publike buxhetore me qytetarë për KAB 2025-2027.

*Shtojca nr. 2 – Tabela e detajuar e kalendarit të dëgjimeve:*

Nr.	Fshatrat	Vendi i mbajtjes së dëgjimeve	Data	Ora
1.	Poterç i Epërm, Poterç i Poshtëm, Drenoc dhe Dugajevë	Shtëpia e Fshatit	31.05.2024	16:30
2.	Grabanicë, Dollovë, Bokshiq, Këpuz dhe Qeskovë	SHFMU "Azem Bejta"	31.05.2024	18:00



3.	Zajm, Gremnik, Deiq, Dolc dhe Dresnik	SHFMU "Motrat Qiriazit"	31.05.2024	19:00
4.	Ujmirë, Siqevë, Doberdol dhe Çabiq	SHFMU "Ali Krasniqi"	03.06.2024	16:30
5.	Gallarevë, Rixhevë, Stapanicë, Zabergjë dhe Carravik	Salla e Sportit "Jetoni"	03.06.2024	17.30
6.	Jashanicë, Pogragjë, Dush i Vogël, Resnik, Jelloc dhe Gjurgjevik i Madh	SHFMU "Tre Dëshmorët"	03.06.2024	19:00
7.	Jagodë, Videjë, Krushevë e Madhe dhe Budisalc	SHFMU "Atë Gjergj Fishta"	10.06.2024	16:30
8.	Zllakuqan, Ranoc, Leskoc, Nagllavë, Dranashiq, Stupë dhe Rudicë	SHFMU "Atë Shtjefën Gjeçovi"	10.06.2024	17:30
9.	Sferkë, Përçevë, Volljakë, Qupevë dhe Dush	SHFMU "Emin Duraku"	10.06.2024	19:00
10.	Takim i përgjithshëm me banorët e lagjeve të qytetit	Salla e Kuvendit Komunal Klinë	12.06.2024	17:00
11.	Takim i përgjithshëm me qytetarë organizuar nga Kuvendi Komuna Klinë	Salla e Kuvendit Komunal Klinë	25.05.2024	10:00

Para datës së takimeve, grupi punues ka nxjerrë edhe njoftimet për të gjitha institucionet komunale, qytetarët, OJQ-të, organizatat e biznesit, kryetarët e fshatrave të bashkësive lokale, media dhe të interesuarit tjerë për pjesëmarrje në këtë takim, si dhe pjesëmarrjen me kërkesa dhe sugjerime në mënyrë elektronike te zyrtarët:

1. Vlora Tafili, email: [vlora.tafili@rks-gov.net](mailto:vlora.tafili@rks-gov.net);
2. Mirasad Dakaj, email: [mirsad.dakaj@rks-gov.net](mailto:mirsad.dakaj@rks-gov.net)

Gjithashtu dhe mundësinë e dorëzimit të propozimeve lidhur me këto akte me shkrim në shërbimin për punë të kuvendit, kati I, zyra e dytë.

Propozimet dhe sugjerimet e të gjithë interesuarve janë mirëpritur nga data **24.05.2024**, gjatë mbajtjes së dëgjimeve dhe deri me datën **21.06.2024**.



Përveç takimit me publikun nëpër lokalitete dhe në sallën e Kuvendit Komunal, grupi punues ka shfrytëzuar metodën për konsultim me qytetarët prej 30 ditësh në ueb-faqen zyrtare të komunës dhe në platformën e konsultimit publik në nivel të qeverisë.

Komuna Klinë: <https://kk.rks-gov.net/kline/category/konsultimet-publike/njoftimet-konsultimet-publike/>

Platformën e konsultimeve publike – Qeveria e Kosovës: <https://konsultimet.rks-gov.net/consultations.php?InstitutionID=20514&OpenPage=0&ClosedPage=0>

Materiali në formë fizike është mundësuar të merret në Zyrën e Shërbimit për Punë të Kuvendit, drejtorinë e Financave dhe Zhvillimit Ekonomik si dhe Zyrën e Kryetarit të Komunës. Po ashtu, ka qenë i publikuar edhe në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Klinës si dhe në Platformën e Qeverisë së Kosovës për Konsultime Publike.

<https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2024/05/634-Klina-DRAFT-KAB-2025-2027.docx>



Shtojca nr. 3 – Tabela e detajuar e metodologjisë së dëgjimeve:

Metodat e dëgjimeve	Data / Kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve	Numri i atyre që kanë dhënë komente, kërkesa / sugjerime

1. Takim i drejtpërdrejtë në shtëpin e fshatit Pjetërq i Epërm.	31.05.2024 46 min	34 pjesëmarrës	4 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa.
			5 kërkesa janë regjistruar.
2. Takim i drejtpërdrejtë në SHFMU “Azem Bejta”, në fshatin Grabancië, më banorët e fshatrave Grabanicë, Dollovë, Bokshiq, Këpuz dhe Qeskovë.	31.05.2024 36 min	13 pjesëmarrës	4 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa.
			6 kërkesa janë regjistruar.
3. Takim i drejtpërdrejtë në SHFMU “Motrat Qirizai”, në fshatin Zajm, më banorët e fshatrave Zajm, Gremnik, Deiq, Dolc dhe Dresnik.	31.05.2024 27 min	9 pjesëmarrës	4 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa.
			6 kërkesa janë regjistruar.
4. Takim i drejtpërdrejtë në SHFMU “Ali Krasniqi”, në Ujmirë, më banoret e fshatrave Ujmirë, Siqevë, Doberdol dhe Çabiq.	03.06.2024 59 min	15 pjesëmarrës	7 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa.
			14 kërkesa janë regjistruar.
5. Takim i drejtpërdrejtë në Salla e Sporteve “Jetoni”, në fshatin Gllarevë, më banorët e fshatrave Gallarevë,	03.06.2024 1 orë	29 pjesëmarrës	5 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa.



Rixhevë, Stapanicë, Zabergjë dhe Carravik.			<b>5 kërkesa janë regjistruar.</b>
6. Takim i drejtpërdrejtë në SHFMU “Tre Dëshmorët”, në fshatin Jashanicë, me banorët e fshatrave Jashanicë, Pogragjë, Dush i Vogël, Resnik, Jelloc dhe Gjurgjevik i Madh.	03.06.2024 1 orë e 12 min	17 pjesëmarrës	<b>4 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa.</b>
			<b>7 kërkesa janë regjistruar.</b>
7. Takim i drejtpërdrejtë në SHFMU “Atë Gjergj Fishta”, në fshatin Jagodë, më banorët e fshatrave Jagodë, Vidjeë, Krushevë e Madhe dhe Budisalc.	10.06.2024 52 min	25 pjesëmarrës	<b>4 pjesëmarrës ka parashtruar kërkesa.</b>
			<b>12 kërkesa janë regjistruar.</b>
8. Takim i drejtpërdrejtë në SHFMU “Atë Shtejfën Gjeçovi”, në fshatin Zllakuqan, me banorët e fshatrave Zllakuqan, Ranoc, Leskoc, Nagllavë, Dranashiq, Stupë dhe Rudicë.	10.06.2024 38 min	17 pjesëmarrës	<b>8 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa.</b>
			<b>11 kërkesa janë regjistruar.</b>
9. Takim i drejtpërdrejtë në SHFMU “Emin Duraku”, në fshatin Sferkë, më banorët e fshatrave Sferkë, Përçevë, Volljakë, Qupevë dhe Dush.	10.06.2024 1 orë e 17 min	20 pjesëmarrës	<b>4 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa.</b>
			<b>4 kërkesa janë regjistruar.</b>



10. Takim i drejtpërdrejtë në sallën e Kuvendit Komunal Klinë me banorët e lagjëve të qytetit.	10.06.2024 1 orë e 21 min	30 pjesëmarrës	5 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa.
			6 kërkesa janë regjistruar.
11. Takim i drejtpërdrejtë në sallën e Kuvendit Komunal Klinë, organizuar nga Kuvendi Komunal.	12.06.2024 36 min	33 pjesëmarrës	3 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa.
			3 kërkesa janë regjistruar.
Publikimi në ueb-faqe / platforma	30 ditë	1 pjesëmarrës	1 kërkesa e regjistruar.
Kërkesa në formë fizike	30 ditë	1 pjesëmarrës	7 kërkesa të regjistruar.

Të gjitha kërkesat e parashtruara në dëgjimet buxhetore të drejtpërdrejta, ato në formë elektronike si dhe ato të pranuar në formë fizike, janë shqyrtuar nga Grupi Punues, ndërsa raporti i detajuar për kërkesat e pranuar apo refuzuara, është paraqitur në formë të plotë në shtojcën nr. 4 të këtij raporti.

*Shtojca nr. 4 – Tabela e detajuar me informatat për kërkesat e dhëna, arsyetimet për kërkesat e pranuar dhe të refuzuara;*

Tema e dëgjimit	Kërkesat / Sugjerimet / Komentet	Personi i kërkesës / sugjerimi për projektet	Statusi i kërkesës / sugjerimi ( i pranuar , pjesërisht e pranuar apo nuk është pranuar)	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mospranimin të komenteve është i detyrueshëm)
-----------------	----------------------------------	--	--	--



**TAKIMI I PARË ME BANORËT E FSHATRAVE POTERÇ I EPËRM, POTERÇ I POSHTËM, DRENOC DHE DUGAJEVË**

DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	Kërkojë ndërtimin e një muri mbrojtës për rrugën e shtëpisë time.	Agim Agushi - fshati Drenoc.	Refuzohet	<b>Përgjigja:</b> Grupi punues ka refuzuar me arsyen që ai muri mbrojtës ka kosto të madhe financiare dhe që nuk përfitojnë një numër i madh i banorëve po vetëm një familje dhe nuk lidhet me rrugën kryesore.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	<b>Kërkesat:</b> 1. Kërkesë për vazhdimin e projektit të rregullimit të shtratit të lumit.	Nysret Krasniqi - Përfaqësues i banorëve të fshatit Drenoc.	Pranohet	<b>Përgjigja:</b> Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Nysret Krasniqi nga fshati Drenoc, hyn në prioritet e vitet 2025-2027.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	2. Ndriçimin e rrugëve të mbetura në fshat.	Nysret Krasniqi - Përfaqësues i banorëve të fshatit Drenoc.	Pranohet	<b>Përgjigja:</b> Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Nysret Krasniqi nga fshati Drenoc, hyn në prioritet e vitet 2025-2027.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	Kërkesë në emër të banorëve të fshatit; asfaltimin e rrugës tek varrezat e fshatit.	Muharrem Musa - fshati Pjetërq i Epërm.	Pranohet	<b>Përgjigja:</b> Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Muharrem Musa dhe hyn prioritet në vitet 2025-2027.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	Kërkesë në emër të banorëve të fshatit; asfaltimin e rrugës tek varrezat e fshatit.	Gjon Daka - fshati Pjetërq i Poshtëm.	Pranohet	<b>Përgjigja:</b> Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Gjon Daka nga fshati Pjetërq i Poshtëm dhe hyn prioritet në vitet 2025-



2027.

**TAKIMI I DYTË ME BANORËT E FSHATRAVE GRABANICË, DOLLOVË,  
BOKSHIQ, KËPUZ DHE QESKOVË**

DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	<b>Kërkesat:</b> 1. Kërkesë për rregullimin e shtratit të lumit "Lumbardh".	<b>Sejdi Baleci - Përfaqësuesi i banorëve nga fshati Grabanicë.</b>	<b>Pranohet</b>	<b>Përgjigja:</b> Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Sejdi Baleci nga fshati Grabanicë dhe hyn prioritet në vitet 2025-2027.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	2. Zgjatja e rrjetit te ndriçimit,	<b>Sejdi Baleci - Përfaqësuesi i banorëve nga fshati Grabanicë.</b>	<b>Pranohet</b>	<b>Përgjigja:</b> Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Sejdi Baleci nga fshati Grabanicë dhe hyn prioritet në vitet 2025-2027.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	3. Vazhdimi projektit për shtrirjen e trotuarit.	<b>Sejdi Baleci - Përfaqësuesi i banorëve nga fshati Grabanicë.</b>	<b>Pranohet</b>	<b>Përgjigja:</b> Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Sejdi Baleci nga fshati Grabanicë dhe hyn prioritet në vitet 2025-2027.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	Kërkon funksionalizimin e objektit të vjetër të shkollës "Azem Bejta", dhe bartjen ambulantes së fshatit dhe gjendjes cilive aty.	<b>Armend Beqirit - fshati Grabanicë, Këshilltarë i Kuvendit Komunal.</b>	<b>Pranohet</b>	<b>Përgjigja:</b> Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Armend Beqiri nga fshati Grabanicë, njëherësh këshilltarë i Kuvendit Komunal Klinë dhe hyn prioritet në vitet 2025-2027.
DRAFT -	Kërkesë për pastrimin e kanali	<b>Hajdar</b>	<b>Pranohet</b>	<b>Përgjigja:</b>



KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	të ujërave afër shkollës.	<b>Baleci - fshati Grabanicë.</b>		Grupi punues kërkesën e z. Hajdar Baleci nga fshati Grabanicë dhe hyn prioritet në vitet 2025-2027.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	Kërkon që fshati Bokshiq tër përfshihet me një projekt në Kornizën Afatmesme Buxhetore 2025- 2027.	<b>Fadil Bershia drejtori i shkollës “Azem Bejta”, nga fshati Qeskovë.</b>	<b>Pranohet</b>	<b>Përgjigja:</b>  Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Fadil Berisha nga fshati Qeskovë, fshati Bokshiq hyjnë në pjesën e investimeve si prioritet në vitet në vazhdim.
<b>TAKIMI I TRETË ME BANORËT E FSHATRAVE ZAJM, GREMNIK, DEIQ, DOLC DHE DRESNIK</b>				
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	Kërkon shtrirjen e rrjetit të kanalizimit në lagjen e “Krasniqeve”.	<b>Labinot Zogaj - fshati Zajm.</b>	<b>Pranohet</b>	<b>Përgjigja:</b>  Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Labinot Zogaj nga fshati Zajm dhe hyn prioritet në vitet 2025-2027.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	Kërkesë për asfaltimin e rrugës “Arra”, në fshatin Zajm.	<b>Metë Krasniqi - fshati Zajm.</b>	<b>Pranohet</b>	<b>Përgjigja:</b>  Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Metë Krasniqi nga fshati Zajm dhe hyn prioritet në vitet 2025-2027.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	1. Kërkon shtrirjen e rrjetit të ndriçimit të rrugës “7 Shtatori”.	<b>Halil Kurtaj - fshati Zajm.</b>	<b>Pranohet</b>	<b>Përgjigja:</b>  Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Halil Kurtaj nga fshati Zajm dhe hyn prioritet në vitet 2025-2027.
DRAFT - KORNIZA	2. Shtrirjen e rrjetit të ndriçimit	<b>Halil Kurtaj - fshati</b>	<b>Pranohet</b>	<b>Përgjigja:</b>



AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	të rrugës “Qerkin Demaku”.	<b>Zajm.</b>		Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Halil Kurtaj nga fshati Zajm dhe hyn prioritet në vitet 2025-2027.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	1. Kërkon asfaltimin e rrugës “Bekim Fehmiu”.	<b>Luigj Dedaj - fshati Dresnik.</b>	<b>Pranohet</b>	<b>Përgjigja:</b>  Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Luigj Dedaj nga fshati Dresnik dhe hyn prioritet në vitet 2025-2027.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	2. Nevojën e madhe për investim në tensionin e lartë të rrymës.	<b>Luigj Dedaj - fshati Dresnik.</b>	<b>Refuzohet</b>	<b>Përgjigja:</b>  Grupi punues ka refuzuar kërkesën tjetër të z. Luigj Dedaj nga fshati Dresnik pasi komuna nuk mund të ndërhyjë në kompetenca të KEDS.

**TAKIMI I KATËRT ME BANORËT E FSHATRAVE UJMIRË, SIQEVË,  
DOBERDOL DHE ÇABIQ**

DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	Kërkesë për vendosjen e shtyllave të tensionit të lartë.	<b>Zeqir Gashi - fshati Cabiq.</b>	<b>Refuzohet</b>	<b>Përgjigja:</b>  Grupi punues ka refuzuar kërkesën e z. Zeqir Gashi nga fshati Çabiq pasi komuna nuk mund të ndërhyjë në kompetenca të KEDS.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	Kërkesat: 1. Vendosjen e shtyllave të tensionit të lartë në fshatin Doberdol.	<b>Anton Berisha - fshati Doberdol.</b>	<b>Refuzohet</b>	<b>Përgjigja:</b>  Grupi punues ka refuzuar kërkesën e z. Zeqir Gashi nga fshati Çabiq pasi komuna nuk mund të ndërhyjë në kompetenca të KEDS.
DRAFT -	2. Zgjerimin e	<b>Anton Berisha</b>	<b>Refuzohet</b>	<b>Përgjigja:</b>



KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	rrugës Doberdol – Gjurgjevik.	- fshati Doberdol.		Grupi punues ka refuzuar kërkesën e z. Anton Berisha nga fshati Doberdol për shkak të problemëve pronësore.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	Kërkesat: 1. Ndriçimin e rrugëve në fshatin Doberdol.	Kadri Vishaj - fshati Doberdol.	Pranohet	<b>Përgjigja:</b> Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Kadri Vishaj nga fshati Doberdol dhe hyn prioritet në vitet 2025-2027.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	2. Ç ’bllokimin e kanalizimit me gjatësi 1 km.	Kadri Vishaj - fshati Doberdol.	Pranohet	<b>Përgjigja:</b> Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Kadri Vishaj dhe në bashkëpunim me KRMU “Hidrodrini” do të intervenohet në ç ’bllokim të kanalizimit.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	Kërkesat: 1. Ndërrimin e dyerve të shkollës “Ali Krasniqi”.	Fatmir Millaku - fshati Ujmirë.	Pranohet	<b>Përgjigja:</b> Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Fatmir Millaku nga fshati Ujmirë dhe hyn prioritet në vitet 2025-2027.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	2. Ndriçimin në një pjesë të rrugës kryesore.	Fatmir Millaku - fshati Ujmirë.	Pranohet	<b>Përgjigja:</b> Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Fatmir Millaku nga fshati Ujmirë dhe hyn prioritet në vitet 2025-2027.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	3. Rregullimin e tensionit të rrymës në lagjen e “Veselve”.	Fatmir Millaku - fshati Ujmirë.	Refuzohet	<b>Përgjigja:</b> Grupi punues ka refuzuar kërkesën e z. Fatmir Millaku nga fshati Ujmirë pasi komuna nuk mund të ndërhyjë



				në kompetenca të KEDS.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	<b>Kërkesat:</b> 1. Kanalizimi në lagjen e "Gashve".	<b>Sokol Krasniqi - fshati Çabiq.</b>	<b>Pranohet</b>	<b>Përgjigja:</b> Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Sokol Krasniqi nga fshati Çabiq dhe dhe hyn prioritet në vitet 2025-2027.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	<b>Kërkesat:</b> 2. Asfaltimin e tre rrugicave të lagjes së "Lubavecve".	<b>Sokol Krasniqi - fshati Çabiq.</b>	<b>Pranohet</b>	<b>Përgjigja:</b> Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Sokol Krasniqi nga fshati Çabiq dhe dhe hyn prioritet në vitet 2025-2027.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	3. Asfaltimin e dy rrugicave më gjithsej 70 metra gjatësi të rrugës "Halil Ibishi".	<b>Sokol Krasniqi - fshati Çabiq.</b>	<b>Pranohet</b>	<b>Përgjigja:</b> Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Sokol Krasniqi nga fshati Çabiq dhe dhe hyn prioritet në vitet 2025-2027.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	4. Shtrim me zhavorr rrugën e cila lidhet me Kijevën.	<b>Sokol Krasniqi - fshati Çabiq.</b>	<b>Pranohet</b>	<b>Përgjigja:</b> Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Sokol Krasniqi nga fshati Çabiq dhe dhe hyn prioritet në vitet 2025-2027.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	<b>Kërkesat:</b> 1. Vendosjen e rrethojës së varrezat në fshatin Çabiq.	<b>Anton Buzhala - fshati Çabiq.</b>	<b>Pranohet</b>	<b>Përgjigja:</b> Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Anton Buzhala nga fshati Çabiq hyn prioritet në vitet 2025-2027.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE	2. Shtrirjen e rrjetit të kanalizimit në lagjen e	<b>Anton Buzhala - fshati Çabiq.</b>	<b>Pranohet</b>	<b>Përgjigja:</b> Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Anton Buzhala nga fshati Çabiq hyn prioritet



2025-2027	“Buzhalëve”, ku do të përfshihen katër apo pesë familje në atë rrjet me 170 metra gjatësi.			në vitet 2025-2027.
-----------	---	--	--	---------------------

**TAKIMI I PESTË ME BANORËT E FSHATRAVE GALLAREVË, RIXHEVË,  
STAPANICË, ZABERGJË DHE CARRAVIK**

DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	Kërkesë për asfaltimin e rrugës në lagjen “Morina”.	<b>Emin Balaj - fshati Gllarevë.</b>	<b>Pranohet</b>	<b>Përgjigja:</b>  Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Emin Balaj nga fshati Gllarevë dhe hyn prioritet në vitet 2025-2027.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	Kërkesë për shtrimin e trotuarit në gjatësi 3 km i cili kalon në rrugën kryesore dhe afër shkollës.	<b>Skender Veselaj - fshati Gllarevë.</b>	<b>Pranohet</b>	<b>Përgjigja:</b>  Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Skender Veselaj nga fshati Gllarevë dhe hyn prioritet në vitet 2025-2027.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	Kërkesë për ndërtimin e trotuarit dhe ndriçimit përgjatë rrugës kryesore të fshatit dhe gjithashtu fshati ka nevojë për shtrirjen e kanalizimit.	<b>Halil Bashota - fshati Carravik.</b>	<b>Pranohet</b>	<b>Përgjigja:</b>  Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Halil Bashota nga fshati Gllarevë dhe hyn prioritet në vitet 2025-2027.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME	Kërkesë për shtrirjen e rrjetit të ndriçimit	<b>Musli Morina – Gllarevë.</b>	<b>Refuzohet</b>	<b>Përgjigja:</b>  Grupi punues ka refuzuar



BUXHETORE 2025-2027	publik në rrugën “Pranvera 81”.			kërkesën e z. Musli Morina nga fshati Gllarevë pasi rruga “Pranvera 81” i takon si pjesë magjistralesë Pejë – Prishtinë dhe komuna nuk mund të ndërhyjë në kompetenca e Ministrisë së Infrastrukturës.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	Kërkesë për asfaltimin e rrugës në lagjen “Veselaj”, me gjatësi 300-400 metra.	<b>Arbër Veselaj – Gllarevë.</b>	<b>Pranohet</b>	<b>Përgjigja:</b>  Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Arbër Veselaj nga fshati Gllarevë dhe hyn prioritet në vitet 2025-2027.

**TAKIMI I GJASHTË ME BANORËT E FSHATRAVE JASHANICË, POGRAGJË,  
DUSH I VOGËL, RESNIK, JELLOC DHE GJURGJEVIK I MADH**

DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	Kërkesat: 1. Rregullimin e shtratit të lumit.	<b>Rasim Marmullaku - fshati Dush.</b>	<b>Pranohet</b>	<b>Përgjigja:</b>  Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Rasim Marmullaku nga fshati Dush dhe hyn prioritet në vitet 2025-2027.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	2. Ndriçimi publik dhe kemi probleme me shtyllat elektrike që duhet të rregullohen.	<b>Rasim Marmullaku - fshati Dush.</b>	<b>Refuzohet</b>	<b>Përgjigja:</b>  Grupi punues ka refuzuar kërkesën e z. Rasim Marmullaku nga fshati Ujmirë pasi komuna nuk mund të ndërhyjë në kompetenca të KEDS.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME	Kërkesë për përmirësimin apo riparimin e rrugës	<b>Liridon Raci - fshati Jelloc.</b>	<b>Pranohet</b>	<b>Përgjigja:</b>  Grupi punues ka pranuar



BUXHETORE 2025-2027	Jelloc-Resnik.			kërkesën e z. Rasim Marmullaku nga fshati Dush dhe hyn prioritet në vitet 2025-2027.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	Kërkesë për renovimin e zyrës së gjendjes civiline në fshatin Jashanicë.	<b>Faruk Mulaj- fshati Jashanicë.</b>	<b>Pranohet</b>	<b>Përgjigja:</b> Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Rasim Marmullaku nga fshati Jashanicë dhe hyn prioritet në vitet 2025-2027.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	<b>Kërkesat:</b> 1. Ndërtimin e rrjetit të kanalizimit.	<b>Tahir Berisha – fshati Gjurgjevik i Madh.</b>	<b>Pranohet</b>	<b>Përgjigja:</b> Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Tahir Berisha nga fshati Gjurgjevik i Madh dhe hyn prioritet në vitet 2025-2027.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	3. Ndërtimin e një trotuar, sipas mundësive buxhetore të komunës.	<b>Tahir Berisha – fshati Gjurgjevik i Madh.</b>	<b>Pranohet</b>	<b>Përgjigja:</b> Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Tahir Berisha nga fshati Gjurgjevik i Madh dhe hyn prioritet në vitet 2025-2027.
<b>TAKIMI I SHTATË ME BANORËT E FSHATRAVE JAGODË, VIDJË, KRUSHEVË E MADHE DHE BUDISALC</b>				
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	<b>Kërkesat:</b> 1. Ndërtimin e një trotuari që lidh fshatin Videjë me Klinën.	<b>Gjergj Marku- Përfaqësuesi i fshatit Vidjë.</b>	<b>Pranohet</b>	<b>Përgjigja:</b> Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Gjergj Marku, përfaqësues i banorëve të fshatit Videjë dhe hyn prioritet në vitet 2025-2027.



DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	2. Asfaltimin e rrugës "Gjergj Nikolla,".	<b>Gjergj Marku- Përfaqësuesi i fshatit Vidjë.</b>	<b>Pranohet</b>	<b>Përgjigja:</b>  Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Gjergj Marku, përfaqësues i banorëve të fshatit Videjë, gjithësesi konfirmojmë që ajo rrugë është në projekt edhe do përfundohet shumë shpejtë.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	3. Përfundimin e kanalizimit në lagjen kryesore, përfshirë degëzimin që vjen nga fshati Paskalicë.	<b>Gjergj Marku- Përfaqësuesi i fshatit Vidjë.</b>	<b>Pranohet</b>	<b>Përgjigja:</b>  Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Gjergj Marku, përfaqësues i banorëve të fshatit Videjë dhe hyn prioritet në vitet 2025-2027.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	<b>Kërkesat:</b> 1. Vazhdimi i kanalit të ujitjes për 800 metra me gjerësi prej 60 metrash.	<b>Mark Gjinaj - fshatit Videjë.</b>	<b>Pranohet</b>	<b>Përgjigja:</b>  Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Mark Gjinaj nga fshati Videjë dhe hyn prioritet në vitet 2025-2027.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	2. Ndërtimi i një rruge fushore me zhavorr tek prona e "Ndue Gjergjit".	<b>Mark Gjinaj - fshatit Videjë.</b>	<b>Pranohet</b>	<b>Përgjigja:</b>  Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Mark Gjinaj nga fshati Videjë dhe hyn prioritet në vitet 2025-2027.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	3. Ndërtimi i një trotuari nga Videja deri te kisha tek lagja Gojani.	<b>Mark Gjinaj - fshatit Videjë.</b>	<b>Pranohet</b>	<b>Përgjigja:</b>  Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Mark Gjinaj nga fshati Videjë dhe hyn prioritet në vitet 2025-2027.
DRAFT - KORNIZA	<b>Kërkesat:</b> 1. Kanalin e	<b>Lekë Bekaj - Krushevë e</b>	<b>Pranohet</b>	<b>Përgjigja:</b>  Grupi punues ka pranuar



AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	ujitjes në mes të fshatit ka nevojë për pastrim dhe zgjerim deri në 800 metra.	<b>Madhe.</b>		kërkesën e z. Lekë Bekaj nga fshati Krushevë e Madhe dhe hyn prioritet në vitet 2025-2027.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	2. Penda e ujitjes është bllokuar dhe kanali nuk po funksionon si duhet, kështu që kemi nevojë që të ç'bllokohet.	<b>Lekë Bekaj - Krushevë e Madhe.</b>	<b>Pranohet</b>	<b>Përgjigja:</b> Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Lekë Bekaj nga fshati Krushevë e Madhe dhe hyn prioritet në vitet 2025-2027.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	3. Ndërtimi i 300 metrave të kanalit të ujitjes me beton, me përmasa 80/60,	<b>Lekë Bekaj - Krushevë e Madhe.</b>	<b>Pranohet</b>	<b>Përgjigja:</b> Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Lekë Bekaj nga fshati Krushevë e Madhe dhe hyn prioritet në vitet 2025-2027.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	Kërkesë për ndriçim publik në fshatin Krushevë e Madhe.	<b>Lush Ndrecaj - fshti Krushevë e Madhe</b>	<b>Pranohet</b>	<b>Përgjigja:</b> Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Lekë Bekaj nga fshati Krushevë e Madhe dhe hyn prioritet në vitet 2025-2027.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	Kërkesat: 1. Asfaltimin e rrugës "Anton Qeta" për minoritetet, veçanërisht një segment prej 200 metrash afër trafos në Budisalc.	<b>Mark Gojani - fshati Budisalc.</b>	<b>Pranohet</b>	<b>Përgjigja:</b> Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Lekë Bekaj nga fshati Krushevë e Madhe dhe hyn prioritet në vitet 2025-2027.



DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	2.Pastrim të kanalit të ujitjes për 900 metra.	<b>Mark Gojani</b> - fshati <b>Budisalc.</b>	<b>Pranohet</b>	<b>Përgjigja:</b> Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Lekë Bekaj nga fshati Krushevë e Madhe dhe hyn prioritet në vitet 2025- 2027.
<b>TAKIMI I TETË ME BANORËT E FSHATRAVE ZLLAKUQAN, RANOC, LESKOC, NAGLLAVË, DRANASHIQ, STUPË DHE RUDICË</b>				
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	<b>Kërkesat:</b> 1.Ndërtimi i trotuarit në rrugën Budisalc- Rudicë.	<b>Bujar</b> <b>Mehmet -</b> <b>fshati</b> <b>Rudicë.</b>	<b>Refuzohet</b>	<b>Përgjigja:</b> Grupi punues ka refuzuar kërkesën e z. Bujar Mehmeti nga fshati Rudicë pasi që ekzistojnë probleme pronësore me banorët.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	2. Ndërtimi i urës e cila lidh fshatin Budisalc dhe Rudicë pasi kalimi është mjaftë i vështirë.	<b>Bujar</b> <b>Mehmet -</b> <b>fshati</b> <b>Rudicë.</b>	<b>Pranohet</b>	<b>Përgjigja:</b> Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Bujar Mehmeti nga fshati Rudicë dhe hyn prioritet në vitet 2025-2027.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	3. Të shihet si prioritet ndërtimi i kanalit të ujitjes.	<b>Bujar</b> <b>Mehmet -</b> <b>fshati</b> <b>Rudicë.</b>	<b>Pranohet</b>	<b>Përgjigja:</b> Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Bujar Mehmeti nga fshati Rudicë dhe hyn prioritet në vitet 2025-2027.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	Ndërtimi i trotuarit në rrugën Krushevë- Zllakuqan.	<b>Tunë Dedaj-</b> <b>fshati Deiq,</b> <b>Këshilltarë</b> <b>në Kuvendin</b> <b>Komunal</b> <b>Klinë.</b>	<b>Pranohet</b>	<b>Përgjigja:</b> Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Tunë dedaj nga fshati Deiq, njëherësh këshilltarë i Kuvendit Komunal Klinë dhe hyn



				prioritet në vitet 2025-2027.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	Kërkesë për shtrimin e një rruge me zhavorr.	<b>Tomë Kqiraj</b> - fshati <b>Berkovë.</b>	<b>Pranohet</b>	<b>Përgjigja:</b>  Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Tomë Kqiraj nga fshati Berkovë dhe hyn prioritet në vitet 2025-2027.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	Kërkesë për rregullimin e shtratit të lumit "Drini i Bardhë", ose të paktën të bëhet pastrimi.	<b>Nrec</b> <b>Përnoka -</b> <b>fshati</b> <b>Zllakuqan.</b>	<b>Pranohet</b>	<b>Përgjigja:</b>  Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Nrec Përnoka nga fshati Zllakuqan dhe hyn prioritet në vitet 2025-2027.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	<b>Kërkesat:</b> 1. Sanim të gropave në rrugët Zllakuqan, Ranoc dhe Leskoc.	<b>Gjokë Dodaj</b> - fshati <b>Leskoc.</b>	<b>Pranohet</b>	<b>Përgjigja:</b>  Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Gjokë Dodaj nga fshati Leskoc dhe hyn prioritet në vitet 2025-2027.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	2. Investim në kabllo të përquesve të rrymës.	<b>Gjokë Dodaj</b> - fshati <b>Leskoc.</b>	<b>Refuzohet</b>	<b>Përgjigja:</b>  Grupi punues ka refuzuar kërkesën e z. Gjokë Dodaj nga fshati Leskoc pasi komuna nuk mund të ndërhyjë në kompetenca të KEDS.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	Kërkesë për investim në rrjet të energjisë elektrike.	<b>Mirush Zefi -</b> <b>fshati Ranoc.</b>	<b>Refuzohet</b>	<b>Përgjigja:</b>  Grupi punues ka refuzuar kërkesën e z. Mirush Zefi nga fshati Ranoc pasi komuna nuk mund të ndërhyjë në kompetenca të KEDS.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME	Kërkesë për ndërtimin e palestrës në	<b>Pren Balaj -</b> <b>fshati Ranoc.</b>	<b>Pranohet</b>	<b>Përgjigja:</b>  Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Pren Balaj nga



BUXHETORE 2025-2027	shkollën “Atë Shtjefën Gjeçovi”.			fshati Ranoc dhe hyn prioritet në vitet 2025-2027.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	Kërkesë për renovimin e tërësishëm të saj apo edhe ndërtimin e shkollës së re “Atë Shtjefën Gjeçovi”.	<b>Nënkryetarja Marqe Tanushi- Selmanaj.</b>	<b>Pranohet</b>	<b>Përgjigja:</b>  Grupi punues ka pranuar kërkesën e znj. Marqe Tanushi-Selmanaj nga fshati Zllakuqan, njëherësh Nënkryetare e Komunës dhe hyn prioritet në vitet 2025-2027.
<b>TAKIMI I NËNTË ME BANORËT E FSHATRAVE SFERKË, PËRÇEVË, VOLLJAKË, QUPEVË DHE DUSH</b>				
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	Kërkesa për ndërtimin e një parku në fshatin tonë.	<b>Sali Berisha - fshati Volljakë.</b>	<b>Pranohet</b>	<b>Përgjigja:</b>  Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Sali Berisha nga fshati Volljakë dhe hyn prioritet në vitet 2025-2027.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	Kërkesë: 1. kërkoj të mbjellën pemë dekorative rreth rrugës kryesore prej varrezave deri te parku.	<b>Mustafë Gashi - fshati Sferkë.</b>	<b>Pranohet</b>	<b>Përgjigja:</b>  Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Mustafë Gashi nga fshati Sferkë dhe hyn prioritet në vitet 2025-2027.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	2. Kërkesë për kanalizim për një distancë prej 400-600 metrash dhe për vazhdimin e trotuarit në fshatin Sferkë.	<b>Mustafë Gashi - fshati Sferkë.</b>	<b>Pranohet</b>	<b>Përgjigja:</b>  Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Mustafë Gashi nga fshati Sferkë dhe hyn prioritet në vitet 2025-2027.
DRAFT -	Kërkesë për	<b>Mergim</b>	<b>Pranohet</b>	<b>Përgjigja:</b>



KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	shtrimin e rrugës “Besim Gashi” me zhavorr.	<b>Gashi - fshati Sferkë.</b>		Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Mergim Gashi nga fshati Sferkë dhe hyn prioritet në vitet 2025-2027.
--	---	-----------------------------------	--	---

**TAKIM I DREJTPËRDREJTË NË SALLËN E KUVENDIT ME  
BANORËT E LAGJEVE TË QYTETIT**

DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2024-2026	<b>Kërkesat:</b> 1. Kërkojë ulëse apo pushimore n ërrugën “Isa Boletini”.	<b>Sahit Raci - banorë në qytet Klinë.</b>	<b>Pranohet</b>	<b>Përgjigja:</b> Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Sahit Raci, banorë në qytet Klinë dhe hyn prioritet në vitet 2025-2027.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2024-2026	2. Gjithashtu, edhe riparimin e rrugës “Mehdi Morina”.	<b>Sahit Raci - banorë në qytet Klinë.</b>	<b>Pranohet</b>	<b>Përgjigja:</b> Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Sahit Raci, banorë në qytet Klinë dhe hyn prioritet në vitet 2025-2027.

DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2024-2026	Kërkon që në rrugën “Shaban Sadiku” dhe rrugën “Bedri Mustafa”, të ndërrohet gypi i azbestit, duke pasur parasysh dëmët që shkaktohen nga përmbajtja e tij e rrezikshme kimike.	<b>Bajram Shala - banorë në qytet Klinë.</b>	<b>Pranohet</b>	<b>Përgjigja:</b> Grupi punues ka pranuar kërkesën z. Bajram Shala, banorë në qytet Klinë dhe hyn prioritet në vitet 2025-2027.
---	---	--	-----------------	---



DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2024-2026	Si banues në objektin në qendër "Citadela", afër objektit të Postës së Kosovës, rruga "Abedin Rexha", në sheshin "Mujë Krasniqi", kërkojë renovimin e jashtëm të këtijë objekti.	<b>Muhamet Gashi,</b> <b>banorë në qytet Klinë:</b>	<b>Pranohet</b>	<b>Përgjigja:</b>  Grupi punues ka pranuar kërkesën z. Muhamet Gashi, banorë në qytet Klinë dhe hyn prioritet në vitet 2025-2027, në kodin financiar bashkëfinancim me donatroë.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2024-2026	Si banues tek ndërtesat afër sheshit "Faruk Elezaj", kërkojë që tek parku i ri i ndërtuar me shtatoren e Faruk Elezajt, të rregullohet edhe hapësira e jashtme aty tek oborret e ndërtesave.	<b>Milazim Raci</b> <b>- banorë në qytet Klinë.</b>	<b>Pranohet</b>	<b>Përgjigja:</b>  Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Milazim Raci, banorë në qytet Klinë dhe hyn prioritet në vitet 2025-2027.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2024-2026	Kërkoj që vitin e ardhshëm të rritet buxheti në drejtorinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në kodin për subvencione.	<b>Edmond Duhanaj -</b> <b>banorë në qytet Klinë.</b>	<b>Pranohet</b>	<b>Përgjigja:</b>  Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Edmond Duhanaj, banorë në qytet Klinë dhe hyn prioritet në vitet 2025-2027.
<b>TAKIM I DREJTPËRDREJTË NË SALLËN E KUVENDIT ME QYTETARË ORGANIZUAR NGA KUVENDI KOMUNAL</b>				
DRAFT - KORNIZA AFATMESME	Kërkesë për riparimin e kanalizimit ekzistues.	<b>Mark Berisha-</b> <b>fshati</b>	<b>Pranohet</b>	<b>Përgjigja:</b>  Grupi punues ka pranuar kërkesën e Mark Berisha-



BUXHETORE 2024-2026		Dugajevë.		fshati Dugajevë dhe hyn prioritet në vitet 2025-2027.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2024-2026	Kërkesë për rregullimin e kanalit për rrjedhjen e ujërave atmosferike.	Marjan Ndrecaj – fshati Dresnik.	Pranohet	<b>Përgjigja:</b>  Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Marjan Ndrecaj nga fshati Dresnik dhe hyn prioritet në vitet 2025-2027.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2024-2026	Kërkesë për rregullimin e rrugës dhe riparimin e ndriçimit në lagjen mbi hekurudhë.	Lavdim Mulaj – banorë në qytet Klinë.	Pranohet	<b>Përgjigja:</b>  Grupi punues ka pranuar kërkesën e z.Lavdim Mulaj, banorë në qytet Klinë dhe hyn prioritet në vitet 2025- 2027.

#### PUBLIKIMI NË UEB-FAQE / PLATFORMA DHE EMAIL

DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	Kërkesa është që te behet rregullimi i kulmit ne dy hyrjet e para, te behet fasadimi/izolimi i ndërtesës dhe te vendoset shenja e ndalim parkimin(përveç banorëve).	Ardian Quni – Banorë në qytet, Klinë.	Pranohet	<b>Përgjigja:</b>  Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Ardian Quni, duke e inkuadruar tek kategoria Bashkëfinancim me Donatorë për projeksionet buxhetore të viteve 2025- 2026.
---	--	---	----------	---

#### KËRKESË NË FORMË FIZIKE

DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE	<b>Kërkesë:</b> 1. Lagjja Morina, me familjët e Amrush Morina,	Sadik Hoti – fshati Dollovë.	Pranohet	<b>Përgjigja:</b>  Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Sadik Hoti nga
--	---	------------------------------------	----------	--



2025-2027	Avni Morina, Haki Morina, Sylejman Morina, Bedri Morina, Sami Morina dhe Fehmi Morina, të cilët kërkojnë gjithësej 790 metra asfaltim të rrugëve.			fshati Dollovë dhe hyn prioritet në vitet 2025-2027.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	2. Lagja e Prekolluka, me familjët e Islam Bardheci, Shqiprim Bardheci dhe Bajram Prokolluka, të cilët kërkojnë 160 metra asfaltim të rrugëve dhe 300 metra rrjet të kanalizimit.	<b>Sadik Hoti – fshati Dollovë.</b>	<b>Pranohet</b>	<b>Përgjigja:</b>  Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Sadik Hoti nga fshati Dollovë dhe hyn prioritet në vitet 2025-2027.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	3.Lagjja Berisha, me familjët e Eqrem Berishës, Avni Berisha, Fehrat Berisha, Ruzhdi Berisha, Driton Berisha, të cilët kërkojnë 200 rrugë të asfaltuara.	<b>Sadik Hoti – fshati Dollovë.</b>	<b>Pranohet</b>	<b>Përgjigja:</b>  Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Sadik Hoti nga fshati Dollovë dhe hyn prioritet në vitet 2025-2027.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	4.Lagjja e Hotëve, familjët e Agron Hoti, Ismet Hoti, Adem Hoti, Skender Hoti, Lulëzim Hoti, Fadil Hoti, Sadik Hoti, Selim Hoti, Bajram Hoti, Arif Hoti	<b>Sadik Hoti – fshati Dollovë.</b>	<b>Pranohet</b>	<b>Përgjigja:</b>  Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Sadik Hoti nga fshati Dollovë dhe hyn prioritet në vitet 2025-2027.



	dhe Florim Hoti, të cilët kërkojnë trotuar dhe asfaltim të rrugës 500 metra.			
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	5. Varrezat e fshatit, kërkojmë 200 metra rrugë me kubëzim.	Sadik Hoti – fshati Dollovë.	Pranohet	<b>Përgjigja:</b> Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Sadik Hoti nga fshati Dollovë dhe hyn prioritet në vitet 2025-2027.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	6. Kanal të ujitjes, 2500 metra.	Sadik Hoti – fshati Dollovë.	Pranohet	<b>Përgjigja:</b> Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Sadik Hoti nga fshati Dollovë dhe hyn prioritet në vitet 2025-2027.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027	7. Ndriçim publik, pjesa e mbetur të vazhdohet edhe 300 metra.	Sadik Hoti – fshati Dollovë.	Pranohet	<b>Përgjigja:</b> Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Sadik Hoti nga fshati Dollovë dhe hyn prioritet në vitet 2025-2027.

Draft –Korniza Afatmesme Buxhetore 2025-2027, pas përmbylljes së procesit të konsultimit, do të finalizohen së bashku me komente dhe sugjerimet dhe do të procedohet për në Kuvendin e Komunës së Klinës, për shqyrtim dhe miratim.

Gjatë debateve buxhetore për Draft – Kornizën Afatmesme Buxhetore 2025-2027, pjesëmarrës kanë qenë 210 persona, 1 person me email dhe një person tjetër me kërkesë me shkrim, më gjithsej **tetëdhjeteshtatë (87) kërkesa**.

*Shtojca Nr. 5 – Tabela e numrit të pjesëmarrësve të ndarë sipas gjinisë.*

Femra	5
Meshkuj	207
Total:	212



Shtojca nr. 6 – Vendimi i themelimit të grupit punues për KAB 2025-2027:

[https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2024/02/Scan\\_2018\\_02\\_02\\_09\\_04\\_16\\_647.pdf](https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2024/02/Scan_2018_02_02_09_04_16_647.pdf)

Përfaqësuesja e Grupit Punues,  
Vlora Tafili



Klinë, 27.06.2024



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



[www.kk.komuna-klina.org](http://www.kk.komuna-klina.org)

21.06.2024

Një  
Udhë  
Organ. ...

RAPORTI GJASHTËMUJOR PËR VITIN 2024  
KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

01 052-119705/24

KKSB-ja ka pasur synim identifikimin e dukurive negative që mund të prishin sigurinë publike, parandalimin e veprimeve që kërcënojnë sigurinë në bashkësi, eliminimin e dukurive të lidhura me krimin, parregullsitë dhe sjelljet e dhunshme. Gjithashtu, ka qenë e përkushtuar për krijimin e një bashkëpunimi të qëndrueshëm me të gjitha komunitetet që jetojnë në territorin e komunës së Klinës.

Gjatë kësaj periudhe raportuese, parimi kryesor i KKSB-së ka qenë përqendrimi në aktivitete për çështje të sigurisë, duke bashkëpunuar me policinë, qytetarët, organizatat, KLSP-të dhe përfaqësues të shoqërisë civile dhe institucionet fetare. Synimi ka qenë identifikimi dhe shqyrtimi i çështjeve lidhur me problemet e sigurisë në bashkësi, me qëllim zgjidhjen konkrete të këtyre sfidave.

Në këtë kontekst, KKSB-ja ka zhvilluar një sërë iniciativash dhe projektesh për të mbështetur dhe forcuar sigurinë në komunitet, duke adresuar drejtpërdrejt shqetësimet dhe sfidat e ngritura nga qytetarët në drejtoritë përkatëse.

**Takimet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi**  
**Gjatë kësaj periudhe (gjashtëmujore) janë trajtuar këto çështje:**

<b>Shkurt</b>	<ol style="list-style-type: none"><li>1. Vlerësimi i përgjithshëm i sigurisë në territorin e Komunës së Klinës.</li><li>2. Ushtrimi i kontrollit më të shpeshta të trafikut rrugor për të zvogëluar aksidentet me fatalitet.</li><li>3. Organizimi i trajnimit për mbrojtje nga zjarri me nxënësit e shkollave.</li><li>4. Trajtimi i qenve endacak.</li></ol>
<b>Prill</b>	<ol style="list-style-type: none"><li>1. Analizimi i vjedhjeve në territorin e Komunës së Klinës .</li><li>2. Mungesa e trotuareve dhe shenjave sinjalizuese në territorin e Komunës.</li><li>3. Identifikimi dhe lirimi i hapësirave publike konkretisht trotuareve.</li></ol>
<b>Qershor</b>	<ol style="list-style-type: none"><li>1. Diskutim për aktivitete e organizuara nga Drejtoria e Arsimit për maurantet.</li><li>2. Prishja e rendit dhe qetësisë publike nga lokalet e natës dhe personat e pa përgjegjshëm.</li><li>3. Parapërgatitja dhe vetëdijesimi i qytetarëve për mbrojtje nga zjarri gjatë sezonit veror dhe vërshimet gjatë vitit.</li><li>4. Plani operativ për sezonin e pushimeve të mërgimtarëve dhe dasmave.</li></ol>



## **Disa konkluzione për sfidat dhe çështjet me të cilat përballlet Komuna e Klinës:**

Komuna e Klinës po përballlet me një problem të vazhdueshëm të vjedhjeve, që kërkon analizë dhe trajtim të mëtejshëm, mbi të gjitha bashkëpunim me qytetarë dhe stacionin policor në Klinë, për të gjitha çështjet e sigurisë në komunë raporton në çdo takim, komandanti i policisë në Klinë dhe gjitha këto probleme trajtohen nga ky stacion policor.

Problem tjetër në komunë është mungesa e trotuareve dhe shenjave sinjalizuese, që paraqet një shqetësim për sigurinë dhe lehtësinë e qarkullimit për këmbësorët. Është identifikuar nevoja për lirim dhe mirëmbajtjen e hapësirave publike, veçanërisht të trotuareve.

Drejtorja e Arsimit organizon aktivitete për maturantët, që janë të rëndësishme për zhvillimin dhe arsimimin e tyre si dhe ofron siguri rrugore dhe përcjellë aktivitetin e tyre nga afër.

Ka shqetësime rreth prishjes së rendit dhe qetësisë publike nga lokalet e natës dhe persona të papërgjegjshëm, inspektorët janë të angazhuar që pronaret të zbatojnë rregulloren e Rendit dhe qetësisë në komunë .

Ka nevojë për parapërgatitje dhe vetëdijësim të qytetarëve për mbrojtje nga zjarri dhe vërshimet, sidomos gjatë sezonit veror, angazhimi i drejtorisë përkatëse është i vazhdueshëm rreth përcjelljes dhe vetëdijësimit të qytetarëve.

Është përpiluar një plan operativ për sezonin e pushimeve të mërgimtarëve dhe dasmave, për të siguruar menaxhim më të mirë të këtyre periudhave si dhe siguri të shtuar në komunikacion sidomos në periudhën kur vinë mërgimtarët.

Komuna ka sfida edhe me menaxhimin e qenve endacakë, që kërkon zgjidhje efektive ku drejtorja e Shërbimeve Publike ka projekt për trajtimin dhe menaxhimin e qenve endacak.

Këto pika reflektojnë përpjekjet dhe sfidat kryesore të Komunës së Klinës për të përmirësuar cilësinë e jetesës dhe sigurinë e qytetarëve të saj.

Zv. Kryesuese

Marqë Selmanaj





**Kuvendi i Komunës Klinë**

**Komiteti për Politikë dhe Financa**

01Nr 06-19775 /24

Klinë: 21.06 /2024

**PËR: Kuvendin e Komunës Klinë**

**Nga: Komiteti për Politikë dhe Financa**

**Kryesuesi i Komitetit: Fadil Gashi**



**REKOMANDIMET e Komitetit për Politikë dhe Financa, të datës: 07.06.2024**

Komiteti për Politikë dhe Financa, në mbledhjen e VI të rregullt për vitin 2024, shqyrtoi dhe miratoi për shqyrtim në Kuvend këto pika:

**Pika1. Shqyrtimi i draft-kornizës afatmesme buxhetore 2025-2027**

-Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, referoi drejtori nga Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, theksoi se procesi i konsultimit publik lidhur me draft-kornizën afatmesme buxhetore 2025-2027 në bashkësi lokale dhe fshatra të Komunës së Klinës, po ashtu, prezantoi të Hyrat komunale dhe parashikimin afat-mesëm 2025-2027 sipas tabelës.

<b>Korniza afatmesme buxhetore 2025-2027</b>	<b>Buxheti aktual 2024</b>	<b>Planifikimi 2025</b>	<b>Vlerësimi 2026</b>	<b>Vlerësimi 2027</b>
Granti i përgjithshëm	6.086.118.00	6.571.819.00	6.951.325.00	7.337.752.00
Granti specifik i arsimit	5.453.127.00	5.953.349.00	6.131.950.00	6.315.908.00
Granti i shëndetësisë	1.673.212.00	1.897.981.00	1.988.325.00	2.082.970.00
Të hyrat vetanake	1.436.260.00	1.495.504.00	1.606.855.00	1.720.536.00
Financimi për shërbimet rezidenciale		250.000.00	200.000.00	200.000.00
<b>Totali :</b>	<b>14.648.717.00</b>	<b>16.168.653.00</b>	<b>16.878.455.00</b>	<b>17.657.166.00</b>



**Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të draft-kornizës afatmesme buxhetore 2025-2027, pa ndonjë vërejtje apo sugjerim, rekomandoi që e njëjta të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.**

**Pika 2. Shqyrtimi i propozim-vendimit për transfer të mjeteve brenda kategorisë ekonomike shpenzimet kapitale.**

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, drejtori i FEZH kërkoi të bëhet transfer i mjeteve brenda OB nga kategoria ekonomike Shpenzimet kapitale (kodi -300), fondi burimor 10.

Nga programi Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural (470), nën-programi Bujqësia-Klinë (47018), kodi funksional (0421) nga kategoria ekonomike Shpenzimet Kapitale (300) fondi 10, projekti “Ndërtimi i kanaleve të ujitjes Budisalc-Jagodë-Radulloç, Poterq-Dollove”, kodi i projektit (54346), shuma prej 19,847.00 €, të transferohet në:

Programin Planifikimi Urban dhe Mjedisi (660), nën-programi Planifikimi Urban dhe Inspeksioni (66395), kodi funksional (0620) në kategorinë ekonomike Shpenzimet Kapitale (300) fondi 10, projekti “Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Krushevë e Vogël (trotuari Klinë-Zllakuqan)”, kodi i projektit (54341) shuma 9,763.00 €.

Programin Planifikimi Urban dhe Mjedisi (660), nën-programi Planifikimi Urban dhe Inspeksioni (66395), kodi funksional (0620) në kategorinë ekonomike Shpenzimet Kapitale (300) fondi 10, projekti “Ndërtimi i segmenteve dhe infrastrukturës nëntokësore të rrugës “Ymer Berisha”, “Drini i Bardhë”, “Skender Rexhepi”, “Abedin Rexha”, “Mehmet Haxhaj”, “Haxhi Zeka”, kodi i projektit (54272) shuma 1,781.13 €.

Programin Shëndetësia dhe mirëqenia sociale (730), nën-programin Shërbimet e shëndetësisë primare (74050) me kod funksional (0721) në kategorinë ekonomike Shpenzimet Kapitale (300), fondi 10, projekti “Ndërtimi i nxehtësimit qendror me pompa termike në QKMF Klinë”, kodi i projektit (54361), shuma 6,000.00 €.

Programin Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencia (180), nën-programin Infrastruktura Rrugore - Klinë (18018) me kod funksional (0451) në kategorinë ekonomike Shpenzimet Kapitale (300), fondi 10, projekti “Ndërtimi i rrjetit të ndriçimit publik Krushevë e Vogël-Madhe, Drenoc, Qeskovë, Jashanicë, Leskoc, Ranoc”, kodi i projektit (54353), shuma 2,302.87 €.

**Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të propozimit për transfer të mjeteve në kategorinë e shpenzimeve kapitale, rekomandoi që propozim-vendimi të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.**

**Pika 3. Shqyrtimi i raportit nga procesi i organizimit të konsultimit publik për draft-strategjinë komunale për mbrojtje nga dhuna në familje 2024-2027.**



-Lidhur me këtë pikë, kryesuesi theksoi se në këtë raport janë të gjitha kërkesat dhe sugjerimet të cilat janë dhënë nga palët e interesuara lidhur me këtë draft-strategji komunale, bazuar në U.A. Nr.03/2020 për transparencë në komuna kemi obligim ligjor që ta shqyrtojmë në KPF dhe Kuvend.

**Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të raportit nga procesi i organizimit të konsultimit publik për draft-strategjinë komunale për mbrojtje nga dhuna në familje 2024-2027, rekomandoi që i njëjti të kalojë për shqyrtim në Kuvend.**

**Pika 4. Shqyrtimi i draft-strategjisë komunale për mbrojtje nga dhuna në familje 2024-2027 dhe plani i veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje 2024-2027.**

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, drejtori i Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, theksoi se ky draft është punuar nga komisioni komunal, por që mungoi në prezantim, Hartimi dhe zbatimi i Strategjisë Komunale dhe Planit të Veprimit kundër Dhunës në Familje për Komunën e Klinës, mundëson koordinimin e përpjekjeve ekzistuese të të gjitha departamenteve dhe institucioneve qeverisëse komunale dhe të organizatave joqeveritare. Qëllimi i vetëm i këtyre përpjekjeve të përbashkëta është të parandalojë dhe luftojë Dhunën në Familje si dhe të ndihmojë zhvillimin adekuat dhe mirëqenien e gjithë shoqërisë sonë. Gjithashtu, kërkoi që i njëjti të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

**Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të draft-strategjisë komunale për mbrojtje nga dhuna në familje 2024-2027 dhe plani i veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje 2024-2027, pa ndonjë vërejtje apo sugjerim, rekomandoi që i njëjti të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.**

**Pika 5. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajt maj-qershor 2024.**

#### **Kërkesa 1.**

Kërkesë për regjistrim të këmbimit të pronës e parashtruar nga Stanka Bogiqeviq nga fshati Drenoc i Komunës së Klinës e cila thekson se që nga viti 1966 shkolla fillore në fshatin Drenoc me marrëveshje për këmbim prone me prindin tim të ndjerë, është ndërtuar në një pjesë të pronës sime, por ajo pjesë e tokës juridikisht ende është në emrin tim, ndërsa toka që i është dhënë si këmbim ende është në emër të kooperativës bujqësore "Bistrica" nga Drenoci. Andaj kërkon që të fillojnë procedurat ligjore për rregullimin e gjendjes faktike, pjesa e cila shfrytëzohet nga shkolla të kalojë në emër të shkollës, ndërsa pjesa e cila është në emër të kooperativës të kalojë në emrin e saj.

**-Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga znj. Stanka Bogiqeviq, rekomandoi që kërkesa të kalojë për shqyrtim në Drejtorinë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi.**

**Kërkesa 2.**

Kërkesë e parashtruar nga HANDIKOS, kryetarja Vjollca Preka, me anë të së cilës kërkojnë sigurimin e një objekti për aktivitetet dhe nevojat e tyre, një zyre 20m<sup>2</sup>, një sallë për takime dhe trajnime të ndryshme 25m<sup>2</sup> dhe një depo për mjete ortopedike dhe sanitare 20m<sup>2</sup>. Gjithashtu kërkojnë që të përkrahen vazhdimisht për plotësimin e kushteve dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara të cilët janë mbi 450 anëtarë.

**Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga HANDIKOS për sigurimin e një objekti për plotësimin e nevojave të tyre, rekomandoi që kërkesa të dërgohet për shqyrtim në Zyrën e Kryetarit dhe në Drejtorinë për Administratë.**

**Kërkesa 3.**

Kërkesë e parashtruar nga Alush Asanaj nga fshati Gllarevë, i cili me anë të kësaj kërkesë, kërkon që t'i jepet në shfrytëzim një pjesë prej 3 ari nga parcela me Nr. P-71010034-01074-1, pronë shoqërore e Komunës së Klinës e cila gjendet në rrugën "Abedin Rexha" pa numër. Gjithashtu, thekson se prona në fjalë gjendet afër shtëpisë së tij dhe se planifikon të ndërtojë një objekt për zhvillimin e një biznesi bazuar në kushtet ndërtimore dhe lejen e dhënë ashtu siç përcaktohet me ligj.

**Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga Alush Asanaj, rekomandoi që kërkesa të dërgohet për shqyrtim në Zyrën e Kryetarit, ku do të veprohet sipas Ligjit Nr.06./L-092 dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës.**